

**UNITED
NATIONS**
United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**TRANSKRIPTI
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 22.2.2007**

**TRANSKRIPT
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE DANA 22.02.2007.GODINE**

SHKURT – FEBRUAR 2007

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare më 8 shkurt 2007, si dhe i taranskripteve të datës 8 e 9 shkurt 2007,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për letërnjoftimin,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetësinë publike,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimet shëndetësore,
7. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Hetimor për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës sipas raportit të Auditorit të Përgjithshëm,
8. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit drejtues të Autoritetit Bankar të Kosovës,
9. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Këshillit të Kosovës për Ujërat.

DNEVNI RED

1. Usvajanje dnevnog reda,
2. Usvajanje zapisnika Plenarne sednice, od 8. februara i transkrpta od 8. i 9. februara 2007 god.,
3. Vreme za parlamentarna pitanja,
4. Prvo razmatranje Nacrta Zakona o ličnoj karti,
5. Drugo razmatranje Nacrta Zakona o javnom zdravstvu,
6. Drugo razmatranje Nacrta Zakona o zdravstvenom osiguranju,
7. Razmatranje Izvestaja Anketne Komisije o faktičkim nalazima u Skupštini Kosova na osnovu Izveštaja Generalnog revizora,
8. Razmatranje predloga Vlade Kosova o imenovanju članova Upravnog odbora Centralnog bankarskog autoriteta Kosova,
9. Razmatranje predloga o imenovanju članova Saveta Kosava o vodama.

AGENDA

1. Approval of the agenda,
2. Approval of minutes for the plenary session 8 February and transcripts of 8 and 9 February 2007,
3. Time reserved for parliamentary questions,
4. First reading of the Draft law on identification card,
5. Second reading of the Draft law on public health,
6. Second reading of the Draft law on health insurance,
7. Review of the Report of Investigative Committee on the factual findings in the Assembly of Kosovo base to the report from the general auditor,
8. Review of the proposal from Government of Kosovo on nominating members of the Steering Committee of Kosovo Central Fiscal Authority ,
9. Review of the proposal of the for nominating members of the Kosovo's water Board .

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Të nderuar deputetë, i nderuari ministër dhe kabinet qeveritar. Mirë se keni ardhur në seancën e sotshme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj se në sallë janë 82 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Para se të fillojmë me punën, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare i ftoj deputetët që të mbajmë një minutë heshtje për viktimat e protestave.

Ju faleminderit.

Në pajtim me rregullat 6 dhe 23 të Rregullores së punës. Kryesia e Kuvendit e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën plenare. Në pajtim me rregullën 23.2 Komisioni për **Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese** i është drejtuar Kuvendit të Kosovës me kërkesë që të radhisë si pikë të veçantë të rendit të ditës rekomandimet e gjyqtarëve dhe se materiali për këtë u është shpërndarë deputetëve.

Qeveria e Kosovës, po ashtu, ka kërkuar që të hiqet pika e 8-të e rendit të ditës të propozuar për këtë seancë.

A miratohet ky rend i ditës me këto dy propozime që i thashë në fund?

Futja e një pike të re të rendit të ditës.

Deklarohemi? Ju faleminderit.

Kush është kundër?

Fjalën e kërkon NAZIM JASHARI ,

DEPUTETI NAZIM JASHARI - I nderuari kryetar, është e rrugës që ky Kuvend të mos punojë..... ta kemi të qartë se cilat pika po propozohen të hiqen dhe cilat pika po propozohen që të futen që të dimë të votojmë. Realisht nuk po dimë si të pozicionohemi si grup parlamentar, duke mos pasur informatë të nevojshme dhe të mjaftueshme për të marrë vendim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Mund të jetë se nuk kam qenë i qartë, e lexoj edhe një herë.

Në pajtim me rregullat 6 dhe 23 të Rregullores së punës Kryesia e Kuvendit e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën plenare të datës së sotme.

Ndërkohë në pajtim me rregullën 23.2 Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese i është drejtuar Kuvendit me kërkesë që të radhisë si pikë të veçantë të rendit të ditës rekomandimin e listës për gjyqtarë dhe se materiali për këtë pikë u është shpërndarë me kohë deputetëve.

Dhe pika tjetër që duhet të hiqet. Qeveria e Kosovës ka kërkuar të hiqet pika 8-të e rendit të ditës e propozuar për këtë seancë.

Fjalën e kërkon z. Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – Faleminderit z. kryetar. Vetë fakti që ne kemi në dorë dy vendime nga Qeveria, tregon se Qeveria aspak nuk është serioze në punën e vetë dhe fakti tjetër që tregon jo seriozitetin e Qeverisë është kërkesa për të tërhequr nga rendi i ditës pikën për të cilën thatë ju.

Unë do të kërkoj një shpjegim nga kryeministri pse këtij Kuvendi ia ka servuar dy vendime, cilat kanë qenë arsyet e ndryshimit të këtij vendimi dhe pse tani e tërheq pikën e rendit të ditës në fjalë dhe nën 2.

Ne kemi pasur materialin për gjyqtarët, por në emër të Grupit Parlamentar konsideroj se kjo pikë nuk mund të futet në rendin e ditës, sepse ashtu siç e kemi marrë rendin e ditës ne si Grup Parlamentar nuk jemi të përgatitur për këtë pikë të rendit të ditës.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Z. kryeministër e keni përgjigjen.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Faleminderit z. Koci. Të nderuar deputetë, i nderuari kryetar.

Është e vërtetë që ka ardhur deri te një kërkesë e jona dje, ndoshta pak me vonesë që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës të kësaj seance për disa arsye. Qeveria më parë e ka marrë një vendim që t'i rekomandojë këtij Kuvendi që të emërohen dy anëtarë të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës z. Isa Mustafa dhe z. Ali Sadriu. Me këtë vendim nuk janë pajtuar PSSPP-ja dhe autoriteti kryesor dhe e ka anuluar kandidaturën e z. Ali Sadriu, për arsye se është deputet i këtij Kuvendi dhe nuk mund të jetë sipas Rregullores së Autoritetit Qendror Bankar anëtar i Bordit.

Duke u nisur nga kjo ne duke dashur që të zgjidhet kjo çështje sa më shpejt kemi pasur një propozim dje që një kandidat tjetër, në parim është miratuar nga Qeveria, por menjëherë pas seancës erdhën reagime të ndryshme se nuk janë kryer konsultimet e nevojshme brenda subjektit politik që është pjesë e koalicionit qeverisës dhe është kërkuar nga unë që të kërkoj nga ju që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës derisa të përfundojnë konsultimet e nevojshme brenda subjektit politik për emërimin e kandidatit të dytë të këtij bordi. Kjo është arsyeja.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Z. Gashi në emër të LDK-së.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Mendoj se është e rrugës kërkesa e Qeverisë që të merret në konsiderim dhe ne e mbështesim që kjo çështje të vijë në seancën e radhës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka Teuta Sahatqija.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Faleminderit z. kryetar. Pajtohemi me kërkesën e PDK-së, sepse sipas Rregullores çdo ndryshim i rendit të ditës duhet të bëhet me shkrim dhe grupet parlamentare nuk kanë qenë të njoftuara me kohë për ndryshimin e rendit të ditës. Prandaj kërkojmë që në të ardhmen çdo ndryshim i rendit të ditës apo çdo kërkesë që vjen nga Qeveria të jenë të njoftuara grupet parlamentare në mënyrë që të jenë të përgatitur. Për heqjen e pikës nga rendi i ditës mund të pajtohemi, por për futjen e pikës së re në rend të ditës pa u përgatitur grupet parlamentare mendoj që nuk është serioze dhe do të duhej të shtyhej për seancën e radhës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Është rekomandim i Komisionit që kjo pikë të futet në rendin e ditës dhe ftoj kryetarin e Komisionit z. Berisha të japë sqarime.

DEPUTETI SADUDIN BERISHA – I nderuari kryetar i Kuvendit. Të nderuar kolegë deputetë.

Sic jeni në dijeni Kuvendi i Kosovës disa muaj më parë ka shqyrtuar rekomandimet e Komisionit për ligje të rekomanduar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për emërimin e 21 gjykatësve dhe të një prokurori për sistemin gjyqësor të Kosovës. Me rekomandimin e Komisionit për ligje 5 për kandidaturat e propozuara është kërkuar informacion shtesë. Në mungesë të dhënave plotësuese Kuvendi ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor që informacioni shtesë t'i përcjellë për 5 kandidaturat e dhëna. Në këtë drejtim ditë më parë Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka përcjell informacionet shtesë për 3 kandidatuara dhe i rekomandon Kuvendit që ato 3 kandidatura të emërohen për gjykatës të gjykatave komunale, 2 për në Gjykatën Komunale të Prizrenit dhe 1 për Gjykatën Komunale të Gjilanit, kështu që me urgjencë është kërkuar që në seancën e radhës kjo pikë të futet në rendin e ditës për shqyrtim dhe miratim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Z. Koci pritni, të votojmë së pari për pikën e rendit të ditës të propozuar nga Komisioni për Çështje Gjyqsore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese.

Fjalën e kërkon z. Bajrush Xhemajli.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Sa i përket futjes së pikës që e propozon Komisioni në rend dite, mendoj që së pari ka mund të bëhet njoftimi më herët, sepse nuk ka qenë diçka e ngutshme dhe dihet se Rregullorja përcakton sa ditë më herët, prandaj kjo më habit pse të futet në mënyrë të ngutshme diçka që nuk ka kurrfarë nevojë. Kjo është absolutisht e pa papranueshme për grupin parlamentar të PDK-së, nuk është asgjë e ngutshme që ata gjyqtarë a do të rrinë një javë apo jo. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Z. Gashi e keni fjalën përsëri.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Faleminderit z. kryetar. Me shumë dashamirësi për propozimin e përfaqësuesit të Komisionit, por mendoj se në veçanti në këto raste ku ne zgjedhim njerëz që duhet me mbështet ligjin dhe rregullat, nuk ka asnjë urgjencë për grupin tonë që kjo çështje të dalë në seancë pa u shqyrtuar në mbledhje të grupit, pa u shqyrtuar në mbledhje të Kryesisë së Kuvendit dhe pa u përfillur procedura në tërësi. Andaj ne sot nuk e mbështesim që kjo të hyjë si çështje urgjente e jashtëzakonshme, pasi për ne nuk është e jashtëzakonshme. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. E vë në votim.

Kush është për propozimin e listës për gjyqtarë që të hyjë në rend ditës?

Për, ju faleminderit

Kundër, ju faleminderit.

Konstatohet se hiqet nga rendi i ditës ky propozim.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës që është kontestuese.

Urdhëroni z. Koci.

DEPUTETI GANI KOCI - Me siguri jeni i lodhur z. kryetar dhe po i ngatërroni shumë çështjet. Nuk mund të kalohet në një çështje pa u kryer çështja e parë. Ne e kishim heqjen nga rendi i ditës dhe e respektoj arsyetimin e kryeministrit për heqje të pikës së propozuar nga rendi i ditës, por nuk mund ta arsyetoj dhe nuk mund të pajtohem me arsyetimin e tij se kjo po tërhiqet nga rendi i ditës ,sepse nuk janë bërë konsultimet ndërmjet subjekteve politike që e përbëjnë koalicionin qeveritar. Kërkoj përgjigje nga kryeministri, anëtari i Bordit të Autoritetit Bankar a duhet të zgjidhet me anë të çelësit politik apo ka kritere të tjera për përzgjedhjen e tij. Në qoftë se nuk e ka të qartë kryeministri, ashtu si nuk e ka pasur të qartë edhe me marrjen e vendimit të parë edhe të dytë, le ta marrë dhe le ta lexojë Rregulloren 2006/47 nenin 18. Mos të shkojë me çelësa politike, sepse do të kemi telashe dhe do të kemi probleme në këtë çështje..

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Kalojmë me votim: Kush është për t'u hequr nga rendi i ditës pika e propozuar nga Qeveria?

Kush është për? Ju faleminderit

A ka kundër, 2 janë kundër. Ju faleminderit.

Konstatoj se kjo pikë hiqet nga rendi i ditës dhe do të propozohet për një seancë të ardhshme.

DEPUTETJA SELVIJE HALIMI – Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë.

Në konsultim me Komisionin për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, këtu ka hyrë pika e 9-të për formimin e Këshillit Kosovar të Ujërave. Ne si komision u pajtuam që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës. Në mungesë të kryetarit, ne u konsultuam ta bëjmë këtë tërheqje dhe arsytet për këtë tërheqje janë:

Edhe pse Këshilli Kosovar për Ujëra propozohet të formohet pas 2 viteve, është dashur vetëm 10 ditë pas aprovimit të Ligjit për ujërat, formohej një këshill që ka obligime këshillëdhënëse për administrimin e ujërave në Kosovë dhe me mandat prej 5 viteve. Përbërja e këtij këshilli, që neve na ka ardhur në Komision nga Ministria e Mjedisit, ka ardhur në formë jo të shkruar zyrtarisht, por ka ardhur nga dy zyrtarë në formë verbale. Ne si komision nuk kemi debatuar për përbërjen e këtij këshilli, andaj duke pasur për bazë mandatin 5- vjeçar dhe përbërjen joadekuate të këtij këshilli për ujërat, ne mendojmë si komision që duhet të tërhiqet sot nga rendi i ditës dhe të shtyhet për seancën e radhës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Propozoj të votohet propozimi i deputetes Selvijs Halimi.

Kush është për? Ju faleminderit.

Kundër, nuk ka. Ju faleminderit.

Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. kryetar. Zotërinj deputetë.

Ngjarjet e 10 shkurtit kanë tronditur jo vetëm opinionin e brendshëm, por edhe atë të jashtëm, kanë shkaktuar reagime nga më të ndryshmet, akuza e kundër akuza. Një palë që akuzon demonstruesit, një palë tjetër që akuzon policinë. Policia ka bërë një komision gjoja për të hetuar atë që e ka bërë vetë dhe ky komision është thënë gati nga të gjithë edhe nga të huajt që është i pabesueshëm, sepse ata që kanë kryer dhunën dhe terrorin e 10 shkurtit nuk mund ta hetojnë vetveten. Prandaj unë mendoj që ky Kuvend nuk është e udhës të heshtë para këtyre fakteve, duhet të ngritë një komision që do ta thotë fjalën e vet për këto ngjarje, për fajtorët që shkaktuan atë masakër dhe ta qetësojë opinionin, sepse opinionin nuk mund të qetësohet me komisione që bën policia për të hetuar vetveten.

Dhe ta thotë fjalën e vet, bile për një pjesë të madhe si 18 vjeçar që janë “dënua drejtësia” dhe po mbahen në burg pa të drejtë, në vend se të shkonin në burg ata që vranë, plagosën dhe dhunuan qindra shqiptarë, banorë, qytetarë të pafajshëm të këtij vendi duarthatë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Ende nuk ka përfunduar procedura e hetuesisë rreth kësaj çështjeje, ne mund ta shfrytëzojmë një të dhënë gojore nga ana e kryetarit të Komisionit për Siguri z. Maloku, por para se t'ia japim fjalën atij do ta marrë fjalën deputetja Gjylnaze Sylja.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryetar.

Desha t'ia tërheq vëmendjen Kuvendit në rregullën 22.7 ku thuhet se diskutimi lidhur me rendin e ditës nuk zgjat më shumë se 2 minuta. Ju lutem z. kryetar ta aprovoni këtë rregull. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju lutem 2 minuta për secilin diskutues.

Vazhdojmë më tutje.

Pika e dytë e rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 8 shkurt 2007, si dhe i transkriptove të 8 dhe 9 shkurtit 2007.

Procesverbali i seancës plenare të datës 8 shkurt 2007 si dhe transkriptet e dt. 8 dhe 9 shkurt u janë shpërndarë të gjithë deputetëve.

Pyes deputetët se a kanë vërejtje në procesverbalet dhe transkriptet e seancës plenare?

Bislimi Hoti e ka fjalën.

DEPUTETI BISLIM HOTI - I nderuari z. kryetar, kryeministër, ministra dhe të respektuar kolegë deputetë.

Kur kam parasysh diskutimin tim të mbajtur në seancën plenare më 9 unë kam vërejtje sepse 1/3 e diskutimit tim nuk është paraqitur në këtë transkript, d.m.th faqe 72 dhe mendoj se vazhdimi i transkriptim nuk ka kurrfarë lidhje me diskutimin tim, andaj kërkoj nga Sekretaria dhe punëtorët përgjegjës që diskutimin tim nuk e kanë të regjistruar unë jam në gjendje t'ju ofroj edhe me shkrim, por nuk lejoj që kështu të mbetet diskutimi im. Mund ta shikoni edhe vetë dhe të cilët kanë pasur rast të më dëgjojnë në diskutim, në faqen 72 se ku ka filluar dhe ku ka mbaruar diskutimi im. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Fetah Berisha.

DEPUTETI FETAH BERISHA – Para se ta them atë që dua ta them ju falënderoj shumë që e keni jetësuar një propozim të kamotshëm dhe tani në pikën e dytë nuk është vetëm miratimi i procesverbalit, por edhe i transkriptit ,sepse transkripti përfshin dhe ngërthen në vete materien e diskutimeve të deputetëve. Po në këtë transkript të kaluar ka aq shumë gabime, seria e gabimeve veç po vazhdon. Ju lutem keni durim se vetëm tri i kam dalluar nga ato. Unë kam thënë për z. Ahtisari se është një diplomat i rryer ndërkombëtar, ndërsa këtu ka dalë .“Është një diplomat i rryer kombëtar”, ndërsa gabimi tjetër është: “Kosova ka përjetuar procese të montuara gjyqësore dhe politike”, këtu ka dalë: “Kosova ka përjetuar qese të montuara”, ndërsa gabimi tjetër është, në vend të fjalës përkon me realitetin, e kanë bërë “kërkon” dhe pyetja e katërt është: Në vend se të thuhet si e kam thënë unë viti 2005: “këtu është thënë emri 2005” Nga të gjitha diskutimet që janë bërë atë ditë me shumicë

janë nga 3 – 4 gabime atëherë ju lutem z. kryetar dhe ata që janë përgjegjës ta ndalin këtë seri të gabimeve shumë të mëdha. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Mbetet që Sekretaria t'i përmirësojë këto gabime. Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Z. kryetar edhe unë e kam një vërejtje në procesverbal. Në faqen 7, kur është diskutuar për shpalljen e 27 prillit ditë e të pagjeturëve, ndër të parët kam qenë edhe unë si diskutuese, ndërsa këtu nuk figuron fare. Me siguri është një gabim dhe kisha kërkuar që të përmirësohet.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ragip Zekolli.

DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI – Edhe unë kam diçka lidhur me transkriptin edhe atë nuk po i përsëris ato që i tha kolegu im më herët, mirëpo vërejtjet me shkrim do t'ia dorëzojë Sekretarisë me kusht që t'i ketë parasysh, janë vërtet gabime të paparashikueshme.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Sekretaria do t'i ketë parasysh këto vërejtje tuaja.

Kalojmë Shkojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 26.1 të Rregullores së punës së Kuvendit koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë e Kosovës është e kufizuar në 50 minuta. Në afate të parashikuar me rregullore janë parashtruar 4 pyetje parlamentare. Pyetjet i janë drejtuar Qeverisë dhe shpërndarë të gjitha me kohë.

Shkojmë me radhë, deputeti Xhevat Bislimi. E ka pyetjen të përsëritur për kryeministrin z. Agim Çeku?

A doni ta sqaroni?

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI - Faleminderit z. kryetar.

Unë i kam dy pyetje për z. kryeministër. Njëra ka kohë që po shtyhet dhe nuk e di se për cilën e keni fjalën tash. Unë mund ta filloj me njërin prej tyre. z. kryeministër Privatizimi në Shtërpc dhe në komuna të tjera me shumicë serbe nuk po bëhet. Privatizimi në Kosovë sipas jush dhe AKM-së është shpresë dhe garanci për ringjalljen ekonomike të Kosovës, por ka fakte të mjaftueshme se procesi i privatizimit është politizuar dhe privatizuar në masë të palejueshme nga AKM-ja, UNMIK-u dhe Qeveria. Kjo dëshmohet edhe me ndalimin e privatizimit të shumë ndërmarrjeve dhe objekteve shoqërore edhe në komunën e Shtërpçës edhe në komuna të tjera me shumicë serbe.

Pyetje?

Çfarë ka ndërmarrë Qeveria juaj për zhbllokimin e këtij procesi në këto komunë?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Z. kryeministër e keni fjalën.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Faleminderit Xhevat.

Siç e dini privatizimi i udhëhequr nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, Agjencioni është në kompetencat e UNMIK –ut. Ne i kemi dy përfaqësues në Bordin e AKM-së që janë zëri dhe ndikimi i Qeverisë në vendimet e Bordit të AKM-së. Kanë qenë disa përpjekje për privatizim të ndërmarrjeve në komunat ku janë shumica serbe. Në vitin 2003 kanë qenë 2 ndërmarrje në Leposaviq – (Albanik) për të cilat nuk ka pasur asnjë ofertues për arsye të paditura, shkaqe politike, nuk ka pasur ofertues dhe ka dështuar dhe ka qenë po në të njëjtin vit në të njëjtën valë privatizimi i Frigoriferit në fshatin Shillovë në komunën e Gjilanit ka pasur vetëm një ofertues dhe ky privatizim ka dështuar. Duke parë se nuk ka interesim dhe mund të shkojnë me një vlerë shumë të vogël këto ndërmarrje AKM-ja dhe bordi i drejtorëve ka vendosur që të pritet pas statusit të bëhet privatizimi i këtyre ndërmarrjeve. Më 15 qershor të vitit të kaluar Bordi i AKM-së ka marrë vendim që të privatizohet kompleksi në Brezovicë, menjëherë pas këtij vendimi ka pasur reagime të qytetarëve dhe të udhëheqësve komunalë të Shtërpcës „duke shantazhuar bordin e AKM-së, AKM-në, Shtyllën e IV të UNMIK-ut që nëse privatizohet kjo ndërmarrje prej se cilës varet ekzistenca e qytetarëve të Shtërpcës, ata do të shpërngulen nga Shtërpca. Ka pasur përpjekje të shumta të të gjithë faktorëve relevantë, duke përfshirë edhe ministrin Dugolli, Bordin i AKM-së që të sigurohen qytetarët serbë që privatizimi është në të mirë të tyre. U është garantuar spinofi special dhe u është garantuar 80% të punonjësve të jenë qytetarë të pakicës serbe, janë garantuar 15 milion investime për 3 vite nga 5 milion dhe të gjitha këto nuk kanë sjell rezultat, por ka pasur ankesa të shumta edhe zyrtare në UNMIK, UNMIK-u vazhdimisht ka insistuar pa marrë parasysh ankesat dhe ankesat kanë shkuar deri në Nju-Jork në Departamentin e Paqeruajtës të Nju-Jorkut dhe Nju-Jorku ka urdhëruar me urdhër ekzekutiv që të ndërprehet më 14 gusht procedura e privatizimit e këtij kompleksi në Shtërpcë derisa të krijohen kushte më të volitshme. Jemi dëshmitarë që kushtet për privatizim janë duke ardhur besoj shumë shpejt dhe do të vazhdohet me përfundimin e privatizimit. Parashihet që të përfundojë brenda këtij viti kryesisht të ndërmarrjeve shoqërore. Kjo është arsyeja dhe natyrisht si Qeveri dhe anëtarë të Bordit të AKM-së nuk pajtohem me këtë. Kemi insistuar, ka insistuar edhe UNMIK-u, por vendimi është marrë në Nju-Jork dhe ka qenë ekzekutiv.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA- Ju faleminderit z. kryeministër. Z. Bislimi keni pyetje plotësuese?

Deputeti Bajrush Xhemajli ka pyetje për kryeministrin Agim Çeku.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI - Faleminderit z. kryetar, përshëndetje për kryeministrin, ministrat, kolegët deputetë.

Z. kryeministër ka kohë që revizori gjeneral ka bërë auditim në AKM dhe kanë kaluar të gjitha afatet që janë të parapara për publikimin e tyre. Kjo ka ndodhur pasi është thënë sidomos në media se ka parregullsi dhe shkelje tepër të mëdha e sidomos në procesin e tenderimit të Feronikelit.

Pyetja është?

Përse nuk bëhet publikimi i këtij auditi për të gjeturat faktike në AKM?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Z. kryeministër e keni fjalën.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Faleminderit z. Bajrush. Siç e dini të gjithë auditi gjeneral është një institucion i pavarur i cili është në kompetenca të plota të PSSP-së dhe vetëm atij i raporton dhe ai është përgjegjës për publikimin e raporteve. Duke ju falënderuar pyetjes së juaj unë jam interesuar për këtë raport dhe kamë marrë garanca që raporti do të publikohet sot, arsyeja shtyerjes është përkthimi, kjo është arsyeja që ma kanë dhënë dhe premtimi i tyre është që të publikohet sot dhe ju falënderoj për këtë se edhe unë dhe të gjithë jemi të interesuar për këtë që raportet të jenë transparente dhe të shihet puna e çdo institucioni, kështu pres që sot të ndodh në Ueb faqen e tyre.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Deputetja Safete Haderxhonaj ka pyetje për kryeministrin Agim Çeku.

DEPUTETJA SAFETE HADERXHONAJ – Faleminderit z. kryetar. Z. kryeministër në shumë hulumtime të bëra kohëve të fundit është konstatuar se problemi kryesor me të cilin përballen qytetarët e Kosovës është shkalla e papunësisë, pasi që numri i punëkërkuësve po rritet nga viti në vit.

Pyetja ime është kjo?

Cilat janë projektet konkrete të Qeverisë që ju drejtoni për këtë vit për gjenerimin e rritjes ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Faleminderit z. Safete për këtë pyetje. Siç e dini ne jemi përcaktuar për një ekonomi të tregut, ekonomi të hapur dhe në ekonominë e tregut Qeveria nuk krijon vende të punës, Qeveria nuk themelon ndërmarrje apo ndërton fabrika dhe i menaxhon ato. Në ekonominë e tregut puna e Qeverisë është ta krijojë një ambient të favorshëm për bizneset dhe një ambient të favorshëm për qytetarët që lirisht të mund të edukohen, e të trajnohen që mund të gjejnë vende të punës të përshtatshme sipas kualifikimit të tyre. Cilat janë ato projekte që ne jemi duke i bërë që ta krijojmë një ambient të favorshëm për rritjen ekonomike? Siç e dini Qeveria është në fazë duke finalizuar dokumentin e quajtur strategji dhe plani zhvillimor i Kosovës i vitit 2007 – 2013, jemi në fazën përfundimtare të këtij dokumenti. Ky dokument ka për qëllim gjenerimin e rritjes ekonomike të Kosovës dhe gjenerimin e punësimit të qytetarëve të Kosovës. Tani për tani ne kemi arritur dhe është e mundshme të kemi rritje ekonomike 2,5 deri 3% dhe me këtë rritje ekonomike neve do të na duhen shumë vite për ta rritur brutoproductin vendor të Kosovës. Me këtë projekt që jemi duke e bërë ne parashohim që rritja ekonomike do të jetë deri në 5% dhe me këtë rritje ekonomike ne brenda 15 viteve do ta kemi dyfishimin e gjidipisë dhe do ta kemi dyfishimin e standardit të jetës së qytetarëve të Kosovës. Ky projekt mbështetet në 3 shtylla.

Shtylla e parë është që t'i ndërtojmë institucionet dhe kapacitetet e nevojshme të institucioneve apo me fjalë tjera ta ndërtojmë një shtet ligjor, një infrastrukturë ligjore e cila do ta krijojë një ambient të favorshëm për biznes dhe investime.

Që ta mbështesim sektorin privat, të investojmë në sektorin privat dhe të investojmë në resurset njerëzore në Kosovë përmes edukimit, arsimit etj.

Ka shumë projekte në këtë drejtim, d.m.th ne parashohim që zhvillimi ekonomik i Kosovës mund të bëhet vetëm përmes këtyre shtyllave, sundimi i ligjit, rendi, infrastruktura ligjore, edukimi, me pasë fuqi punëtore të edukuar dhe kompetitive në rajon.

Infrastruktura. Pa një infrastrukturë nuk mundemi.

Dhe mbështetje në resurset që i kemi, resurset tona janë: gjenerata e re dinamike dhe e talentuar, sektori i energjisë, sektori i bujqësisë, sektori i minierave. Këto janë resurset tona. Ne duke u mbështetur në këto resurse do t'i propozojmë këtij Kuvendi projekte konkrete, ato projekte që gjenerojnë vende të punës.

Në termocentralin Kosova C. Në ndërtimin e këtij termocentrali parashihen të jenë të punësuar afro 3.000 punëtorë, kurse në mënyrë indirekte edhe 5.000 të tjerë, kështu që duke mundësuar investimet përmes privatizimit, duke filluar gjenerimi i ndërmarrjeve të privatizuara ka rënie të punës. U përmend Feronikeli 7.000 punëtorë kanë gjetur punë në Feronikel. Tani do ta kemi shpresoj valën e dytë të operatorit mobil ku parashihet të ketë disa qindra vende pune, kështu që ka projekte të tilla. Krahas këtyre jemi duke negociuar me disa vende evropiane në mënyrë bilaterale për punësim sezonal dhe jemi duke negociuar dhe pritet që gjatë kësaj vere të kemi disa qindra apo mijëra qytetarë të Kosovës në punë sezonale jashtë Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. A keni pyetje plotësuese?

DEPUTETJA SAFETE HADERXHONAJ – Këto që i tha z. kryeministër, janë më tepër si një lloj demagogjie bazuar në kualitetin e koalicionit qeverisës. Me qenë se gjatë periudhës së qeverisjes së koalicionit qeverisës ka ardhur duke u rritur numri i të papunëve dhe duke u zvogëluar numri i njerëzve të cilët janë në punë. Për këto kam edhe shifra.

Kryeministri e din se suksesi i një kryeministri dhe i një qeverie matet edhe me shkallën e uljes apo të rritjes së punësimit. Pyetja ime është:

Sa është numri i të rinjve të shpërngulur nga Kosova gjatë vitit 2005 dhe 2006 në kërkim të një jete më të mirë në vendet tjera?

Kurse sa i përket çështjes së papunësisë kjo Qeveri është dorëzuar para problemit të papunësisë, sepse nuk ka pasur ide, energji, nuk ka pasur gatishmëri për ta zgjedhur problemin e papunësisë dhe për të krijuar parakushte për punësim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Pyetja që i drejtohet Ardian Gjinit nga deputetja Selvije Halimi shtyhet për seancën tjetër për shkak se ministri është në udhëtim zyrtar

Deputetja Safete Hadergjona ka pyetje për ministrin Qemajl Ahmeti.

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ – Z. ministër në të gjitha raportet periodike dhe vjetore të buxhetit të konsoliduar të Kosovës gjatë vitit 2005 dhe 2006 vërehet dukuria e mosshfrytëzimit të mjeteve në vijën buxhetore “shpenzime kapitale” që është një dëshmi se kjo Qeveri ka shënuar një përvojë negative sa i takon realizimit të investimeve publike. Kjo dukuri është e evidente edhe në Ministrinë e Transportit dhe Posttelekomunikacionit. Për mirëmbajtje të rrugëve janë ndarë 8 milion euro në vitin që lamë pas në kategorinë mallra dhe shërbime, e qytetarët përballen me infrastrukturë të dobët rrugore.

Pyetja ime është?

Pse është bërë gërryerja e rrugës në magjistralin Prishtinë – Pejë duke filluar stina e dimrit, ku si pasojë e kësaj gërryerje janë krijuar gropa në rrugë që vozitësve po u shkaktohen dëme materiale, por edhe po rrezikohet jeta e qytetarëve?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Z. ministër e keni fjalën, urdhëroni.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – I nderuari kryetar i Parlamentit, të nderuar deputetë, e nderuara znj. deputete.

Për shkak të deformimeve që kanë ndodhur gjatë vitit të kaluar është dashur të bëhej një intervenim ad-hoc në gërryerjen e saj për të eliminuar pasigurinë në rrugë dhe ajo ka ndodhur, por për shkak të deformimeve të mëdha është se ka qenë rruga e dobët, ka disa gropa dhe po presim në fazën e parë të këtij viti kur të fillojë mirëmbajtja të evitohet. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Keni pyetje plotësuese.

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ- Z. ministër, sa është vlera e mjeteve të paguara për këtë projekt të cilin e keni filluar, me qenë se për mirëmbajtje të rrugëve janë planifikuar 8 milion euro, kurse në 9- muajor të vitit 2006 janë shpenzuar vetëm 4 milion euro, çka do të thotë se gjatë 3 muajve s’kemi mund t’i shfrytëzohim edhe 4 milion euro të cilat kanë mbetur nga buxheti i juaj dhe pyetja ime është:

Sa është vlera e mjeteve të paguara për projekte të filluara dhe të papërfunduara, pra në mënyrë të kundërligjshme, për projekte të vonuara gjatë viteve 2005 dhe 2006 në Ministrinë e Transportit dhe Posttelekomunikacionit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – Nuk kemi të bëjmë me pyetje plotësuese, por kemi të bëjmë me pyetje të re që mund të parashtrohet në procedurë të rregullt dhe mund të përgjigjem edhe pse unë përgjigjen e di. Më duhet të korrigjoj vetëm një statistikë nga buxheti se nuk janë ndarë 8 milion euro për mirëmbajtje të rrugëve, por është 5 milion euro, 2.700.000 kanë qenë obligime dhe prej tyre janë harxhuar në tërësi. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Deputeti Xhevat Bislimi ka bërë pyetje të përsëritur ministrit Agim Veliu.

Ministri Veliu e ka dorëzuar përgjigjen me shkrim, por deputeti do të marrë përgjigje me gojë.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI - Z. ministër ,fjala është për gjendjen e rëndë sipas meje në shkollat e Kosovës. Këto ditë me një grup këshilltarësh komunal kam vizituar disa shkolla në komunën e Vitisë. Jam i tronditur me gjendjen e këtyre shkollave. Jam i informuar se edhe në shumicën e shkollave të Kosovës është e njëjta gjendje. Pastërtia në këto shkolla, kualiteti i ajrit, gjendja e tualeteve dhe mungesa e ujit rrezikojnë seriozisht shëndetin e nxënësve. Në shkolla mungojnë karriget, dërrasat e zeza janë tepër të dëmtuara, dyer e dritare tepër të shkatërruara, mure tepër të dëmtuara, mungesa e arsimitarëve, orë të

humbura, shkolla me drejtorë të kontestuar dhe me konkurse që hapen dhe anulohen për drejtorë janë probleme që pengojnë zhvillimin normal të procesit arsimor.

Ka shkolla z. ministër që nuk plotësojnë asnjë kusht për mbajtjen e mësimit që duhet të mbyllen.

Pyetja?

A jeni ju në dijeni për këtë gjendje? Nëse po, çfarë keni ndërmarrë për përmirësimin e kësaj gjendje në shkollat e komunës sonë, por edhe në shkollat e Kosovës përgjithësisht?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Z. ministër e keni fjalën.

MINISTRI AGIM VELIU - I nderuari z. kryetar i Kuvendit, i nderuar kryeministër, deputetë të nderuar.

Me Ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm Ministria e Arsimit është përgjegjëse për investimet kapitale, pra ndërtimin dhe renovimin e objekteve shkollore, kurse pastërtia në shkolla, mungesa e ujit, dyert dhe dritaret e dëmtuara etj, janë përgjegjësi e komunave të cilave u alokohet buxheti nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në fillim të vitit. Është e vërtetë se hapësira shkollore e pamjaftueshme ende praqet sfidën kryesore të arsimit kosovar, por Ministria e Arsimit po vazhdon me ndërtimin e shkollave dhe renovimin e tyre. Kërkesa për hapësira shkollore vazhdojnë të jenë të mëdha dhe ato vijnë sipas prioriteteve që përcaktohen nëpër secilën komunë. Vitin e kaluar përmirësimi i infrastrukturës ka përfshirë rreth 5.000 m². Mbi 35.000m² janë duke u ndërtuar, ndërsa janë rinovuar e janë duke u rinovuar rreth 7.000m² hapësirë shkollore. Po ashtu dua të theksoj se informacionet nga organet përgjegjëse të arsimit në komunën e Vitisë nuk e paraqesin gjendjen që theksohet në pyetjen e parashtuar. Pavarësisht kësaj ne e dimë se gjendja nëpër disa shkolla në vend nuk është e dëshirueshme, por Ministria e Arsimit ka prioritet zgjerimin e hapësirës shkollore dhe me përkushtim po vazhdon ndërtimin dhe renovimin e objekteve shkollore aq sa lejon buxheti për investime në infrastrukturë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit z. ministër. Z. Bislimi a keni pyetje plotësuese.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. ministër unë nuk e di si e paraqet gjendjen Drejtoria Komunale e Arsimit në Viti, por unë ju garantoj dhe ju mund ta vërtetoni kur të doni se të paktën 100 nxënës sivjet janë të infektuar me verdhza ose sarillëku për shkak të ujit të ndotur dhe të papastërtisë në shkollat e komunës së Vitisë dhe merrni mundin ose dërgoni njerëzit tuaj le ta shikojnë gjendjen e këtyre shkollave, pastërtinë dhe dëmin që u shkaktohet nxënësve, shëndetit të tyre në ato shkolla.

Sa u përket hapësirave shkollore, merreni rastin e fshatit Radivojcë, ku shkolla është djegur tash disa muaj dhe shkoni shikoni se në çfarë kushtesh mësojnë nxënësit e atij fshati. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju njoftoj se pyetjet që nuk marrin përgjigje brenda dy seancave plenare do të botohen në Buletinin e Kuvendit.

Fjalën e ka z. Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Mua më vjen keq, por për procedurë do të flas.
Ne kemi ndërtuar rregulla strikte të procedurës për këto pyetje dhe për këto përgjigje. Unë e mirëkuptoj kryetarin e Kuvendit që don me ju bë qejfin deri në pakufi të gjithëve, por unë e thërras që strikt të punojë me Rregullore. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit, ishte preferimi i kryeministrit për atë.
Kalojmë në pikën e 4-të të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për letërnjoftimin

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 31 janar të vitit 2007. Janë përmbushur të gjitha kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.
Ftoj ushtruesin e detyrës së ministrit për Punë të Brendshme, Blerim Kuçin që ta marrë fjalën.

U.D i MPB BLERIM KUÇI – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë.
Sot para jush ju ofroj një ekspozë lidhur me Projektligjin për letërnjoftimin.
Përmes ekspozëve do të mundohem që sadopak t’jua lehtësoj punën për marrjen e një vendimi që për Ministrinë e Punëve të Brendshme ka të bëjë me një ligj të rëndësishëm. Kjo ekspozë lidhur me këtë ligj përmban një arsyetim të përgjithshëm, po ashtu, përmban një përmbajtje të përgjithshme dhe përmban një informatë lidhur me një përgatitje nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për përgatitjen e prodhimit të dokumentacionit civil, në këtë rast edhe me Letërnjoftimet e ardhshme. Në kuadër të arsytimit për Projektligjin për letërnjoftimin. Nevoja për nxjerrjen e Ligjit për letërnjoftimin është e një rëndësie të madhe, sepse Kosovës i mungon legjislacioni i përshtatshëm i cili i referohet përgatitjes së dokumentacionit civil dhe implementimit të tij pas zgjidhjes së statusit të vendit.
Me këtë ligj, eliminohen zbrastësitë ligjore që kanë të bëjnë me pajisjen e shtetasve të Kosovës me letërnjoftim. Gjithashtu ky ligj eliminon edhe ligjet e aplikueshme, që ishin në fuqi në këtë fazë tranzicioni në Kosovë.

Përmbajtja e Projektligjit

Projektligji ka dhjetë kapituj me gjithsej njëzet e tetë nene, duke filluar me dispozitat e përgjithshme të Projektligjit për letërnjoftimin, me përkufizimin, qëllimin e dhënies, si dhe të drejtën, detyrimin për t’u pajisur me letërnjoftim dhe letërnjoftim të përkohshëm.
Ligji përcakton kompetencën dhe mënyrën e dhënies së letërnjoftimit, organin kompetent për dhënien e Letërnjoftimit, formën dhe përmbajtjen e letërnjoftimit, procedimin, personalizimin dhe prodhimin e letërnjoftimit, shpërndarjen e letërnjoftimit, si dhe përpunimin dhe formën e formularëve për Letërnjoftim.

Po ashtu përcakton afatin e vlefshmërisë së letërnjoftimit sipas moshës:

për 10 vjet,

Për 5 vjet dhe me afat të pacaktuar.

Rastet kur mund të refuzohet kërkesa për lëshimin e letërnjoftimit, për arsye të pacaktuara me ligj, kushtet kur shtetasi duhet të nxjerrë letërnjoftim të ri si dhe rastet kur vlefshmëria e

letërnjoftimit skadon. Projektligji rregullon procedurën e lëshimit të letërnjoftimit shtetasve të Kosovës, mënyrën e paraqitjes së kërkesës për t'u pajisur me letërnjoftim, përmbajtjen e formularëve, afatet dhe mënyrën e lëshimit të letërnjoftimit dhe përshkrimin e rrethanave rreth dëmtimit, humbjes dhe vjedhjes së letërnjoftimit, evidencave, mbikëqyrjes kompetente, si dhe përcakton masat ndëshkuese për shtetasit që nuk i përmbahen këtij ligji, duke u përmbyll me dispozita të fundit.

Projektligji ka formën dhe strukturën standarde që përdoret për legjislacionin e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës, si dhe është në pajtim me Kornizën Kushtetuese dhe Rregulloren nr 2006/26 mbi bartjen dhe transferimin e përgjegjësive në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Për zbatimin e këtij Projektligji, nevojiten mjete buxhetore shtesë një pjesë e të cilave janë të planifikuara në kuadër të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2007 në shumë prej 1.500.000 euro.

MPB-ja përmes grupit të ekspertëve dhe të konsulentëve me firmat profesionale këto ditë do të rekomandojë përzgjedhjen teknike më të mirë për letërnjoftimin e ri, si dhe koston financiare për prodhimin e tyre, mjete këto që duhet të sigurohen edhe nga donatorët.

Shpresojmë në procedimin dhe aprovimin sa më të shpejt të këtij projektligji nga ana e Parlamentit, për të filluar me implementimin e tij dhe pajisjen e shtetasve me dokumentacion të ri.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së fjalën e ka deputeti Agim Krasniqi.

DEPUTETI AGIM KRASNIQI – Faleminderit z. kryetar. Të nderuar ministra, të nderuar deputetë. Do t'i them nja 2-3 fjalë në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së lidhur me Projektligjin në fjalë.

Rreth qëllimeve dhe rëndësisë së këtij projektligji foli edhe ushtruesi i detyrës së ministrit. Desha të them se ky ligj është mirë i përgatitur, është shumë përmbajtësor, sigurisht që ka vend për vërejtje, plotësime dhe ndryshime, mirëpo duke marrë parasysh që sot është në shqyrtim të parë dhe duke marrë parasysh se Komisioni funksional do të merret me këtë projektligj në procedurën e rregullt, do të ketë mundësi që ky projektligj të plotësohet, të ndryshohet dhe të jetë funksional. Për atë në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së ky ligj mund të aprovohet në parim dhe jemi për aprovimin në parim të këtij projektligji.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së deputetja Selviqe Halimi.

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI – Ju faleminderit z. kryetar. Projektligji për letërnjoftimet është në vazhden e projektligjeve që hyn në paketën e projektligjeve të tjera të cilat kanë të bëjnë me rregullimin dhe pajisjen e qytetarëve me dokumente personale. Ajo që është shqetësuese për këtë projektligj është buxheti. Ne nuk kemi informata se a është siguruar buxheti për aplikimin e këtij ligji, Në ligj thuhet nëse Qeveria kërkon që qytetarët e Kosovës të pajisen me letërnjoftime të reja brenda vitit 2007 kemi një kosto të rritur për 27%, pse duhet të rritet kostoja për 27% p.sh kur e njëjta kosto parashihet të jetë brenda 3 viteve dhe pse duhet të rritet nëse kjo parashihet që të jetë në vitin 2007.

Vërejtje lidhur me këtë projektligj kemi në pjesën hyrëse ku paraqiten përkufizimet. Në pikën 5 kemi të dhëna biometrike, ku kemi të bëjmë me sqarime nuk mund të përdorim shprehjen “e tjerë,” siç është rasti: “të dhënat biometrike nënkuptojnë gjurmët e gishtërinjve, fotografia (portreti), gjurmët e syve etj. Duhet të futen të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me biometrinë e jo të mbetet “e tjera”, sepse është një projektligj shumë i ndjeshëm.

Çështja tjetër. Te neni 4.2. të drejtën për t’u pajisur me letërnjoftime të përkohshme, e gëzojnë qytetarët të cilët nuk e kanë të rregulluar çështjen e shtetësisë. Duhet të cekem fillimisht dispozitat e përgjithshme se kur mund të konsiderohet një person që nuk e ka të rregulluar shtetësinë ,sepse këtu kemi të bëjmë me shumë kategori, ata të cilët mund të kërkojnë shtetësinë e Kosovës, pasi Kosova të jetë shtet. Mirëpo e kemi edhe një numër shumë të madh të personave apo të bashkëvendësve tanë të cilët janë jashtë Kosovës dhe të cilët në të ardhmen do të llogariten si qytetarë të Kosovës të numëruar e jo si shtetas sipas të gjitha ligjeve që deri më tash disponojmë, nëse nuk arrijmë të ndryshojmë diçka.

Në nenin 8, te përmbajtja: “letërnjoftimi përmban: mungon se letërnjoftimi personal duhet të përmbajë fotografinë dhe mungon e dhëna se letërnjoftimi personal duhet të përmbajë edhe emrin e njërit prind. Këto parashihen pastaj në formular si kërkesa që i paraqesin qytetarët, mirëpo duhet të jetë shprehimisht e cekur në nen te përmbajtja se çka duhet të përmbajë letërnjoftimi.

Çështja tjetër, të cilën unë kisha dashur ta ngrit, është se ndoshta në të ardhmen Komisioni Funkcional do ta plotësojë te çështja e gjobave apo sanksionimeve. Kemi diskrepancë në mes të veprave të cilat mund të bëhen në rast të mos posedimit të letërnjoftimit, në rast të mos nxjerrjes së letërnjoftimit po që se ajo është dëmtuar, humbur etj me rastin kur një person mund ta keqpërdorë apo e përdor një letërnjoftim të personit tjetër për qëllime përfitimi. Këtu duhet të dallohen këto gjopa ,sepse kur letërnjoftimi i huaj, ajo kalon në vepër penale, gjegjësisht në mashtrim dhe ajo nuk mund të mbetet një dënim deri në 250€ që është shënuar këtu. D.m.th duhet të konsultohet edhe kodi penal dhe i procedurës penale.

Këto ishin disa vërejtje elementare të cilat nuk guxojnë të jetë të lëshuara kur të vjen në amendamentim ky ligj. E përkrahim në parim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Në emër të AAK-së deputeti Naim Maloku.

DEPUTETI NAIM MALOKU – Faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë.

Grupi Parlamentar i AAK-së e mirëpret arritjen e këtij projektligji në procedim në Kuvend në dëgjim të parë dhe konsideron së bën pjesë në pakon e ligjeve që janë shumë të rëndësishme për Kosovën. Mendoj se Ministria e Punëve të Brendshme ka bërë shumë mirë që e ka proceduar në kohë këtë projektligj, në mënyrë që të jetë e përgatitur për dhënien e dokumenteve, pra letërnjoftimeve të gjithë qytetarëve të Kosovës. Ne e mirëpresim në Kuvend të Kosovës edhe Ligjin për shtetësinë ku do të përcaktohen dhe ky Kuvend do të përcakton dhe përkufizon të gjitha kushtet e parapara me ligj që duhet t’i posedojë një qytetar për të marrë shtetësinë e Kosovës dhe Ligji për letërnjoftimet parasheh në një nen ku mund të jepen edhe letërnjoftimet e përkohshme për shtetasit të cilët nuk e kanë të rregulluar shtetësinë, kjo bëhet në të gjitha shtetet e BE-së. Janë konventat ndërkombëtare

që obligojnë shtetet që nuk guxojnë me leju që në territorin e vet të ketë qytetarë pa letërnjoftim dhe brenda këtij projektligji është i paraparë edhe ai nen për qytetarët, gjegjësisht shtetasit të cilët nuk e kanë të rregulluar çështjen e shtetësisë të paraparë me ligjin që do të vijë në Kuvend të Kosovës të pajisen me letërnjoftime të përkohshme. Ligji është i punuar mirë. Lus deputetët e Kuvendit të Kosovës që kanë vërejtje në formë të amendamenteve që sa më parë t'i drejtojnë në Komisionin Funkcional, në mënyrë që sa më parë ky projektligj të vijë në lexim të dytë.

Sa i përket kostos së Projektligjit është mirë e cekur dilema se nëse Qeveria e Kosovës vendos që brenda vitit 2007 të gjithë qytetarët e Kosovës të pajisen me letërnjoftime të Kosovës, atëherë në bazë të këtij ligji normalisht që janë edhe shpenzime shtesë për shkak se duhet administrata e cila bën lëshimin të këtij dokumenti, duhet të rritet përkohësisht për një numër të madh të tyre dhe normalisht që do të ketë edhe shpenzime shtesë, por nëse Ministrisë i jepet afat në bazë të dinamikës që mund të përballojë administrata e Departamentit të Letërnjoftimeve, atëherë normalisht që nuk do të ketë nevojë për shpenzime shtesë. Si do që të jetë për këtë do të vendosin Qeveria dhe Kuvendi i cili duhet gjejë mjete shtesë nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Mendoj në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së që duhet të shkojmë në variantin e dytë që qytetarët e Kosovës të pajisen gjatë vitit 2007 me letërnjoftime.

Lus deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Në emër të Orës deputeti Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Faleminderit z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar përfaqësues të Qeverisë.

Ligjin që e kemi përpara është një ligj shumë i nevojshëm për funksionimin e jetës në Kosovë dhe përgjithësisht është i punuar mirë dhe Grupi ynë parlamentar e përkrah.

Janë disa vërejtje të cilat mendoj se ligjin vetëm do ta pasuronin dhe ato do të përpiqem t'i them, sepse edhe në Komision do të merren sigurisht parasysh.

Në nenin 4, pika 1 kemi që çdo shtetas i Kosovës më i vjetër se 16 vjet është i detyruar të pajiset me letërnjoftim. Mendoj se ekziston edhe praktika evropiane që duhet të shtohet që edhe shtetasit me moshë mbi 10 vjet mund të kenë, duhet t'u jepet mundësia që edhe fëmijët mbi 10 vjet mund të kenë letërnjoftim e posaçërisht kur kemi parasysh mundësinë e lëvizjes vetëm me letërnjoftim përtej kufijve që edhe është e paraparë me anë të këtij ligji dhe telashet që mund të anulohen me një mundësi të këtillë gjatë atij kalimi.

Në nenin 4.2 e kemi një pozicion që e përmendi edhe parafolësi im, të drejtën për t'u pajisur me letërnjoftim të përkohshëm.

Mendoj se kjo çështje duhet të rregullohet me ligj të veçantë, sepse nuk ka mundësi që vetëm me një nen të mbulohet një aspekt i funksionimit të ndërkombëtarëve të ndryshëm që gjenden në Kosovë dhe të cilët kanë të drejtë për letërnjoftim. Po ashtu nuk mund të lihen pa u mbuluar mirë me dispozita edhe aspekti i qëndrimit të azilantëve, të cilët gjenden në Kosovë dhe nuk kanë shtetësi të Kosovës. Prandaj duhet ta keni parasysh se ky ligj duhet të jetë edhe Ligji për letërnjoftimin ndaj shtetasve të huaj dhe kjo mendoj se nuk mund të rregullohet vetëm me këtë nen. Është krejtësisht e pamundshme të rregullohet me këtë nen.

Në nenin 9 kemi formularët dhe letërnjoftimi i shtypur në gjuhën zyrtare të Kosovës, mendoj se duhet të shtypen edhe në anglisht, për shkak të rrethanave dhe kohës në të cilën po jetojmë, kurse te neni 9.2 thuhet se formularët dhe letërnjoftimi shtypen në alfabetin latin. Duhet të shtohet që në përputhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve duhet të shtypen edhe në gjuhët e komuniteteve të tjera në Kosovë, pra konform përdorimit të gjuhëve, sepse nuk mund ta shkelim një ligj duke miratuar një ligj tjetër.

Në nenin 18.1 kemi evidencën, mendoj se duhet të saktësohet se evidenca pasi që është paraparë këtu mbi kërkesat e pranuar, evidenca mbi letërnjoftimet e lëshuara, po duhet të plotësohet edhe evidenca mbi letërnjoftimet e anuluar apo evidenca për letërnjoftimet e shpallura të pavlefshme. Gjithashtu evidencat duhet të definohen në ligj dhe të mbrohen në mënyrën më të mirë të mundshme, duke e ruajtur fshehtësinë e informatës.

Ligji si ligj ka qenë i nevojshëm, është mbuluar me rregullore të UNMIK-ut, por tash duke e pasur parasysh fazën në të cilën po hyjmë mendoj se me përmirësimet që mund t'i bëjmë në Kuvend do të jetë një ligj i mirë për Kosovën. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Në emër të Grupit 6+ deputeti Mahir Jakcilar.

Sayın Başkan, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri

DEPUTETI MAHIR JAKCILAR - Kimlik belgeye ait Yasa'yı dikkatle görüştüğümüzden sonra, maalesef aynı Yasa'nın yurttaşlar ile toplulukların gereksinmelerine uygun olmadığı ve Avrupa Birliği ilçelerine aykırı olduğu görüşüne vardık. Elimizde varolan malzemede Kimlik belgelerine ait Yasa'nın hazırlanmasıyla ilgili Çalışma Gurubu hakkında hiç bahsedilmediği ve aynı zamanda azınlıklar sıralarından hiç kimsenin çalışma gruplarında yer almadıklarına dair eski tecrübelerden hareket ederek, Kosova'nın tüm yurttaşları ve topluluklar üyeleri için bu Yasa'nın oldukça önemli olması yüzünden, sözkonusu Yasa'nın tekrar işlenmesi amacıyla geri çevrilmesini arz etmekteyiz.

AEİ Başkanının düşüncesine göre, Yasa incelemesi, Avrupa Birliği enstitülerinin diğer zorunlu akitlerinden değil, esas olarak Acquis'in genel çerçevesinden faydalanması yüzünden, bu Yasa'nın bir kez daha görüşülmesinin gerekli olduğu görüşündeyiz.

Yasa'nın belirli maddelerini incelerken, dillerin kullanımı açısından bazı hükümlerin Anayasa Çerçevesi ile Dillerin Kullanımına ait Yasa'ya aykırı olduğunu düşünmekteyiz. Bundan ötürü de, 6+ Parlamento gurubu temsilcileri ve KDTP temsilcileri olarak, bu Yasa'nın tekrar işlenmesi amacıyla geri çevrilmesinin ve sözkonusu Yasa'nın yeniden işlenmesi sırasında çalışma gruplarına diğer topluluklar temsilcilerinin de katılmasının gerekli olduğu kanısındayız.

İlginize teşekkürler!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Qibrije Hoxha, kurse le të përgatitet deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETJA QIBRIJE HOXHA – Ju faleminderit i nderuari kryetar, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë

E përsëritës këtë projektligj dhe jam për aprovimin e tij. Ky është një ligj i cili dëshmon se Kosova është e gatshme të funksionojë si shtet me një legjislacion të harmonizuar me

ligjet e UE-së. Megjithatë unë kam disa sugjerime për këtë projektligj. Janë disa pika dhe ato janë: Lëshimi i lejeve për të miturit, konfiskimi i lejeve të njoftimit për të miturit, konfiskimi i lejeve të njoftimit, lejet e përkohshme, si dhe regjistrimi i të dhënave të personave në regjistrin e identitetit pranë organeve të policisë së Kosovës. Megjithatë për këto vërejtje do të angazhohem në Komisionin funksional, anëtare e të cilit jam, por tani desha të ndalem vetëm në njërin prej vërejtjeve ose sugjerimeve të mia e ajo është: lidhur me lëshimin e lejeve të njoftimit për të miturit. Konsideroj se është bërë një lëshim ,sepse duhet të precizohet se lejet e njoftimit për të miturit duhet të lëshohen vetëm në pajtim të prindit ose të kujdestarit në rast të mungesës së prindit.

Siç tha edhe një parafolës imi se mund të ketë raste kur edhe fëmijët edhe të miturit kanë nevojë për leje të njoftimit, kështu që kjo duhet të precizohet që të bëhet vetëm në pajtim me prindin ose me kujdestarin. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi, kurse le të përgatitet deputeti Xhavit Haliti.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë dhe të pranishëm të tjerë.

Bazuar në shumë fakte dhe në shumë arsyetime, identiteti i shtetasit të Kosovës ka qenë më se i nevojshëm, andaj është e domosdoshme dhe është bërë një punë e madhe që sot para nesh kemi Ligjin për letërnjoftimin. Bazuar në këtë çmuj shumë punën dhe kontributin e Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila hartoi dhe na prezantoi në shqyrtim të parë Propozimligjin për letërnjoftimin, për ta plotësuar, gjegjësisht për të dhënë vlerësimet tona. Në parim e përkrahi këtë dhe plotësohet një vakum ligjor. Me zgjidhjet e ofruara arrihen standardet e kërkuara nga Bashkësia Evropiane dhe natyrisht në pajtueshmëri me regjionin lidhur me letërnjoftimin. Por për t'u zbatuar ky ligj kërkohet kërkesë permanente dhe angazhim i departamenteve adekuate të Ministrisë së Punëve të Brendshme në të gjitha nivelet e organizimit për ta dhënë letërnjoftimin në afat sa më të shkurtër të mundshëm ,si dhe obligueshmërinë e çdo shtetasi të Kosovës të moshës madhore që të pajiset me letërnjoftim.

Në këtë drejtim duhet përcaktuar patjetër vlerën e kohës së përdorimit të letërnjoftimit si p.sh. atë dhjetëvjeçar. Në veçanti duhet menduar dhe sanksionuar në këtë ligj mënyrën e pajisjes së qytetarëve të Kosovës me letërnjoftim që kanë ruajtur apo dëshirojnë të ruajnë shtetësinë e Kosovës, ndërsa për shkaqe ekonomike dhe politike në faza të caktuara të historisë sonë kanë qenë të shtrënguar të jenë refugjatë në botë dhe ky numër nuk është i vogël . Kjo vërehet në momentet shumë me rëndësi, në momentet e zgjedhjeve dhe në situatat të caktuara politike dhe të padëshiruara, sepse qytetari i Kosovës, gjegjësisht shtetasi i Kosovës dëshiron këtë ta posedoj, pa duke marrë parasysh a ka dyshetësi apo një shtetësi. Mendoj se marrja për bazë e ligjit slloven për letërnjoftim nuk është edhe aq adekuate, por mund të jetë e pranueshme në këtë fazë. Në veçanti është e domosdoshme që letërnjoftimi të përmbajë simbolet e shtetit të Kosovës për të cilat tashmë është përcaktuar ,por jo në mënyrë **recidive**. Ajo që brengos është fakti se me letërnjoftim patjetër duhet të gjendet adresa e banimit të cilën deri më sot nuk e kemi pasur dhe për të cilën gjyqësia, administrata, Shërbimi Policor dhe institucionet e Kosovës kanë pasur pengesa shumë të mëdha në realizimin e punëve të tyre të përditshme. Pasi që nga Veriu i Kosovës ka shumë të shpërngulur me dhunë nga vendbanimet e tyre, kërkohet që qytetarëve, të cilëve u jepet

letërnjoftimi në adresat e vendbanimeve ku kanë jetuar apo nga janë dëbuar me dhunë dhe jo në adresat ku jetojnë apo ku janë duke jetuar me qira. Edhe një herë ritheksoj se dispozita e nenit 8.2 patjetër duhet të përcaktojë se çdo letërnjoftim në Kosovë, përveç të tjerash, duhet të përmbajë gjithësi dhe në mënyrë të obligueshme adresën e banimit me të dhëna të tjera në harmoni me nenin 16, gjegjësisht me formularin për aplikim. Formulari për letërnjoftim duhet prodhuar nga një person juridik përmes një tenderimi ku do të merrnin pjesë së paku 3 persona juridikë, pjesë e së cilës edhe letërnjoftimi duhet të shtypet në gjuhën e qytetarit që e kërkon, sepse do të shtypej në dy apo tri gjuhë, siç u kërkuar këtu edhe anglisht, jo vetëm se do të kërkoheshin shpenzime, por qytetari nuk dëshiron të mbajë në xhep as gjuhë të huaj, e as formular të huaj, e as alfabet të huaj, prandaj kjo është në kundërshtim pikërisht me ligjin në të cilin u thirrën disa dhe në një ndër kriteret për ndërrimin e lejes së njoftimit është ndërrimi i vendbanimit, andaj adresa e banimit është obligueshmëri që të pajiset letërnjoftimi si dokument që nuk mund të përmbajë adresë tjetër përveç asaj të banimit. Kërkesa për dhënien e letërnjoftimit të ri në bazë të këtij Propozimligji duhet mbështetur në dokumentet e aplikuar fillimisht dhe jo në dokumentet e vjetra siç është ky i UNMIK-ut që e kemi në xhep pa adresë të banimit apo në dokumentet e Serbisë të cilat nuk i posedojmë dhe këto procedura duhet të jenë të kaluara. Dënimet për mos posedimin e letërnjoftimit dhe gjobot e parapara prej 5 deri 200€ janë të larta dhe këto dënime duhet diferencuar, siç u cek më lart, nga keqpërdorimi, falsifikimi apo metodat e tjera të keqpërdorimit të lejes së njoftimit. Mbështetur në këto vlerësime dhe sugjerime mendoj se ky ligj plotëson shumicën, të mos them në tërësi, kriteret e një ligji të mirëfilltë dhe unë e përkrah në tërësi. Ju falënderoj duke qenë këmbëngulës që patjetër ta mbajnë edhe formulari edhe letërnjoftimi adresën e banimit të deklaruar në aplikim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti, kurse le të përgatitet deputeti Nimon Alimusaj.

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Z. kryetar, ministra, kolegë. Së pari do të dëshiroja ta përsërisja ministrin për aktin e tij të lartë të dhënies dorëheqje edhe përkundër asaj që nuk ka pasur mendoj ndonjë të metë, por mendoj se e ka dhënë si akt moral. Kujtoj se është mësim i mirë për ne të gjithë që të dëshmojmë që kur të metat vërehen në terren ne i kemi përgjegjësitë tona politike dhe duhet të ndërmarrim një akt të tillë.

Sa i përket ligjit në fjalë mendoj se është shumë ligj komunist, them i mbështetur në të kaluarën dhe mendoj se nuk na është ofruar një ligj i cili e obligon administratën që t'i shërbejë qytetarit, por e obligon qytetarin të jetë i disiplinuar dhe i obliguar ndaj administratës. Unë mendoj se Ligji për letërnjoftimet sado i mirë në dukje të jetë është i përzemërt dhe nuk mund t'i plotësojë standardet evropiane, për të cilat po flasim pa u kryer regjistrimi i rregullt i popullsisë dhe pa u qartësuar mirë kushtet në bazë të cilave do të bëhet regjistrimi dhe si do të jetë ky regjistrim.

Regjistrimi i popullsisë mendoj që do të duhej t'u besohet organizatave të specializuara dhe të shpallej një tender për krijimin e databexhit dhe serverit i cili do të garantojë regjistrimin e numrit personal të çdo qytetari dhe pas këtij regjistrimi mendoj se do të jetë obligim i administratës që të pajisë çdo qytetar të Kosovës me letërnjoftim. Kjo nuk nënkupton as moshën 10 as 16, por që nga lindja fëmija duhet të pajiset me letërnjoftim, siç veprohet në këto vendet për të cilat po flasim dhe nuk i njohim mirë.

Ligji nëse është vetëm sa për t'i ndërruar letërnjoftimet në fjalë, ndoshta i plotëson kushtet ,sepse po kalojmë nga një gjendje e caktuar administrative në një gjendje tjetër dhe ndoshta do ta konsideroja si letërnjoftim të përkohshëm deri në momentin kur do të regjistrohej popullsia e Kosovës.

Ndoshta në ligj do të duhej të cekem te Ligji për nxjerrjen e letërnjoftimit te masat e sigurisë që janë në letërnjoftim dhe mënyra se si do të prodhohet ky letërnjoftim, do të prodhohet në Kosovë,do të prodhohet me tenderë ndërkombëtarë nga ndonjë firmë e specializuar e cila e vërtet do ta sillte një letërnjoftim për të cilin nuk do të kishte nevojë të dyshojë as administratori e as polici ,sepse me futjen e tij në masën e sigurisë ku do të përdorej ai do të dilte automatikisht se kush është personi dhe nuk do të kishte mundësi që t'i ndërrohej as fotografia as të dhënat, adresa dhe asgjë tjetër.

Pra unë mendoj që administrata e Kosovës në të ardhmen do të duhej dhe duhet të jetë e obliguar që pas lindjes së secilit fëmijë të punohet me urgjencë për krijimin e numrit personal të tij dhe detyrimisht fëmija të pajiset brenda një afati të shkurtër me letërnjoftim pa pasur obligim të ketë fotografi deri në moshën 2 -vjeçare të paktën . Nën 2 mendoj se ky do të duhej të quhej obligim i administratës dhe jo i qytetarit për të nxjerrë letërnjoftimin dhe në qoftë se është obligim i administratës për ta pajisur qytetarin me letërnjoftim dhe ai e humb, e falsifikon dhe ku ta di unë, atëherë besoj se çdo gjë do të jetë e qartë edhe për masat administrative që mund t'i ndërmarrë ligji kundër keqpërdoruesve të letërnjoftimeve dhe kundër atyre që përpiqen që t'i falsifikojnë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka Nimon Alimusaj, kurse le të përgatitet deputeti Xhezair Murat.

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ – Faleminderit z. kryetar. Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë. Unë që në fillim dua të nxjerr konstatimin se ky projektligj meriton lëvdata sa i përket anës formale , siç është teknika legjislative, konciziteti, qartësia, pra një gjuhë që nuk jemi mësuar shumë shpesh në leximin e parë t'i kemi ligjet së paku në versionin shqip të jenë të shkruara shqip dhe për këtë hartuesit e këtij projektligji ,sa i përket kësaj ane, meritojnë lëvdatë. Prandaj që në fillim dua të konstatoj se unë e përkrah në parim këtë ligj si të hartuar mirë për këtë fazë, mirëpo ky projektligj nuk u ka shpëtuar edhe të metave që duhet të kihet parasysh në procesin e mëtutjeshëm Unë për argumentim dua të përmend vetëm një mangësi që vërehet në këtë ligj dhe ajo është se dispozitat e kundërshtojnë njëra-tjetrën.

Në nenet 2.1, 3.1 dhe 16.3 thuhet se: “Letërnjoftimet duhet të përmbajnë edhe adresën ku banon”, qoftë në nenin 2.1 ku jepet përkufizimi i nocionit letërnjoftim, qoftë në nenet e pastajme, kurse në nenin 8.2 kur numërohen elementet që duhet t'i ketë letërnjoftimi, fare nuk përmendet adresa ku banon, d.m.th .vendqëndrimin e tij, nuk **guxon** që një ligj të ketë kështu dispozita që e kundërshtojnë njëra- tjetrën dhe kjo do të ishte e meta kryesore e këtij ligji. Sipas meje meriton të kihet më shumë vëmendje për nenin 3.2, ku thuhet që: “letërnjoftimi mund të shërbejë si dokument udhëtimi për kalimin e kufirit shtetëror në qoftë se kjo është e rregulluar me marrëveshje ndërmjet shteteve”. Ky nen, kjo dispozitë ,do të sillte njëfarë momenti ku duhet të diskutohet se çka do të ndodhë me ata që kanë dyshitetesi a do të respektohen dokumentet p.sh siç është pasaporta etj. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhezair Murat, kurse le të përgatitet deputeti Fetah Berisha.

DEPUTETI XHEZAIR MURAT – Poštovani presedniče. G. Ministri, kolege poslanici, ja sam u prilici da neznam po koji put ponovim nešto što ste čuli a to je prilikom izrade N/Z nešto što je neophodnost, nešto što je minimum zahteva, nešto što zovemo ispunjavanje standarda i dalje se ne poštuje a to je uključivanje u radnim grupama i predstavnika manjinskih zajednica.

Mislím sad se približno u ovom N/Z jednom triku jednostavno se ne navode imena onih ljudi koji rade na njemu, a mi imamo podatke da nije bilo predstavnika iz ostalih zajednica, to je jedna manjkavost koja se ovde provlači dugo i ne znam dokle ćemo ovo da pominjemo.

U sugestijama agencija za evroipske integracije se navodi: „neke odredbe N/Z su nejasne“. Lišne karte, odnosno lične dokumenta se izdaje na službenim jezicima. Ako je lična karta lični dokumenat ono spada u individualna prava, a individualno pravo je kršenje ako mu ne ispunjavamo na jeziku koje imao određeni član, to je jedan propust koji je dovoljno važan da se ovde izrekne jedna opomena o ovom zakonu. S obzirom na to da ovaj N/Z blebira da popuni pravnu prazninu koja postoji u ovoj oblasti, mi smatramo da su propusti koji su već navedeni, dovoljno da se ovaj zakon vrati na ponovno doradu i ja u ime subjekta koji predstavljám, u ime kvalicije VAKAT kažem da ovaj zakon zahtevamo da se uz sve što smo naveli i koje su propuštene vrati na ponovnu doradu. Hvala!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Faleminderit. Fjalën e ka deputeti Fetah Berisha, kurse le të përgatitet deputeti Behxhet Brajshori.

DEPUTETI FETAH BERISHA - I nderuari z. kryetar, të respektuar ju 3 ministra që jeni këtu, të çmuar kolegë deputetë dhe ju që e përcillni këtë seancë.

Sot në këtë seancë të Kuvendit të Kosovës kemi në shqyrtim Projektligjin për letërnjoftimin të përpiluar dhe të paraqitur nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës. Pas kalimit gradual të kompetencave nga ndërkombëtarët te vendorët në Kosovë për herë të parë u themelua Ministria e Punëve të Brendshme, puna e së cilës po shënon suksese pozitive. Ky projektligj natyrisht se ka lidhshmëri edhe me Ligjin për numrin personal, për emrin personal, me Ligjin për familjen, gjendjen civile etj, mirëpo sa do që kanë edhe ngjashmëri me njëri –tjetrin, i kanë edhe specifikat e veta. S’ka asnjë dilemë se Kosova ka nevojë të madhe për këtë ligj ,sepse mungesa e tij krijon vakuum ligjor, prandaj ky ligj është i një rëndësie të veçantë edhe për faktin se interesi i qytetarëve të Kosovës për dokumentin e identifikimit, (letërnjoftimin)është nevojë praktike dhe administrative. Po ashtu rëndësia e tij qëndron edhe në stabilitetin legjislativ në këtë lëmi. Dokumenti i identifikimit më parë ka qenë kompetencë e Ministrisë së Shërbimeve Publike, ndërsa me themelimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme është bërë kompetencë e kësaj ministrie. Ky projektligj në 10 kapitujt e tij ndërthen procedurat e prodhimit të letërnjoftimit, dhënien e formës, përmbajtjen e këtij dokumenti shumë të rëndësishëm identifikues, po ashtu skadimin, afatet, mënyra e lëshimit, format etj. Këto do të realizohen vetëm atëherë kur statusi përfundimtar i Kosovës do të jetë i zgjidhur përfundimisht. Vetëm atëherë qytetarët e Kosovës do të kenë letërnjoftimin e parë me shenjen e shtetit të Kosovës. Natyrisht se ky projektligj nuk është i përsosur, sa do që është bërë përpjekje nga përpiluesit edhe të

përfshihen përvojat e të tjerëve edhe të ketë përputhje me parimet ligjore të BE-së. Unë nuk do t'i përmend ato që i përmendën parafolësit e mi, unë do t'i veçoj vetëm dy momente. Mund të përmendet neni 22, paragrafi 22.1 i cili ma thotë mendja se duhet formuluar më qartë. Po ashtu është e nevojshme të lihet mundësi në këtë ligj për ndonjë udhëzim administrativ. Sidoqoftë Projektligjin për letërnjoftimin të cilin po e debatojmë sot duhet aprovuar në parim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka Behxhet Brajshori, kurse le të përgatitet deputeti Ilaz Pireva.

DEPUTETI BEHXHET- Z. kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë.

Unë çmoj ardhjen e këtij projektligji në Kuvendin e Kosovës dhe e konsideroj shumë të rëndësishëm që sa më shpejtë ta miratojmë, natyrisht nxjerrja e një dokumenti të tillë ka rëndësi për qytetarët e Kosovës në fazën të cilën po hyjmë. Konsideroj se është një ligj mjaft mirë i punuar, përmban elemente që rrumbullakojnë ciklin që prej fillimit të përgatitjes për nxjerrjen e letërnjoftimit nga ana e qytetarit e deri te pajisja e tij me letërnjoftim.

Do t'i them vetëm dy sugjerime të miat. Në nenin 8 nuk parashihet që letërnjoftimi duhet të përmbajë emrin e njërit prind edhe pse në nenin 16 thuhet në formularin të cilin do ta dorëzojë qytetari për marrjen e letërnjoftimit do të përmbajë edhe emrin e njërit prind. Mendoj se letërnjoftimi, megjithatë duhet të përmbajë, përveç elementeve të tjera që parashihen në nenin 8 edhe emrin e njërit prind që do ta pasuronte letërnjoftimin.

Dhe e dyta mendoj se ky projektligj duhet të sigurojë një mekanizëm të veçantë për sigurinë e kualitetit të materialit me të cilin do të punohen letërnjoftimet, duke respektuar procedurat e hapura siç u tha edhe nga kolegët me anë të procesit të tenderimit. Kompania e cila do të marrë përsipër përpunimin e tyre natyrisht në ligj duhet të jetë e sanksionuar që duhet të siguroj atë kualitet.

Dhe e treta që nuk duhet të jetë problem në këtë rast, me të gjitha vështirësitë tona buxhetore. Kufizimet buxhetore do të jenë të përballueshme, sepse Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë një buxhet të tillë. Sa i përket vitit 2007 tashmë janë paraparë mjetet buxhetore nëse fillohet me nxjerrjen e letërnjoftimit dhe natyrisht në procesin e rregullt buxhetor Qeveria do të parashohë edhe mjete të tjera që do të jenë të nevojshme për nxjerrjen e këtij dokumenti tepër të rëndësishëm për qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit, para se t'ia jap fjalën deputetit Ilaz Pireva, ftoj deputetët që nuk gjenden në sallë të kthehen në sallë në mënyrë që të votojmë në parim dokumentin.

Urdhëroni z. Pireva.

DEPUTETI ILAZ PIREVA – I nderuari z. kryetar, të nderuar deputetë.

Edhe unë përkrah në parim Projektligjin për letërnjoftimet, megjithatë kam disa vërejtje:

U kërkua këtu që në letërnjoftime të reja të shënohet vendbanimi. Në këtë aspekt para se të nxirren letërnjoftimet duhet të bëhet një konsolidim i emërtimeve të vendbanimeve. Kemi në këtë aspekt një vështirësi dhe kanë telashe të mëdha ,sepse ende komunat nuk e kanë bërë këtë çështje. Po ashtu pos vendbanimeve, unë konsideroj që duhet të sigurojë edhe

komuna për ata që kanë lindur nëpër fshatra. Gjithashtu duhet të përgatitet stafi me rastin e hartimit të këtyre letërnjoftimeve, sepse ka shumë gabime të cilat pastaj po reflektohen keq edhe në dokumentet e tjera të identifikimit.

Edhe unë pajtohem me atë që kur është fjala të të dhënat biometrike këtu ka dalë edhe gjurmë të syve, unë nuk di sa ka gjurmë të syve, ka gjurmë të gishtërinjve e jo të syve, por duhet të ketë edhe karakteristika të tjera të veçanta për personin, të themi se edhe gjatësia ndoshta duhet të jetë e shënuar aty.

Në nenin 6 thotë se letërnjoftimi i huaj nuk lejohet të keqpërdoret, ndërsa me këtë kuptojmë që i yti mund të keqpërdoret, prandaj unë besoj se komisioni funksional do t'i vërej edhe gjatë punës së tij do t'i eliminoj këto gabime. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Në sallë momentalisht kemi 72 deputet.

Votojmë tash:

Për64

Kundër6.

Miratohet Projektligji për letërnjoftimin.

Në bazë të rregullës 23 pika 7 dhe rregullës 35.4 Kuvendi ngarkon këto Komisione: Komisionin për Siguri, si funksional dhe referues. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese. Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Komunitete. Komisionet duhet që brenda afatit dhe jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Fillojmë me punën. Prezentë janë 64 deputetë. Shkojmë me pikën e 5 të rendit të ditës,

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetësinë publike

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë me datën 11 maj 2006. Komisionet parlamentare të Kuvendit e kanë shqyrtuar, i kanë paraqitur raportet, dhe rekomandimet me amendamente.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore, dhe komisionit për shëndetësi, punë, dhe mirëqenie sociale, si komision funksional raportues në vijim jepet radhitja e rekomandimeve të amendamenteve e tekstit për projektligjit për shëndetësi publike si vijon:

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion, dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për Shëndetësinë e Publike ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozita të Projektligjit për Shëndetësinë Publike dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve kanë vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për shëndetësinë publike dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kryetarja e Komisionit, deputetja Fatmire Mulhaxha e ka fjalën.

FATMIRE MULHAXHA – KOLLÇAKU- Ju faleminderit z. kryetarë, vetëm dy sugjerime në emër të Komisionit funksional. Do të thotë amendamenti i dytë propozojmë që pika X apo x të fshihet, si dhe te neni 22 të mbetet si në Projektligj do të thotë mos ta votojmë amendamentin, por të mbete si në Projektligj. Këto janë dy sugjerime në emër të Komisionit funksional.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Deputeti Ilaz Pireva e ka fjalën.

DEPUTETI ILAZ PIREVA – Edhe unë si anëtar i Komisionit. Kur jemi te amendamenti i dytë, kur është fjala te ypsiloni apo yja si po i thonë: Gjendja e jashtëzakonshme nuk mund të jetë migrimi i popullsisë, por migrimi në masë ose migrimi masiv, po jo vetëm migrimi. Prandaj, këtu duhet të shtohet , kur është fjala për gjendje të jashtëzakonshme, duhet të shtohet fjala” migrime masive” po jo vetëm migrimi gjendje e jashtëzakonshme, kanë shpëtuar.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju lutem kur të vijmë te amendamenti mund të flasim për këtë.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Për.....73,

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2.

Urdhëro, fjalën e ka ministri.

MINISTAR SADIK IDRIZI – G. Fatmira, ako sam razumeo imali ste na ovaj član, pitanje kod x kompletno da se briše, ili ste mislili jer ovde je ono što bi možda trebalo da se briše grupe roma što ne bi odgovaralo, može samo to da se briše ostalo nije toliko diskutabilno u ovom amandmanu a inače ne bi trebalo da bude pomenuto jer ako su siromašni, siromašni su u to kategoriju spadaju, ne može biti po nacionalnom nećemu, mislim možda ste imali dobru namjeru, ne verujem da namera bila loša, ali ovde u ovom zakonu tone može da se stoji jer se kosi sa nekim pravima.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA - Urdhëroni deputete Fatmire.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA –KOLLÇAKU- Ju faleminderit z. kryetar, ai ka qenë një gabim teknik. Përndryshe ka qenë e paraparë për **grupe rinore**, d.m.th. ka qenë një gabim teknik, mirëpo ne u takuam si komision sugjeruam të hiqet, Tash mbetet edhe propozimi i ministrit që mund të qëndrojë, nëse largohet ajo fjali, do t'i mbetet seancës plenare të vendosë a është gabim teknik.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ftoj përfaqësuesin e Komisionit ta definojë tekstin, ta definoni tekstin që tash e keni në aprovim.

FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU – Z. kryetar, unë thashë Komisioni ka vendosur që ta fshijë pikën x apo X, mirëpo është edhe propozimi i ministrit i cili sugjeroi vetëm kjo që ka qenë që ne e kemi vlerësuar gabim teknik, do të thotë të fshihet dhe të mbetet kjo pikë. Mendoj që në këtë rast nuk mund të takohemi serish si komision dhe i keni dy propozime të ministrit. Ta hedhim në votim vetëm çështjen e kësaj pike, përndryshe amendamenti qëndron në gjitha pikat e tjera. Nuk mundem me marrë një vendim në këtë moment unë. Komisioni ka dhënë sugjerim që të fshihet kjo pikë, pika X, ministri propozoi, **kështu që unë.....**

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Atëherë propozimi është që të fshihet fjala: grupet rome. Kalojmë në aprovim të amendamentit me këto vërejtje:

Votojmë tash:

Për.....63,
Kundër..... 2

Miratohet amendamenti nr. 2 me vërejtjet e deputetit Ilaz Pireva.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për..... 68,
Asnjë kundër, kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash.

Për.....67.
Kundër..... 1.

Kalon amendamenti nr. 4

Amendamenti 5

Votojmë tash.

Për.....70
Kundër..... 0

Kalon amendamenti nr. 5.

Lus regjinë që ta shkurtoni afatin në 10 sekonda.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI – Ju lutem para se të votohet me amendamente, mua po më intereson si eksperte ligjore ta pyes Komisionin për Shëndetësi: Cili është justifikimi i fshirjes së neneve komplete 2,3,4,5 nga ligji i propozuar, sepse fshirja e nenit duhet të arsyetohet, domethënë këtu e kemi një dukuri të fshirjes së neneve prandaj është mirë që të na jepni një arsyetim për hir të Kuvendit në tërësi, pse fshihen nenet, pa arsyetim, vetëm thuhet neni 4 fshihet, neni 5 fshihet që është një dukuri normale në legjislacion, por le të jepet për Kuvend.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Neni ka hyrë në procedurë, i kemi 50 vota për dhe një kundër, d.m.th. kemi votuar për të.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Për..... 75

Kundër..... 1,

Kalon amendamenti 7

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Për..... 66

Asnjë kundër, kalon amendamenti

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Për..... 72

Asnjë kundër, kalon amendamenti.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Për.....70,

Asnjë kundër, kalon amendamenti.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Për.....68,

Asnjë kundër, kalon amendamenti.

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Për.....65
Kundër..... 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 13
Votojmë tash:
Për.....65.
Kundër..... 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 14
Votojmë tash:
Për.....68
Asnjë kundër, kalon amendamenti.

Amendamenti 15
Votojmë tash:
Për.....67
Kundër 2
Kalon amendamenti.

Amendamenti 16.
Votojmë tash:
Për.....65
Asnjë kundër kalon amendamenti.

Amendamenti 17
Votojmë tash:
Për.....61
Kundër..... 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 18
Votojmë tash:
Për..... 63
Kundër..... 2.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 19
Votojmë tash:

Deputetja Fatmire Mulhaxha e ka fjalën. Urdhëroni

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU – Kryetar, unë në fillim fola për këtë amendament, do të thotë propozova që neni 22 në emër të Komisionit funksional, të mbetet si në Projektligj, do të thotë bie amendamenti, mbetet si në Projektligj është

propozim i Komisionit funksional Nëse bën vetëm një sqarim të shkurtër për zonjën Nerxhivane. Të gjitha ato që janë përsëritur në ligj dhe që ndërhyjnë në kompetencat e ministrive të tjera janë rregulluar me ligje të tjera ne i kemi fshirë. Nuk kemi bërë intervenime të tjera. Ajo çka është rregullohet p.sh. me Ligjin për ushqimin nuk ka pasur nevojë me hy këtu, ajo ka qenë ku fshihet plotësisht diku neni, ndërsa te ky amendament do të thotë propozojmë që të mbetet neni 22 si në Projektligj.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Fjalën e ka deputeti Fadil Kryeziu.

DEPUTETI FADIL KRYEZIU – I nderuar kryetar, unë po kuptoj që Komisioni po e tërheq amendamentin 19, pra të jemi të saktë në këtë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli.

DEPUTETI LULZIM ZENELI – Qasjen çfarë po e demonstroi Komisioni për Shëndetësi është e gabueshme, por një fakt Ligji për ushqimin nuk ka kaluar në këtë Parlament dhe nuk **mund ta ftojme** në një ligj i cili do ta rregullojë këtë materie derisa s’e ka miratuar Kuvendi i Kosovës Ligjin për ushqim dhe qasja tjetër, çfarë ka demonstruar me kompetenca që synohet të merret një fushe tjetër, kinse nën pikën e analizimit të kualitetit të ushqimit është një qasje e gabueshme. Po e them është e gabueshme për vetë faktin se nuk mund të adresohet një përgjegjësi që nuk i takon qoftë Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik ,qoftë ndonjë institucioni mekanizmi tjetër, prandaj kolegja Nerxhivane pajtohem që pati të drejtë, ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Unë pajtohem me propozimin e Fadil Kryeziut këtu. Këtu jemi në një procedurë në nen konkret, nëse Komisioni njëzëri e tërheq amendamentin, ne nuk kemi çka votojmë, ose bëhet apel që të votohet kundër edhe të kalojmë të mos mbajmë fjalime të kota, ne jemi te 19-tshi, Nëse i gjithë Komisioni që e ka rekomanduar një herë thotë jo ne njëzëri tërhiqemi, ne s’e votomë fare, atëherë votojmë kundër, përndryshe nuk kemi si. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Deputetja Fatmire Mulhaxha Kollçaku

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU – S’ka nevojë domethënë për diskutime dhe diskutanti i mëparshëm, meqenëse ndoshta nuk janë kuptuar qartë, ne mendojmë të mbetet si Projektligj dhe tërheqim amendamentin dhe përfundon diskutimi rreth kësaj çështjeje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Atëherë sipas propozimit të Komisionit konsiderojmë se është hequr amendamenti 19 e mbetet ashtu si ka qenë në Ligj.

Amendamenti 20

Votojmë tash:
Për..... 64,
Kunëdër .. 1.

Kalojnë amendamenti.

Amendamenti 21
Votojmë tash:
Për.....65
Kundër.... 3

Kalon amendamenti.

Amendamenti 22
Votojmë tash:
Për.....71
Kundër.... 1.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 23.
Votojmë tash:
Për.....62
Kundër..... 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 24
Votojmë tash:
Për.....64
Kundër.... 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 25
Votojmë tash:
Për.....64
Kundër..... 3.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 26.
Votojmë tash:
Për..... 67
Kundër.... 1.

Amendamenti 27
Votojmë tash:
Për..... 64
Kundër... 1.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 28
Votojmë tash:
Për.....66
Kundër.. 1.

Amendamenti 29
Votojmë tash:
Për..... 68
Kundër... 2.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 30
Votojmë tash:
Për..... 66
Kundër... 2.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 31
Votojmë tash:
Për..... 67
Kundër... 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 32
Votojmë tash:

Për..... 67
Kundër... 2.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 33
Votojmë tash:
Për..... 66
Kundër... 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 34
Votojmë tash:
Për..... 66
Kundër... 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 34
Votojmë tash:
Për..... 66

Kundër... 3.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 35

Votojmë tash:

Për..... 64

Kundër... 2.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 36

Votojmë tash:

Për..... 65

Kundër... 1

Kalon amendamenti.

Atëherë votojmë për Ligjin në tërësi bashkë me amendamentet e aprovuara.

Votojmë tash:

Në sallë janë 78 deputetë.

Për.....66

Kundër..... 2

Aprovohet Projektligji për shëndetësinë publike bashkë me amendamentet.

Pika 6 e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimet shëndetësore

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 27 janar 2005. Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar dhe të Kuvendit ia kanë paraqitur raportin dhe rekomandimet me amendamente.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues në vijim jepet radhitja e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e Projektligjit për sigurinë shëndetësore si vijon.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për sigurimet shëndetësore e ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese. Komisioni për Buxhet ka konstatuar se dispozitat e Projektligjit për Sigurinë Shëndetësore dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për sigurimet shëndetësore dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kalojmë në aprovimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Për..... 64

Asnjë kundër kalon amendamenti

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Për.....60

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti.

Deputeti Pireva urdhëroni.

DEPUTETI ILAZ PIREVA – Tek amendamenti i 3-të është një përsëritje e pikës p, edhe në faqen tjetër është i njëjti tekst vetëm të konstatohet që, po mendoj të hiqet kur bëhet teksti i spastruem. Dy herë është i përsëritur.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Keni të drejtë me këtë vërejtje, prandaj amendamenti 3 me vërejtjen që e dha deputeti Ilaz Pireva e qes në votim.

Votojmë tash:

Për..... 64

Asnjë kundër kalon amendamenti.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Për..... 59

Kundër..... 2

Kalojnë amendamenti.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Për..... 67

Asnjë kundër.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Për..... 68

Kundër... 1.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Për..... 64
Kundër... 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 8
Votojmë tash:
Për..... 69
Kundër... 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 9
Votojmë tash:
Për..... 71
Kundër... 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 10
Votojmë tash:
Për..... 68
Kundër... 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 11
Votojmë tash:
Për..... 68
Kundër... 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 12
Votojmë tash:
Për..... 68
Kundër... 3.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 13
Votojmë tash:
Për..... 68
Asnjë kundër
Kalon amendamenti.

Amendamenti 14
Votojmë tash:
Për..... 69
Kundër... 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 15

Votojmë tash:

Për..... 66

Kundër... 3.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 16

Votojmë tash:

Për..... 70

Kundër... 1.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 17

Votojmë tash:

Për..... 64

Kundër... 1.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 18

Votojmë tash:

Për..... 66

Kundër... 1.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 19

Votojmë tash:

Për..... 64

Kundër... 2.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 20

Votojmë tash:

Për..... 66

Kundër... 1.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 21

Votojmë tash:

Për..... 63

Kundër... 4.

Kalon amendamenti.

Amendamenti nr. 22, kemi dy propozime. Propozimi i Komisionit FunkSIONAL dhe i Komisionit për Buxhet. Deputeti Fadil Kryeziu e ka fjalën.

DEPUTETI FADIL KRYEZIU – I nderuari kryetar, nëse më lejohet unë do të lloboja tash në këtë rast se në cilësi të deputetit që në amendamentin 22 të përkrahet propozimi i Komisionit për Buxhet. Kujtoj që edhe Komisioni Parlamentar FunkSIONAL do të pajtohet me mua, sepse intenca jonë është që të kemi fondin e veçantë, pra për sigurimin shëndetësor, ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Ftoj kryetaren e Komisionit të deklarohet për këtë.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU – Të them të drejtën për këtë nuk e kam autorizimin e Komisionit, janë dy versione. Unë vetëm mundem personalisht me përkrahë propozimin e Komisionit për Buxhet se intenca ka qenë krijimi i fondit, kështu që në këtë rast nëse deputetët kanë diçka me thënë, mund individualisht me u përcaktu ,por edhe me votuar se cilën bazë asaj si vendos vetë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, Fjalën e ka deputeti Alush Gashi

DEPUTETI ALUSH GASHI – Ju faleminderit z. kryetar ne si grup parlamentar e kemi diskutuar këtë çështje, e kemi pas në dëgjim publik kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa si edhe anëtarët e Komisionit nga radhët tona, Komisionit për Shëndetësi dhe ne jemi të bindur që zgjidhja më e mirë për këtë çështje është 22 b dhe ne do të votojmë për propozime të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, deputeti Bajrush Xhemajli e ka fjalën.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAILI – Ju faleminderit z. kryetar. Edhe ne si Grup Parlamentar jemi konsultuar lidhur me këtë çështje dhe po ashtu edhe ne mendojmë se amendamenti 22 nën b, duhet votuar. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit atëherë kalojmë në votim.

Amendamenti 22 b
Propozimi i komisionit për buxhet
Votojmë tash:
Për..... 70
Kundër 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 23
Votojmë tash:

Për..... 68
Kundër..... 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 24
Votojmë tash:
Për..... 61
Kundër nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 25
Votojmë tash:
Për..... 67
Kundër..... 2.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 26
Votojmë tash:
Për..... 66
Kundër..... 3
Kalon amendamenti.

Amendamenti 27
Votojmë tash:
Për..... 67
Kundër..... 1
Kalon amendamenti.

Amendamenti 28
Votojmë tash:
Për..... 67
Kundër..... 1
Kalon amendamenti.

Amendamenti 29
Votojmë tash:
Për..... 68
Kundër..... 1.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 30
Votojmë tash:
Për..... 68
Kundër..... 2
Kalon amendamenti.

Amendamenti 31

Votojmë tash:

Për..... 67

Kundër..... 3

Kalon amendamenti.

Amendamenti 32

Votojmë tash:

Për..... 61

Kundër..... 2

Kalon amendamenti.

Amendamenti 33

Votojmë tash:

Për..... 60

Kundër..... 4

Kalon amendamenti.

Amendamenti 34

Votojmë tash:

Deputeti Naser Osmani e ka fjalën.

DEPUTETI NASER OSMANI – I nderuari kryetar. Konsideroj që është bërë një lëshim teknik i cili duhet përmirësuar patjetër dhe të jetë kështu: Ky ligj hyn në fuqi pas nënshkrimit nga përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe zbatohet nga viti 2009, jo 2007 si figuron, për arsye se i nevojitet dy vite për me u grumbulluar fonde që të mund të zbatohet . Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka ministri Idrizi.

MINISTRI SADIK IDRIZI – Ovo je nastalo iz razloga što je prilikom prvog čitanja to je bilo još januara 2005. godine i od prilike to se poklapa sa gotovo 2 godine da se pripremi fond i da, znači ovo nije ispravka napravljena što je čekanje dugo. Ja mislim da možda i datumski nije potrebno vezivati za to što postoje člarnovi koji trebaju i ranije da počnu da se pripremaju jer na ovaj način mi imamo formiranje fondova, donošenje zakonski akata, u pojedinim članovima stoji da od potpisivanja zakona u roku od godinu dana fond mora da donese svoje podzakonske akte statut i ostalo, ima od stupanja na snagu član kaže da u roku od 30. dana Ministarstvo treba da formira Odbor i tako dalje. Mislim da bi varijanta koja bila u početku bila bolja varijanta da zakon stupa na snagu od potpisivanja od strane Specijalnog Predstavnik stimo što će jer 12 meseci je potrebno da se formira fond i stoji u zakonu.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Do të ftoja edhe përfaqësuesin e Komisionit Funkcional të deklarohet. Deputetja Gjylnaze Syla e ka fjalën.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA - Ju faleminderit z. kryetar. Konsideroj se më së miri do të ishte të definohet amendamenti 34 kështu: Ky ligj hynë në fuqi pas nënshkrimit nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, nuk mendoj që duhet të vihet ose të specifikohet koha. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Fatmire Mulhaxha

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU – Ju faleminderit z. kryetar. Është e qartë që në fillim në koston e parë financiare që e ka ofruar Ministria e Shëndetësisë mjetet kanë qenë të siguruara për krijimin e infrastrukturës që është për tri vitet e para ,atëherë ka qenë për vitet 2005, 2006, 2007 mjetet kanë qenë të ndara dhe të siguruara.

Do të thotë ajo çka u tha, unë e kisha përkrahur Ministrinë e Shëndetësisë sepse është edhe afati në amendamentin 32 qe 30 ditë duhet , d.m.th. të fillojë infrastruktura së pari dhe gradualisht mbushja e fondit dhe të mos precizohet dy vite ma vonë, por ta shohim do të fillojmë me vënien e bazave dhe kur të mundësohet mbushja e fondit të fillojë edhe implementimi tamam si duhet, si e parasheh ky ligj. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Ju faleminderit, fjalën e ka ministrja Tërmkollli.

MINISTRJA MELIHATE TËRMKOLLI - Shumë shkurtimisht desha një çështje ndoshta teknike. Nuk e di si ka mundësi që Parlamenti me anashkaluar vetveten nga miratimi i këtij ligji, kur unë me sa di e ka një formë e cila është pranuar shumë më herët, që ligjet hyjnë në fuqi kur miratohen në Parlament edhe kur nënshkruhen nga përfaqësuesi. Po e shoh se dy- tri raste kemi këtu vetëm Përfaqësuesin Special, kujt i ka mbetur bash deri te UNMIK-u nuk e di, por unë për vete nuk jam bash ashtu, s’e kisha pranuar një gjë të tillë. Duhet të jetë formulimi, thjeshtë të jetë i miratuar nga Parlamenti i Kosovës dhe mandej me nënshkrim të Përfaqësuesit Special. Dhe ky viti 2007, që në fakt kujtoj që ministri e dha mirë, sepse Ligji mund në pjesë të caktuara me u zbatuar në vitin 2009, por ligji duhet me funksionuar qysh prej tash. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Unë pajtohem me propozimin **tuaj, është** edhe standardi që ligjet të miratohen në Kuvend ,pastaj i nënshkruan PSSP-ja dhe shpallen të plotfuqishme.

Amendamenti 34, me ndryshimet e propozuara. Urdhëroni z. Kryeziu.

DEPUTETI FADIL KRYEZIU - I nderuar kryetar. Unë propozoj që amendamenti 34 të duket kështu: Ky ligj hyn në fuqi pas aprovimit nga Parlamenti dhe nënshkrimi nga PSSP i Kombeve të Bashkuara.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Naser Osmani e ka fjalën.

DEPUTETI NASER OSMANI – Unë kërkoj falje ndoshta nuk është mjaft i qartë, nuk është çështja vetëm me grumbullimin e fondit, me grumbullimin e mjeteve për me filluar zbatimin e fondit z. Ministër, por është një problem tjetër që ka vonuar ligjin deri më tani, e ai është Ligji mbi menaxhimin e financave publike i cili nuk mundëson krijimin e fondeve. Unë e kam dhanë një afat në kuptimin e asaj që ndërkohë mund ta ndryshojmë ligjin në fjalë dhe do të parashihen edhe fonde të tjera, jo vetëm fondi i shëndetësisë, mirëpo ne duhet ta sqarojmë qartë se ky edhe nëse nënshkruhet, nuk mundet me u zbatuar se ky ligj ka të bëjë me fondin edhe fondi nuk mund të krijohet derisa është ligji mbi menaxhimin e financave publike në fuqi. Unë të vetmin kompromis që mundem me e bë këtu me juve z. ministër me bë viti 2008, për arsye se një vit duhet të grumbullohen fondet, ky është kompromisi i vetëm që mund ta bëjmë, viti 2008 të hyjë në fuqi. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Deputeti Bajrush Xhemaili

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAILI – Unë u tërhoqa faktikisht, por meqë m’u dha fjala, sepse duhet të them që deputetin- kolegun Fadil Kryeziu e përkrah, mënyrën e formulimit të thjeshtë, për atë u tërhoqa, por tash vetëm po e përkrah. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Urdhëroni z. Ministër.

MINISTRI SADIK IDRIZI- Ja u potpunosti sfatam predsednika Komisije za budžet za to što se radi, ovaj je zakon je u suprotnosti sa zakonom o menadžiranjem javnih finansijama. Međutim iako se usvoji bez ovoga 2008 i 2009.godina ne znamo kad će biti potpisano od strane specijalnog predstavnika, to je jedna stvar, i druga stvar u samom zakonu je regullisano da u roku od 12 meseci treba da se formira fond da uspostavi infrastrukturu, da donese pod zakonska akta, i navedena su koja, on mora dasvoj statut svoja druga ostala pod zakonska akta da bi počeo da radi znači, mi smo imali planirana sredstva za 2005. godinu u iznosu određenom da bi počeli sa infrastrukturom jer on mora da bude znači, na centralnom nivou na opštinskom nivou da počne da se formira ta infrastruktura to ne može fond odjednom znači mora da se uradi pod zakonska akta da se krene sa tom infrastrukturom da se znači radi, ako bi čekali 2008. godinu onaku na praznu ili 2009. godinu taj fond neće početi ni 2010 ni 2011. godine, o tome se radi, to je samo zbog toga smo mišljenja da se ne precizira godina koja će biti. Kada je bila preciziran kada je urađen prvi Nacrt bilo je rečeno da bude čak da počne taj zakon i ta preporuka rekomandim komisije za zdravstvo bilo je preporučeno 01.01.2005. godine da taj zakon počne sa implementaciju a on nije bio, na prvom čitanju je bio tek u januara januaru 2005. godine. To su od nekih razloga ja potpuno razumem ovo li, mislim da bi trebalo da ide varianta koja bila dosadašnja varianta koja bez amandmana i onda da se krene sa implementacijom, jer ima nešto što je 30. dana a nešto ima rok godinu dana, usvajanje odnosno potpisivanja od strane specijalnog predstavnika. Hvala

XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Ferid Agani

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar, i kuptoj argumentet e kolegëve, vetëm ta kem parasysh se vonesa në fillimin e implementimit të këtij ligji bi drejtëpërdrejt në kolizion me një ligj tjetër që është në fuqi, e ky është Ligji për shëndetësi i Kosovës qysh në vitin 2004 i cili parasheh fillimin e punës të Fondit për Sigurimet Shëndetësore nga 1 janari i vitit 2005. Kështu që unë mendoj se e mbështeti propozimin e deputetit Kryeziu që dhanë edhe disa kolegë të tjerë dhe mendoj se nuk duhet të kemi kufizime kohore dhe do të shohim në procesin e ardhshëm të zhvillimit, të legjislacionit si do ta akomodojmë ma lehtë këto zgjidhje. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Behxhet Brajshori.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – Z. kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra. Është e vërtetë se ne do të kemi problem, që sa më shumë Ligje do ta kundërshtojnë njëri-tjetrin, e tha deputeti Agani dhe formimin e e fondeve vazhdimisht e kemi pasur problem dhe do ta kemi problem edhe në vazhdim derisa të mos ndryshojë Ligji për menaxhimin e financave publike, i cili dorën në zemër nuk varet prej institucioneve ose prej Qeverisë, por sugjerimet janë natyrisht për institucionet financiare ndërkombëtare të cilat e monitorojnë punën tonë. Në përgjithësi them se edhe në këtë do të kemi vështirësi nëse themi: Fillon së funksionuari me aprovimin në Kuvend dhe pas nënshkrimit të Përfaqësuesit Special, sepse fondi si i këtillë nuk mund të fillojë së funksionari.

Ndoshta do të ishte mirë me thënë: Fillon së zbatuari më së voni me 1 janar 2009, kjo do të na ndihmojë që ne të jemi azhur në përgatitjen e infrastrukturës tjetër ligjore dhe të akteve të tjera brenda kësaj periudhe nëse mundemi edhe brenda 6 muajve. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – E kuptojmë arsyen se vërtet në këtë çështje ky ligj bie ndesh me Ligjin mbi menaxhimin e Financave Publike dhe sa kemi njohuri Ministria e Ekonomisë e Financave ka filluar përgatitjet në ndryshimin e këtij ligji dhe në qoftë se është kështu, atëherë edhe t'u pasë parasysh edhe një afat deri në nënshkrimin që do të bëhet nga Përfaqësuesi Special, nëse i vjen radha ta nënshkruajë edhe këtë ligj, atëherë nuk prish punë që të miratohet kështu si u propozua dhe nuk e pengon Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave në zbatimin e Ligjit edhe pas ndryshimeve, sepse këto në një amendament më lartë thuhet “Organizimi i shërbimit profesional bëhet me një akt të posaçëm në pajtim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Por me këtë ndryshim do doja që vërtet të influencohet shumë te ministri i Ekonomisë dhe Financave që ndryshimet në Ligjin mbi menaxhimin e buxhetit dhe përgjegjësitë të bien sa më shpejt në këtë Kuvend. Mos të bëhemi pre ose viktimë e pritjeve dhe shtyrjeve, është shtyrë qe dy vjet ose 3 vjet, tash edhe dy tjera t'i zgjasim për shkak të pengesave në një ligj të caktuar.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Propozoj që t'i përmbahemi këtij teksti. Ligji hyn në fuqi pas miratimit në Kuvend dhe shpalljes ose nënshkrimit të Përfaqësuesit Special.

Votojmë tash:

Për..... 66.

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti.

Ftoj regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin në tërësi të Projektligjit bashkë me amendamentet e aprovuara.

Votojmë tash:

Për..... 68

Kundër..... 1.

Miratohet Projektligji për sigurimet shëndetësore.

Në sallë momentalisht janë 78 deputetë që kanë votuar.

Doni të vazhdojmë më tutje apo të shkojmë në pauzë të drekës. Vazhdojmë.

7. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Hetimor për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës sipas raportit të Auditorit të Përgjithshëm.

Komisioni Hetimor i formuar me vendimin e seancës plenare të datës 3 nëntor 2006 ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës sipas raportit të auditorit përgjithshëm të Kosovës. Raporti u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Ftoj kryetarin e Komisionit që ta marrë fjalën.

DEPUTETI FERID AGANI- I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra, zonja ministre, kolegë deputetë, mysafirë të respektuar.

Komisioni Hetimor për shqyrtimin e të gjeturave faktike në Kuvendin e Kosovës në raportin e auditorit të përgjithshëm të Kosovës i themeluar me vendimin e Kuvendit të datës 3 nëntor viti 2006, e ka përfunduar punën e tij më 31 janar të vitit 2007, brenda periudhës së përcaktuar kohore prej 3 muajve. Në pajtim me mandatin e dhënë subjekti i hetimit ishte periudha kohore 1 korrik 2004, 31 mars 2006, duke përfshirë edhe ngjarjet relevante para dhe pas kësaj periudhe.

Në fillim të punës së tij Komisioni i miratoi Rregulloren e punës, planin veprues me dinamikën e përcaktuar kohore si dhe kornizën metodologjike për shqyrtimi e çështjeve kryesore. Po ashtu e përgatiti edhe një dokumentacion plotësues për mbarëvajtjen e punës së Komisionit i cili është paraqitur në shtojcat e këtij raporti. Puna e Komisionit u mbështet me 25 akte relevante juridike dhe prova përkatëse materiale. Me këtë rast dua të theksoj se në raportin i cili u është shpërndarë ka një lëshim teknik në pikën 3.2.10 që mungon në raport, që njëra prej provave materiale e cila është konsideruar dhe është

shfrytëzuar nga ana e Komisionit Hetimor është edhe vendimi i Komisionit Disiplinor të Kuvendit të Kosovës ndaj katër nëpunësve civilë të Kuvendit, kështu që raporti duhet të plotësohet në këtë pikë si dhe një lëshim tjetër teknik, mungesa në shtojcën 1 të vendimit për themelimin e Komisionit Hetimor, që do t'u shpërndahet të gjithë deputetëve gjatë kësaj seance. Të gjitha vendimet në Komision Hetimor u morën me konsensus dhe me rastin e përpilimit të raportit përfundimtar nuk pat mendime të ndara.

Rrethanë kufizuese për punën e Komisionit Hetimor ishin: Zhvillimi paralel i procedurave hetimore gjyqësore, pra njëkohësisht zhvilloheshin procedurat hetimore gjyqësore dhe atë rreth çështjeve të njëjta si dhe mungesa e fuqisë ligjore të komisionit në mungesë të ligjit për Komisionet Hetimore për t'i detyruar të themi ashtu kushtimisht dëshmitarët që t'i përgjigjen ftesës. Për kundër këtij fakti shkalla e bashkëpunimit të zyrtarëve të Kuvendit dhe jashtë tij me Komisionin Hetimor ishte mjaftë e mirë, me përjashtime individuale. Ftesa për dëshmi me shkrim u është dërguar 26 zyrtarëve të Kuvendit dhe jashtë tij ,prej të cilëve vetëm 4 nuk janë përgjigjur, ndërsa ftesa për dëshmi gojore u është dërguar 9 zyrtarëve prej të cilëve vetëm 3 nuk janë përgjigjur dhe njëri prej tyre me arsyetim.

Lidhur me çështjet kryesore të shqyrtimit Qendrën Protokollare Administrative në Gërmi, veturën e blinduar dhe shpenzimet e lidhura me pagesat e furnitorëve ,paradhëniet, paratë e gatshme dhe mëditjet, Komisioni Hetimor konstatoi se gjatë periudhës kohore që ishte relevante për hetime ishte evidentë dështimi mbikëqyrjes së shpenzimit të buxhetit të Kuvendit nga ana e Kryesisë dhe ish- kryetarit të Kuvendit. Në Kuvend ishte krijuar mjedis organizativ që cilësohej me mungesë të transparencës, tendenca për keqpërdorimin e fondeve publike, veçanërisht nëpërmjet të instalimit të praktikave joligjore në procesin e prokurimit, keqpërdorim të hierarkisë zyrtare ,si dhe në disa raste manipulime fshehje të dokumentacionit zyrtar.

Sipas përfundimeve të Komisionit shkaktarë të drejtpëdrejtë të kësaj gjendjeje ishin: Përvetësimi dhe keqpërdorimi i kompetencave dhe i përgjegjësive në nivelin politik dhe administrativ të vendimmarrjes, tendenca për instalimin e praktikave joligjore në menaxhimin e fondeve publike nga ana zyrtarëve të lartë politikë dhe administrativë të Kuvendit, mungesa e rregullativës juridike që ka rezultuar me mungesën e praktikave pozitive në marrëdhëniet ndërmjet nivelit politik dhe administrativ të vendimmarrjes në Kuvend, papërgjegjësia individuale dhe kolektive në nivelet më të larta të vendimmarrjes politike dhe administrative në Kuvend, mungesa e kornizës së domosdoshme rregullativë dhe të mekanizmave të kontrollit të brendshëm gjatë menaxhimit të buxhetit në Kuvend, veprimi joligjor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik në një rast dhe veprimi joligjor i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave në një rast.

Në këtë aspekt Komisioni Hetimor ka konstatuar se ekziston përgjegjësia politike e ish-kryetarit të Kuvendit, e Kryesisë së Kuvendit në mandatin e parë dhe e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave ,si dhe përgjegjësia administrative e ish- sekretarit të Kuvendit dhe e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Pas zbatimit sistematik të procesit hetimor, Komisioni konstatoi si vijon: Të gjeturat faktike në raportin e auditorit të përgjithshëm të Kosovës janë të sakta, me përjashtim të

referencës përkitazi me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Hidroterm” nga Suhareka e paraqitur në pikën 4.5.1.3 të raportit të auditorit të përgjithshëm.

Kryesia e Kuvendit të Kosovës nuk i ka realizuar përgjegjësitë dhe kompetencat ligjore për mbikëqyrjen e punës së ish -sekretarit të Kuvendit të përcaktuara me rregullën 6.6. të Rregullores së punës së Kuvendit. Ka punuar pa Rregullore të punës së Kryesisë në bazë të së cilës do të zbatonte kompetencat e përcaktuara ligjore me Kornizën Kushtetues dhe me Rregulloren e punës. Nuk ka iniciuar nxjerrjen e rregulloreve përkatëse për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore të Kuvendit. Nuk ka iniciuar nxjerrjen e rregulloreve të cilat do të rregullojnë shpenzimet buxhetore të administratës së Kuvendit. Nuk e ka shqyrtuar mungesën e vendimit politik për ndërtimin e Qendrës Protokollare Administrative në Gërmi gjatë procesit për miratimin e buxhetit të Kosovës të vitit 2004. Nuk e ka iniciuar çështjen e blerjes së veturës së blinduar për kryetarin e Kuvendit. Nuk i ka shqyrtuar raportet periodike të shpenzimeve buxhetore të Kuvendit. Ish- kryetari i Kuvendit nuk ka realizuar koordinimin e duhur të aktiviteteve ndërmjet Kryesisë së Kuvendit dhe sekretarit të Kuvendit, në bazë të Kornizës Kushtetuese dhe Rregullores së punës së Kuvendit. Nuk ka marrë masa për pengimin e zhvillimit të procedurave rreth ndërtimit të Qendrës Protokollare Administrative në Gërmi dhe blerjes së veturës së blinduar, përkundër faktit se për këtë nuk kanë ekzistuar vendimet paraprake të Kryesisë së Kuvendit.

Nuk ka iniciuar nxjerrjen e Rregullores për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore të dedikuara për Kabinetin e kryetarit të Kuvendit, ndërsa në disa raste i ka përdorur këto mjete edhe për qëllime private. Ka përgjegjësi politike për lejimin e veprimeve joligjore të këshilltarit të tij politik dhe të ish -sekretarit të Kuvendit që aktualisht janë nën hetime. Ish- sekretari i Kuvendit nuk ka raportuar në mënyrë të rregullt në Kryesinë e Kuvendit përkitazi me çështjet që ishin objekt i hetimeve, nuk ka iniciuar nxjerrjen e Rregullores së punës së Kryesisë së Kuvendit, si dhe të rregulloreve përkatëse për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore të dedikuara për administratën e Kuvendit dhe Kabinetin e kryetarit të Kuvendit. Në disa raste ka përdorur mjetet buxhetore të Kuvendit për qëllime private dhe këtë e ka lejuar edhe për anëtarët e Kabinetit të ish- kryetarit të Kuvendit , si dhe për një pjesë të stafit në shërbimin civil. Ka nxjerrë vendim jo të ligjshëm të datës 24 mars 2004 për fillimin e procedurave dhe prokurimit për Qendrën Protokollare Administrative në Gërmi, ka ndërmarrë veprime jo ligjore me qëllim të manipulimit të procedurave të prokurimit, veçanërisht përkitazi me qendrën protokollare administrative në Gërmi dhe veturën e blinduar.

Nuk ka realizuar mbikëqyrje adekuate ligjore të zyrtarëve të lartë të administratës së Kuvendit, ka shkelur kodin e mirësjelljes së nëpunësve civilë duke ushtruar presion mbi nëpunësit civilë për realizimin e qëllime personale.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka shkelë dispozitat e Ligjit të prokurimit publik 2003/17 dhe të shtojcës së Rregullores së UNMK-ut nr. 2004/3 të datës 28 korrik 2004 për vazhdimin e mandatit të Organit Rregullator të Prokurimit Publik deri më 1 janar 2005, duke anuluar vendimin e paraardhësit të tij juridik, organit rregullator të prokurimit publik, përkitazi me ankesën e operatorit ekonomik “Hidroterm” dhe duke ia dërguar lëndën në rishqyrtim autoritetit kontraktues të Kuvendit. Ka fshehur dhe nuk i ka zbatuar vendimet

fuqplotë të organit rregullator të prokurimit publik të datës 27 dhjetor 2004 lidhur me ankesën e operatorit ekonomik” Hidroterm” Suharekë.

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave nuk i ka respektuar dispozitat ligjore duke e lejuar pagesën e veturës së blinduar nëpërmjet transferimit joligjor të mjeteve financiare nga vija buxhetore për Qendrën Protokollare Administrative në Gërmi, ndonëse për këtë nevojitet vendimi i Qeverisë së Kosovës.

Nuk ka siguruar zbatimin e vendimit të organit rregullator të prokurimit publik të datës 27 dhjetor 2004 lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Hidroterm.”

Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa, rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa përkitazi me përgatitjen e buxhetit të Kuvendit janë anashkaluar. Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk i ka shqyrtuar raportet e shpenzimeve të mjeteve buxhetore të Kuvendit në mungesë të raportimit të brendshëm.

Mbështetur në përfundimet e paraqitura në mënyrë më detaje Komisioni Parlamentar Hetimor rekomandon ndërmarrjen e masave si vijon. Fuqizimi i rolit mbikëqyrës të Komisionit për Buxhet dhe Financa gjatë shpenzimit të fondeve publike. Mbështetja e Komisionit për Buxhet dhe Financa me ekspertë me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për monitorimin e shpenzimeve të fondeve publike. Informimi i rregullt i Komisionit për Buxhet dhe Financa me raportet përkatëse të Zyrës së auditorit të përgjithshëm dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave në pajtim me ligjin. Hartimi i rregulloreve përkatëse për ekzekutimin e buxhetit të Kuvendit, duke përfshirë politikat dhe procedurat e përmendura në raport në mënyrë më detale. Themelimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm përkitazi me shpenzimin e buxhetit të Kuvendit, duke përfshirë themelimin e organit për auditim të brendshëm në pajtim me ligjin. Përmirësimi i procedurave të brendshme për përpilimin e buxhetit të Kuvendit. Në këtë drejtim duhet siguruar transparencë dhe dialog të hapur në relacionet ndërmjet Departamentit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit, sekretarit të Kuvendit, Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Kryesisë së Kuvendit.

Hartimi urgjent i Rregullores së punës së Kryesisë së Kuvendit, plotësimi i Rregullores për organizimin dhe përgjegjësitë e administratës së Kuvendit me dispozitat që rregullojnë mënyrën e raportimit të rregullt të sekretarit të Kuvendit në Kryesinë e Kuvendit dhe së paku një herë në vit të Kryesisë së Kuvendit në Kuvend. Nxjerrja e Ligjit për Komisionin Hetimor, shqyrtimi i përgjegjësisë në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik përkitazi me anulimin e vendimit të organit Rregullativ të Prokurimit Publik nga pika e 7.4.9 e këtij raporti.

Shqyrtimi i përgjegjësisë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave përkitazi me lejimin joligjor të pagesës nga pika 7.4.10 e këtij raporti. Në kuadër të procesit dhe bartjes së kompetencave nga UNMIK-u në institucionet e Kosovës është e domosdoshme që Kuvendi në procedurë urgjente të nxjerrë Ligjin mbi auditimin e përgjithshëm.

Monitorimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve sipas opinionit të Komisionit Hetimor duhet të jetë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Kryesisë së Kuvendit.

Të nderuar deputetë

Puna e Komisionit Hetimor ishte transparente dhe e hapur për publikun, përveç një seance të mbyllur që kam pasur në fillim të punës sonë. Në fund të punës sonë më lejoni që të konstatoj bashkëpunimin e suksesshëm ndërmjet të gjithë anëtarëve të Komisionit Hetimor, si dhe procesin mjaft efektiv të punës. Shpresoj që Komisioni Hetimor ka hapur rrugën për praktika të ngjashme hetimore në Kuvend të Kosovës dhe me këtë ka kontribuar për fillimin e ndryshimit të gjendjes në kuptim pozitiv. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA- Ju faleminderit!. Deputeti Ramadan Kelmendi ka kërkuar fjalën sigurisht në emër të Grupit Parlamentar, atëherë fjalën e ka deputeti Bajrush Xhemali.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAI – I nderuari z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë ministra.

Që në fillim të fjalës sime në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së dua të shprehni një konsideratë për punën e Komisionit Hetimor që rezulton me këtë raport të saktë dhe të drejtë lidhur me të gjeturat faktike të auditorit të përgjithshëm. Në kohën kur ky Kuvend ka diskutuar raportin në fjalë, shumica nuk i kanë besuar këtyre të gjeturave faktike, aq më tepër ka pasur mendime dhe qëndrime në këtë Kuvend se këto as që mund të ndodhin dhe sipas tyre edhe mund të jenë të shpifura. Fatmirësisht raporti i Komisionit Hetimor që e kemi përpara na i ka hequr këto dilema dhe i ka verifikuar, por jo vetëm që i ka verifikuar të gjeturat faktike në raport të revizorit, por ka hasur edhe në të gjetura të tjera mjaftë të rënda për të cilat auditori nuk ka pasur mundësi t'i verifikojë, nga shkak i fshehjes së lëndëve nga administrata e Kuvendit, si është rasti i dokumentacionit të tenderimit për ndërtimin e Qendrës Protokollare Villa Grmija. Edhe pse si Kuvend dhe aq më parë si Komision Hetimor nuk ka pasur ndonjë përvojë lidhur me çështjet e tilla konsiderojmë se Komisioni e ka kryer punën e vet me një përkushtim dhe profesionalizëm që e dëshmon ky raport dhe kjo është mirë edhe për faktin që ne si deputetë që në radhë të parë si institucion duhet të bëhemi shembull i respektimi të ligjit dhe besimit që na është dhënë dhe ta kthejmë këtë besim në veprimet tona konkrete.

Pa dashur të futemi në çdo pikë të këtij raporti të cilat për Grupin Parlamentar të PDK-së janë të besueshme dhe të argumentuara, do të kërkoja që ky Kuvend të marrë masat e duhura për evitimin të keqpërdorimit të tilla buxhetore dhe të krijojë mekanizma të cilët do ta mbikëqyrin në mënyrë sistematike punën dhe veprimin e secilit institucion veç e veç, por edhe secilit zyrtar në këto institucione. Sipas këtij raporti del se në mënyrë të sinkronizuar kanë vepruar ish- kryetari i Kuvendit dhe ish- sekretari, por gjithnjë me dijen dhe me miratimin e ministrit të Financave në shpenzimin e parave publike pa kritere dhe pa respektuar ligjet dhe sidomos ligjet për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

Sipas të gjeturave faktike të këtij raporti edhe këshilltarët dhe ish- kryetarët dhe sekretarët na dalin si zyrtarë të prokurimit publikë, kjo është e pafalshme dhe dihet se mbi këtë duhet të bie përgjegjësia, fshehja e dokumentacionit dhe provën nga zyrtarët e Kuvendit dhe mosprezantimi i këtij materiali para auditorit të përgjithshëm .Po ashtu përbën shkelje të rëndë që nuk mjaftën vetëm suspendim si masë administrative. E dimë se lidhur me këtë çështje është duke u zhvilluar edhe procedura penale ligjore dhe me këtë rast kërkojmë nga autoriteti i prokurorisë dhe i drejtësisë që këtë çështje ta çojë deri në fund, përndryshe do të bëhet shkelja e dytë më e madhe në lidhje me parandë publike. Raporti po ashtu, konstaton faktin e bartjeve të parasë nga një vijë buxhetore dhe nga një projekt në një projekt tjetër dhe vi tjetër buxhetore pa u respektuar procedurat, që tregon shkeljet e vazhdueshme të ligjit nga ana e ministrit. Është e pafalshme edhe për ish -kryetarin dhe për ish- Kryesinë e Kuvendit që kanë lejuar që pa asnjë vendim paraprak, pa asnjë planifikim paraprak të fillohet me projekte kapitale dhe gjithë kjo vetëm në konsultime jo zyrtare në mes të kryetarit, sekretarit dhe këshilltarit të kryetarit.

Blerja e rrobave, blerja e pajisjeve të kuzhinës të cilat kurrë s'kanë ardhur në Kuvend që në dukje duken shkelje të vogla tregojnë mjaftë dhe verifikojnë në mënyrë të qartë keqpërdorimin dhe keq menaxhimin e parasë publike. Aq më keq kur kësaj ia shton edhe kërcënimet të cilat u janë bërë varësve të tyre për të cilat sipas deklaratave të dëshmitarëve ka qenë i njohur edhe kryetari i Kuvendit. Mënyra e pagesave të mëditjeve, falsifikimi i nënshkrimeve dhe i faturave të cilën gjë e vërteton ky raport ,por edhe raporti që ne nuk e kemi në dorë i Komisionit Disiplinor për zyrtarë të Kuvendit po ashtu tregojnë papërgjegjësinë totale të zyrtarëve të administratës dhe të ish- kryetarit dhe të vetë kryesisë së Kuvendit. E në seancën e kaluar kur është diskutuar raporti i auditorit nga grupi ynë parlamentarë është thënë mjaft e që po i vërteton edhe ky raport që e kemi në dorë. Prandaj, pa dashur të përsërisim gjërat dua të mbështes në emër të grupit rekomandimet e Komisionit Hetimor, duke shtuar se duhet të përcaktohet edhe një përgjegjësi ,qoftë ajo edhe morale për ish- kryetarin i cili ka abuzuar në tërësi me funksionin e vetë edhe për Kryesinë që ka lejuar një abuzim të tillë.

Po ashtu kërkoj që komisionet e tilla hetimore të krijuara nga ky Kuvend të fillojnë hetime sidomos në zyrën e kryetarit të Kosovës për periudhën 2002-2006. Sipas informatave që kemi ,por edhe sipas raportit të auditorit që po mbahen fshehurazi në shumë institucione qeveritare, keqpërdorimi dhe keq menaxhimi i parasë publike është shumë i madh si në Kuvendin e Kosovës. Po ashtu kërkojmë që të vijë para përgjegjësisë dhe ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe posaçërisht Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik për të cilin Komisioni Hetimor ka konstatuar shkelje të rënda ligjore, vetëm kështu ky raport do të ishte i plotë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit!, i nderuari z. kryetar, ministra, të nderuar deputetë. Grupi Parlamentar i Aleancës është i përkushtuar për transparencë dhe llogaridhënie para qytetarëve të Kosovës. Ne vlerësojmë se fuqizimi i mekanizmave të mbikëqyrjes së brendshme të kontrollit të brendshëm është i nevojshëm për të siguruar

funksionimin e mirë të Kuvendit. Prandaj konsiderojmë se Kuvendi i Kosovës me krijimin e Komisionit Hetimor ka treguar pjekuri politike e cila meriton respekt të veçantë. Çështja që ka hetuar Komisioni që kishte të bënte me keqpërdorimet dhe keq menaxhimet në vetë institucionin e çojnë Kuvendin drejtë arritjes së standardeve të larta demokratike dhe të transparencës ndaj qytetarëve të Kosovës. Në këtë kontekst përshëndesim raportin e Komisionit Hetimor për gjeturat faktike nga raporti i auditorit të përgjithshëm. Raporti i Komisionit është i plotë dhe objektiv. Shkeljet janë të ilustruara qartë dhe rekomandimet janë gjithëpërfshirëse, Ky raport me konkluzionet dhe rekomandimet mbështet nga Grupi Parlamentar i Aleancës. Dëshirojmë të theksojmë rekomandimin e bërë nga komisioni që të hartohet korniza ligjore për hetimet parlamentare që përfshijnë Ligjin për Komisionin Hetimor dhe Ligjin mbi auditimin e përgjithshëm. Kjo do të sigurojë në të ardhmen suksesin e punës së Komisionit.

Është me rëndësi që lidhur me rekomandimet e parashtruara të veprohet shpejtë dhe të nxirren procedurat për funksionimin më të mirë të Kryesisë dhe të administratës së Kuvendit. Të njëjtën kohë çmojmë lartë korrektësinë e konstatimeve dhe vullnetin e këtij Kuvendi që të përballlet me fakte dhe dëshirën për funksionimin më të mirë të organeve të saj. Mjetet publike janë mjete që grumbullojnë nga xhepat e qytetarëve tanë dhe këto duhet të shpenzohen vetëm për qëllime publike. Menaxhimi me mjetet publike duhet t'i nënshtrohet procedurave transparente dhe këto procedura duhet të hartohen sa më shpejtë. Këtu duhet çmuar edhe punën e auditorit gjeneral të Kosovës. Kërkojmë që raportet e auditorit të bëhen transparente për publikun. Qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të dinë se si janë shpenzuar mjetet publike. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Ju faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit, ministra, të nderuar kolegë deputetë.

Grupi Parlamentar ORA që nga fillimi, nga shkurti 2005, ka tërhequr vëmendjen për keqpërdorime në buxhetin e Kuvendit dhe ka kërkuar inicimin e procedurave për identifikimin e keqpërdorimeve dhe keqpërdoruesve dhe fillimin e masave për përgjegjësi, transparencë, dhe pengim të veprimeve të tilla në të ardhmen. Me një vit vonesë pra, në shkurt 2006 me 40 nënshkrime dhe përkrahjen e Grupit Parlamentar të PDK-së dhe deputetëve të tjerë të nderuar u arrit që të diskutohet në seancën plenare të Kuvendit për këto keqpërdorime.

Raporti i auditorit për të gjeturat faktike i vërtetoi të gjitha këto makinacione. Përkundër fakteve të pamohueshme edhe përkundër asaj se Rregullorja e punës e lejon formimin e Komisionit Hetimor kishte shumë hezitime dhe pengesa të panumërta për krijimin e këtij komisioni, pasi kjo deri tash nuk ishte praktikë në Kuvendin e Kosovës. Besojmë se në të ardhmen komisionet hetimore do të jenë një rutinë e cila do të ngritë transparencën dhe besimin në institucionet tona. Gjithashtu do t'u dërgohet mesazhi qytetarëve, punëtorëve të administratës dhe zyrtarëve të tjerë për funksionimin e shtetit dhe sundimin e ligjit.

Komisioni Hetimor i cili pasqyron përbërjen e Kuvendit i themeluar me 3.11.2006 përfundoi punën, e cila rezultoi me një raport prej 68 faqesh. Më duhet të lavdërojë zellin dhe përkushtimin e anëtarëve të Komisionit për kryerjen e detyrës së ngarkuar nga Kuvendi.

Në kapitullin V të përfundimit ato verifikojnë saktësinë e të gjeturave faktike të raportit të auditorit, por rekomandimet që pasojnë në kapitullin VI nuk i reflektojnë në masë të mjaftueshme këto përfundime. Posaçërisht e meta e tyre është mungesa e afatizimit kohor për realizimin e këtyre rekomandimeve. Raportimi nga Kryesia, siç është cekur në raport dhe një përcjellje e implementimit të rekomandimeve janë gjëra të cilat mungojnë në këtë raport. Përderisa auditori gjeneral jep vetëm të gjetura dhe faktet Komisioni Hetimor është dashur të japë rekomandime për përgjegjësinë politike, por edhe të propozojë iniciimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë penale për të gjithë të implikuarit në këto keqpërdorime. A do të vazhdojë puna në Qendrën Protokollare Administrative Gërmia apo do të ndalet, a do të redistinohet objekti apo jo, këto janë çështje për të cilat duhet të vendosë Kuvendi i Kosovës.

Po e përsëris edhe një herë se rekomandimet nuk janë në përputhje me të gjeturat faktike të auditorit dhe as me përfundimet tek të cilat ka ardhur komisioni gjatë punës së vet. Prandaj në emër të Grupit Parlamentar ORA kërkojmë që Kuvendi, si organi më i lartë i pushtetit në Kosovë të dëshmojë përgjegjshmërinë para qytetarëve të Kosovës dhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përcaktimin e çfarëdo përgjegjësie të të gjithë zyrtarëve në cilin do rrafsh të qeverisjes të cilët kanë vepruar në kundërshtim me ligjin në fuqi. Përndryshe është e pamundur të pretendojmë që po ndërtojmë shoqëri demokratike të bazuar në ligj ku askush nuk është mbi ligjin. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të Grupit 6+ Hysnija Beshkoviq

DEPUTETI HYSNIJA BESHKOVIQ – Poštovani predsedniče Skupštine, dame i gospodo poslanici.

Kao član Istražne komisije i drugi potpredsednik iste je u ime parlamentarne grupe 6+ ocenujemo da je izveštaj verodostojan suštinski tačan i da je potvrdio nalaze generalnog revizora. Te isti u celosti prihvatamo da cenujući vaše vreme da se ne bi ponovo ponavljalo.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sanije Aliu, le të përgatitet deputetja Nuran Malta.

DEPUTETJA SANIJE ALIU - I nderuar z. kryetar të nderuar kolegë, i nderuar **ministër**. Rezultati i punës së Komisionit Hetimor për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës në raportin e auditimit të përgjithshëm ofron një pasqyrë për një mjedis organizativ jo të përgjegjshëm të cilët i lejojnë vetes komoditet për mosrespektim të rendit shtëpiak mu në vendin që është burim i vendim marrjeve dhe i ligjeve për një funksionim ma të mirë të shoqërisë.

Janë të papranueshme këto hapësira për veprim ngase nuk ndërtohet shteti duke i keqpërdoret mundësitë që ai të ofron, por duke ofruar aftësitë dhe mendjen për ndërtimin e tij. Edhe pse për herë të parë është aplikuar një praktikë e tillë Komisioni ka bërë një punë të mirë duke përcaktuar metodologjinë e punës të cilën e ka bazuar në prova materiale të sakta të cilat janë të konstatuara nga Zyra e auditorit gjeneral dhe komisioni heterogjen i Parlamentit me konsensus të plotë, ku kanë bashkuar dhe deklaratat me shkrim të zyrtarëve me ç'rast ka konstatuar një varg shkeljesh, por edhe përgjegjësitë e këtyre shkeljeve.

Është e vërtetë se po mësojmë të ndërtojmë një Parlament demokratik dhe një administratë funksionale, por nuk di si t'i arsyetojë bartësit e këtyre lëshimeve kurrqysh në start kanë pasur të ditur se në cilin drejtim e orientojnë veprimtarinë e tyre. Komisioni Hetimor ka identifikuar tri çështje serioze për shqyrtim të cilat për ne dhe opinionin janë të njohura.

Unë edhe më parë me rastin e debatit për Qendrën Protokollare kam thënë se jemi në fazën e formimit të shtetit dhe të legjislacionit dhe se ndihet nevojë e madhe për hapësira që do të krijonin kushte për punë të qetë dhe të frytshme të komisioneve parlamentare dhe grupeve parlamentare. Për arsyen e ndërtimit të një objekti në fjalë me siguri mund të them fjalë miradije, por edhe argumentet e kundërta vënë në pikëpyetje të madhe. Në mendjen time shtroj dilemën: si duhet të funksionalizuar ma mirë institucionet tona që është një nga standardet kryesore në të cilin duhet dhënë provimin.

Mbështes rekomandimet e Komisionit Hetimor për fuqizimin e rolit mbikëqyrës të Komisionit për Buxhet dhe Financa për kontrollimin e shpenzimeve të fondeve publike. Por vlerësimi im është se rruga ma e mirë është parandalimi i fenomeneve të tilla përmes mekanizmave të kontrollit të brendshëm, transparencës dhe respektimit të hierarkisë zyrtare. Mos marrja e vendimeve në nivel të institucioneve, për realizimin e projekteve të mëdha **tenda** për keqpërdorim të fakteve publike, manipulimi për fshehje të dokumenteve janë veprime që duhet me i luftuar çdo shoqëri demokratike, e në veçanti ne që po synojmë me e ndërtuar shtetin dhe njohur ndërkombëtarisht.

Delegatë të nderuar, raporti dhe vetë ky debat janë dëshmi se ka shumë çka duhet parandaluar dhe korrigjuar edhe në institucionin pjesë e të cilit jemi ne. Uroj që ky vend i respektuar kurrë të mos shtrojë çështjet e tilla për shqyrtim. E kuptoj se ka qenë start i ndërtimit të institucioneve, se ka munguar rregullativa e domosdoshme, ka munguar auditimi i brendshëm, se transparenca nuk ka qenë në nivelin e duhur, por nuk amnistohet edhe çdo shkelje, sepse ky është një institucion i cili bën ligjet dhe duhet të japë shembullin e respektimit të tij. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Nuran Malta le të përgatitet Fadil Geci, Urdhëroni z. Geci

DEPUTETI FADIL GECI – Ju faleminderit. I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, Debatin e sotëm dhe vetë raportin e Komisionit Hetues e shoh si një cilësi të re të punës Kuvendit të Kosovës ,e cila duhet të vazhdojë me qëllim të përmirësimit të punës të

mbikëqyrjes dhe të kontrollit në funksion të shtimit të efikasitetit dhe të respektimit të ligjshmërisë.

Raporti i bërë nga deputetët e gjithë spektrit politik të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës duhet të miratohet me vërejtje përmirësime dhe konkretizimet që do të bëhen gjatë debatit të sotëm.

Konkluzionet, besoj se të gjithë pajtohemi duhet të jemi në përputhshmëri të plotë me respektimin e kushtetutshmërisë e ligjshmërisë së vendit dhe të Rregullores së punës së këtij Kuvendi. Për të qenë kjo një praktikë e rregullt e kontrollit parlamentar dhe duke respektuar mandatin e deputetit dhe dinjitetin tonë si përfaqësues të mandatarit të popullit dhe duke u thirr në të gjitha konstatimet e komisionit hetimor propozojë.

1. Të shqyrtohet në seancë plenare raporti periodik tremujor financiar të gjitha shpenzimet e Kuvendit duke parë lidhmërinë dhe zbatimin e ligjshmërisë në mandatin e deputetit, sekretarisë së Kuvendit, Kryesisë përkatësisht kryetarit të Kuvendit. Të bëhet paraqitja strukturore e detale e shpenzimeve krahasuara për vitin e kaluar për shkak të krijimit të një opinioni të caktuar medial, por para se gjithash për shkak se është detyrë jona dhe duhet të shihen dhe të krahasohen shpenzimet e zyrove të sekretarit të Kuvendit, të stafit të tij politik dhe administrativ. Kjo jo se është fjala për kabinetin Daci apo Berisha, por sepse kemi të bëjmë raportin tre mujorë të vitit 2004/2005.
2. Të vazhdohet me hetimet për ndërtimin e qendrës protokollare Gërmia. Ky Kuvend ka marrë një vendim për vazhdimin e punëve, ndërsa punët janë ndërprerë dhe afati i dorëzimit në shfrytëzim të objektit ka kaluar edhe përveç pasojave financiare të dëmshme kemi edhe pasoja protokollare dhe mosshfrytëzimin e ambienteve të punës që janë ndërtuar me paratë e taksapaguesve. Konkretisht të raportohet nga sekretari, Kryesia dhe kryetari sot për përgjegjësinë ashtu si janë të përshkruara për udhëheqjen e mëparshme në këtë raport se kur do të lëshohet objekti dhe se a do të humbë Kuvendi në kontekstin gjyqësor në kompani të ndërtimit për mospërbushjen e obligimeve sipas kontratës.
3. Të vazhdohet puna për të raportohet për blerjen e veturës zyrtare të blinduar për kryetarin e Kuvendit. A është bërë padia dhe kundër kompanisë kontraktuese që është dashur të sjellë veturën dhe se a do të ketë përfitime Kuvendi i Kosovës nga kthimi i parave për mos përmbushjen e kontratës dhe për dëmshpërblimin. E dini se mbrojtja e këtyre interesave të Kuvendit është detyrë e sekretarit, e Kryesisë dhe e kryetarit. Mos të na ndodhë të humbim kontestin për kthimin e më shumë se 300 mijë euro për shkak të vonesës së ngritjes së padisë.
4. Të sqarohet se çka është menduar në konstatimin e përgjegjësisë politike për ish - kryetarin dhe Kryesinë e Kuvendit. Përgjegjësia politike nuk është as kategori kushtetuese as ligjore në Kosovë, partitë politike mund ta kenë, por Komisioni Hetues i Kuvendit nuk mund t'ua imponojë.
5. Gjithashtu, se nuk konsiderohen shërbime private, shërbime shëndetësore për tri funksionet më të larta të vendit. Gjithashtu nuk konsiderohen në shfrytëzim për nevoja private blerja e rrobave dhe periudha 6- mujore për stafin politik dhe administrativ të Kuvendit të Kosovës. Këto janë rregulla që vlejné edhe në shtete të

tjera, ose nëse Komisioni mendon se nuk është këtu ta shpjegojë dhe të tregojë se është ndërprerë kjo praktikë. Raporti i Komisionit Hetues është një raport yni dhe ka detyra dhe përkufizime të caktuara dhe nuk mund të shërbejë asnjë provë, asnjë zëvendësim për institucionet dhe organet e tjera. Do të ishte nën dinjitetin e Kuvendit të Kosovës që të përzihet në institucionet e pavarura apo që materiali i tij të tentohet të shërbejë për qëllime të tjera jashtë mandatit të deputetit dhe jashtë mandatit të institucionit më të lartë përfaqësuesve ligjvënës të Kosovës. Përzierja e këtyre çështjeve ashtu si edhe me rastin e përcaktimit të përgjegjësisë politike do të ishte rikthim në sistemet e kaluara moniste dhe jodemokratike. Pra, ndarje e qartë të pushtetit ligjvënës ekzekutiv dhe gjyqësor. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ramë Buja, le të përgatitet deputeti Lulzim Zeneli.

DEPUTETI RAMË BUJA – Të nderuar kolegë deputetë, i nderuar kryetar. Besoj se të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se me këtë veprim me themelimin e Komisionit Hetimor të gjithë pajtohemi se kemi futur cilësi të re për legjislativin tonë që flet për transparencën tonë, megjithëse pak të vonuar, por besoj këtu e tutje të vazhdojë ashtu si duhet. Unë që në fillim dua t'i komplimentoj anëtarët e Komisionit, sepse në leximin që e kam bërë këtij materiali jam ndier mirë t'ju them të drejtën dhe asnjë herë tjetër ndonjë material i ardhur nga nivelet e tilla kuvendare nuk ka qenë më përmbajtjesor, më profesional dhe më logjik, në analizimin e çështjeve të cilat i kanë marrë parasysht. Andaj thjeshtë dua t'i falënderoj të gjithë në veçanti kryesuesin e Komisionit.

Megjithatë ka një mungesë ky raport që unë dua t'ju them me shumë kujtesë sepse mund të jetë harruar, por një vend ku thuhet se janë ofruar dokumentacion- fakte të tjera për Qendrën Protokollare Gërmija, ndërsa mungon diçka që është thënë nga unë në Kryesinë e Parlamentit të Kosovës dhe në seancën parlamentare për veturën e blinduar që në fillim atëherë kur ka filluar të kundërmojë kjo çështje se si është çështja e saj dhe është kërkuar që të sqarohet kjo çështje në Kryesi dhe në seancën Parlamentare. Pastaj kjo çështje është lënë si mungesë dhe kërkoj që pasi të plotësohet ndërkohë **ose....**

Rekomandimet e bëra nga Komisioni për mua janë shumë thelbësore dhe janë shumë domethënëse, gjithsesi duke u plotësuar me këto që i tha shefi i përkohshëm i grupit tonë parlamentar, zëvendësshefi i Grupit Parlamentar të PDK-së z. Bajrush Xhemali, sepse ai kërkon që kjo çështje të vazhdohet të mos mbetet vetëm me kaq, Komisioni Hetimor ose ky ose të tjerë, që mund të themelohen, t'i hyjnë punës për të bërë transparente edhe veprime të tjera të paligjshme në institucionet e tjera të Kosovës, sepse kjo na bën nder, por diçka që dua t'ia kujtoj këtij Kuvendi, kolegëve të mijë të nderuar, një vendim shumë i palogjikshëm jopolitik, hiq pragmatik, absolutisht i suksesshëm e hiq i ndershëm që është bërë në këtë Kuvend për Qendrën Protokollare, vendimi për të vazhduar punimet në mjegull akoma pa ditur se cilat janë sqarimet rreth dokumentacionit, rreth vendimeve, rreth ecurisë etj. etj. Andaj po them mbase këtu ka punë akoma, por puna serioze shumë logjike dhe përmbajtjesore është bërë për këtë çështje, andaj unë edhe një herë ju falënderoj.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli, le të përgatitet deputetja Besa Gaxherri

DEPUTETI LULZIM ZENEL – I nderuar z. kryetar, të nderuar deputetë. Së pari konsideroj se ky debat është i panevojshëm për shumë arsye sot dhe mundësia e një debati të tillë çfarë është ky sot e konsideroj në vazhden e elementeve për të ricikluar tema dhe për të debatuar tema të caktuara të cilat ky Kuvend i ka tejkaluar, të cilat me mëdyshje mund të konstatojmë se mund të vihen vetëm në shërbim të politikave joparlamentare që do ta dëmtonin apo mund ta dëmtonin nivelin e ecjes përpara të punës normale të Kuvendit, prandaj nuk pajtohem dhe e kundërshtoj një qasje të Kuvendit rreth kësaj çështjeje. Ky Kuvend po shtron një temë të tillë për debat parlamentar, thashë për të satën herë dhe nuk është në rregull një gjë e tillë, jo pse Kuvendi nuk duhet të debatohet për çështje të tilla, por janë nevojat reale, por mbi këto tema kur të debatohet dalin në sipërfaqe kalkulimet të cilat aspak nuk i shkojnë nderit dhe dinjitetit të punës së deputetit edhe këtij Kuvendi. Kjo argumentohet edhe në anën tjetër se, në këtë Raport nuk e kemi asnjë element për të cilën mund të krijohen elementet debutuese, nuk dallon prej raportit prej auditimit në esencë, për të cilin ky Kuvend ka debatuar shumë kohë më herët. Krijohet përshtypja se me një qasje të tillë, çfarë ka ky Kuvend dhe po e demonstroi, ky Kuvend do të bjerë, nuk do të thosha lajthitje apo politika të caktuara, qoftë partiake apo jo parlamentare.

Vlerësoj se institucionet kompetente gjyqësore e kanë mandatin për ta kryer punën e vet dhe çdo qasje tjetër për trajtimin e kësaj çështjeje do të ishte joproduktive për vetë Kuvendin dhe për autoritetin e këtij Kuvendi. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri, le të përgatitet deputeti Milazim Haliti

DEPUTETJA BESA GAXHERRI – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë. Në radhë të parë nuk pajtohem me kryetarin e Komisionit se konkludimet në këtë komision janë marrë me konsensus, sepse unë jam anëtare e këtij Komisioni dhe në shumë gjëra kam kundërshtuar, por megjithatë Komisioni ka kryer punën e vet në nivel dhe sot e kemi Raportin përpara.

Edhe një herë, unë sot do ta potencoj se i ashtuquajturit Raport i të gjeturave faktike nuk ka qenë dokument që i përngjan auditimit. Megjithatë, organet e këtij Kuvendi e kanë ngritur këtë çështje në prokurori, që unë t'ju them të vërtetën nuk kam asgjë kundër, sepse jam ithtare se çdo çështje që dyshohet që është shkelur ligji duhet të procedohet në organet kompetente të drejtësisë, por pa u politizuar. Por fatkeqësisht organet e këtij Kuvendi, të cilat këtë çështje e proceduan më shumë për çështje politike sesa ligjore nuk qenë të sigurt se do t'ia arrijnë qëllimit përmes organeve të drejtësisë, gjë e cila u dëshmuar se ish-kryetari Daci nuk ka të bëjë me shpifjet dhe montimet që u bënë, andaj Kryesisë së Kuvendit i mbeti edhe një mundësi që ta formojë një komision hetimor me të cilin po tenton ta dëmtojë imazhin politik të ish-kryetarit Daci.

Unë si anëtare e këtij Komisioni po ndalem në tri çështje të cilat i keni në Raport: Qendrën Protokollare, veturën e blinduar dhe shpenzimet e tjera të lidhura me pagesën e

furnitorëve, mëditjeve e tjera. Në asnjë nga këto tri çështje apo tri pika nuk është përgjegjës i drejtpërdrejtë kryetari i Kuvendit, bile edhe nga rezultatet e Komisionit Hetimor thuhet: mungesë e transparencës, tendencë për keqpërdorim, d.m.th nuk mund të vijmë në konkludim që ka keqpërdorim dhe fjala tendencë nuk ka të bëjë me keqpërdorimin e fondeve publike, veçanërisht nëpërmes instalimit të praktikave joligjore në procesin e prokurimit, keqpërdorim i hierarkisë zyrtare si dhe manipulim dhe fshehjet e dokumentacionit zyrtar, të cilat nuk janë të verifikuara as në auditim e as në këtë Raport.

Unë kam për të shtuar, për ta dokumentuar se kjo çështje është tërësisht politike, e montuar nga njerëzit e caktuar, po e jap këtë shembull: ndërmarrja e cila është zgjedhur për ta vlerësuar apo bërë ekspertizën për punën e Qendrës Protokollare është ndërmarrja INGJ nga Peja, faktikisht në këtë tender të cilin e ka shpallur Kuvendi për ndërmarrjen e cila do ta bëjë vlerësimin, ekspertizën e kësaj ndërtese apo të këtij objekti në të ka konkurruar edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, anëtari i Kryesisë të Kuvendit deputet i subjektit ORA, subjekt që ka ngritur këtë akuzë është Gazmend Muhaxheri, i cili ka konkurruar me firmën e tij AD. U lutem **kamerave**, kjo është licenca e tij, përfaqësues ligjor është Gazmend Muhaxheri, ndërsa udhëheqës teknik i ndërtimitarisë të kësaj kompanie është Kenan Krasniqi.

Të nderuar deputetë, edhe kolegu, shoku i tij i ngushtë, sepse unë i njoh, jemi vendas këta janë edhe shokë të pandashëm. Kanë konkurruar Kenani me firmën e tij, d.m.th. me firmën INGJ dhe një firmë tjetër gjithashtu nga Peja, që të trijat janë nga Peja, që të tretë janë marrë vesh me çmimet e përgatitura dhe tenderin e fiton z. Kenan Krasniqi me të cilin ua dokumentoj, shikoni kjo është: Kenan Krasniqi, pra është teknik në ndërmarrjen e z. Gazmend, ndërsa këtu fiton tenderin për ta vlerësuar. Kjo do me thënë është tërësisht konflikt i interesave dhe një gjë e kisha pasur për të shtuar se kjo ndërmarrje është në adresë këtu shkruan: adresa është Pejë, ndërsa kjo ndërmarrje nuk është e regjistruar në Pejë. Kjo ndërmarrje është e regjistruar në Prishtinë, vepron këtu dhe kisha pasur për të shtuar se kjo ndërmarrje ia ka 12.000 euro borxh Administratës Tatimore për vitin 2004, të cilat nuk i ka paguar. Unë e pyes Kuvendin dhe a ka ofruar certifikatë nga Administrata tatimore kjo ndërmarrje dhe a e dini se ka qenë borxh shtetit dhe sa ka pasur aftësi për të bërë një vlerësim të tillë. Përveç kësaj, që nuk është as morale e as ligjore, sepse edhe punëmarrësi është dashur ta ketë një vlerësues të vetin edhe punëdhënësi në këtë rast Kuvendi dhe natyrisht, se kjo çështje duhet të shkojë në gjyq, e jo të lëshohemi dhe të merret Komisioni hetimor me çështje shumë, shumë profesionale dhe konkrete. Megjithatë, kjo nuk donë koment, e tëra kjo është e përgatitur dhe, më falni subjekti politik ORA është një subjekt shumë i vogël ose jo relevant, por megjithatë për të bërë punë të tilla, për të ngritur çështje politike deri në këtë masë, që në të vërtetë Kuvendi, deputetët e këtij Kuvendi janë lodhur më me këtë temë, i ka ndihmuar natyrisht subjekti i Lidhjes Demokratike sepse nuk ka pasur mundësi të bëhet kaq histori kjo.

Unë po e shtoj se Kryesia e Kuvendit pra ia ka dhënë mundësinë anëtarit të Kryesisë së vet të bëjë një vlerësim, dhe kjo nuk donë koment, kjo vërtetë është edhe qesharake.

Sipas Komisionit Hetimor i cili nuk e ka peshën ekspertëve, por kryesisht atë politike konstaton se të gjeturat faktike rezultuan nga: Kryesia e Kuvendit, nga kryetari i Kuvendit, nga ish sekretari i Kuvendit, nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa. Ju lutem shumë, nga kjo shihet se ka shkelje, dhe unë pranoj se ka shkelje të procedurave, ka pasur

atëherë kur vërtetë na ka munguar legjislacioni, por ka edhe sot, por tjetër është shkelja e procedurave tjetër është: korrupsioni, tjetër është manipulimi me qëllim, pra unë duke u bazuar, duke kaluar mbi të gjitha këto institucione ose është fatale për Kosovën që janë të implikuara 6 institucione dhe bëhet korrupsion ose kjo nuk do shpjegim, është tërësisht e pa vërtetë dhe tërësisht politike.

Pyes këtë Kuvend ose juve Z. kryetar, por të më përgjigjeni sot. A e keni hartuar ju Rregulloren për shpenzimin e 8 milion euro të cilat janë ndarë për Grupin Negociator apo të Unitetit siç po e quani për vitin 2006? Çfarë kriteresh janë caktuar për shpenzimin e këtyre mjeteve? Pse nuk alarmohet kjo çështje, po e them unë sepse në grup janë të gjithë liderët e subjekteve, të gjithë d.m.th. të partive më të mëdha të subjekteve politike dhe shefat e institucioneve. A nuk është keqpërdorim i këtyre mjeteve ku në emër të këtij grupi udhëtojnë jashtë Kosovës njerëz me dhjetëra sikur të ishin duke shkuar në ekskursion, ku anëtarët e këtij grupi marrin mëditje të vlerës marramendëse, që pres të më jepni ju përgjigje sot sa është shuma e mëditjeve të Grupit Negociator? Kur grupet punuese në krye me liderët e caktuar nuk ju pëlqen që t'i mbajnë takimet në Kosovë, por për të qenë më komod herë shkojnë në bregdetin e Durrësit e herë në atë të Antalisë. A thua këto mjete nuk qenkan të qytetarëve të Kosovës, ndërsa bëhet fushatë historike për takimet e ish kryetarit të Kuvendit brenda Kosovës, si në Brezovicë dhe i llogariten shpenzimet se çfarë kanë pirë në këto takime, kjo vërtetë është ironi e jetës apo siç thotë populli mos u bësh me të qajtë Rahoveci. Sido qoftë bile nëse doni ju jap edhe fakte tjera. Është ndërtesa përballë Kuvendit, ndërtesa e Qeverisë e cila ka pasur konstruksionin dhe përmbi këtë 13 milion e gjysmë janë investuar në këtë objekt dhe asnjëherë nuk dihet si janë shpenzuar ato mjete dhe në çfarë forme janë shpenzuar ose objekti i Ministrisë të Arsimit e cila Ministri aktivitetin e vet e kryen në një shtëpi private, e cila nuk ka leje të ndërtimit, janë dhënë mjetet, janë dhënë mjetet dhe ky objekt ende është vetëm në themelet e saja dhe shumë shembuj të tjerë, megjithatë edhe sot keni mundësinë që të merreni me këtë çështje, por ju kisha lutur që ta ndërrojmë mentalitetin e politikanëve të mos t'i personalizojmë gjërat, të mos merremi me gjëra shumë të imëta e mos t'i shohim gjërat shumë të dukshme, që janë të rrezikshme e të dëmshme, që j si për shembull në këto momente historike kisha thënë e dramatike për Kosovën. Ky Kuvend të humbë kohë për çështje të cilat janë organet kompetente që duhet të bëjnë punën e vet, d.m.th. nuk kemi nevojë më të merremi me këtë çështje kur vërtet janë organet kompetente, ndërsa ne më mirë është që të kishim sot në rend të dite çështjen e sigurisë në Kosovë, të arsimit ose të shëndetësisë.

Krejt në fund z. kryetar, në bazë të cilit ligj kërkoni që t'i merrni njerëzit në përgjegjësi, pra po e përmbylli, por vërtet më intereson se në bazë të cilit ligj kërkohet që t'i marrim njerëzit në përgjegjësi politike. Po jua përkujtoj se tani po jetojmë dhe po veprojmë në sistemin demokratik e jo atë komunist. Në demokraci ose je fajtor ose nuk je. Ka përgjegjësi politike, nuk ka përgjegjësi politike për keqpërdorime financiare. Ju faleminderit,

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Për replikë është paraqitur Gazmend Muhaxheri

Kërkoni fjalën, kur vjen radha. Milazim Haliti e ka fjalën, le të përgatitet deputetja Teuta Hadri

DEPUTETI, MILAZIM HALITI - Ju faleminderit z. kryetar që kësaj radhe ma dhatë fjalën për dallim nga seanca e 9 shkurtit, që nuk ma dhatë fjalën për diskutim. Të nderuar deputetë, nuk është hera e parë që po e shqyrtojmë Raportin për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës. Edhe më 3 nëntor të vitit 2006, është shqyrtuar ky Raport, atëherë si Raport i Zyrës së auditimit, e kësaj radhe i Komisionit Hetimor. Që në fillim të raportit vërehet se Komisioni Hetimor ka hetuar periudhën 1 korrik 2004, 31 mars 2006 dhe është përqendruar në tri çështje kryesore: Qendrën Protokollare Administrative në „Gërmi”, veturën e blinduar dhe shpenzimet e tjera të lidhura me pagesat e furnitorëve, paradhëniet, paratë e gatshme dhe mëditjet. Dihet mirëfilli se për këtë raport është shkruar në detaje dhe të dhënat e këtij raporti janë bërë publike edhe nëpër gazetat ditore. Pastaj ky raport u është shpërndarë deputetëve për diskutim, por edhe është formuar Komisioni Hetimor dhe krahas punës së Komisionit është zhvilluar edhe procedura hetimore nga organet gjyqësore për çështje të njëjta. Sipas parimit askush mbi ligjin, duhet të përgjigjen para organeve të drejtësisë të gjithë ata që e shkelin ligjin dhe që e keqpërdorin pozitën zyrtare, por me këtë rast do të ishte më mirë që së pari gjykata ta thotë fjalën e vet për këto çështje hetimore, ndërsa në të kundërtën jo rastësisht fuqishëm po punohet me debate të shpeshta në Kuvend për përcaktimin e fajësisë dhe të përgjegjësisë politike e në fakt kjo përgjegjësi politike ende pa u konstatuar është ndërmarrë në shumë raste.

Gjatë punës Komisioni Hetimor paska konstatuar se ekziston përgjegjësia politike për kryetarin e Kuvendin akademik Nexhat Daci që tani nuk është më kryetar, pastaj për Kryesinë e Kuvendit, për Ministrinë për Ekonomi, Financa, ish- sekretarin e Kuvendit dhe Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, që del konstatimi se të gjithë ata që kanë punuar në Kuvend paskan përgjegjësi politike. Përveç konstatimeve të Komisionit Hetimor, herë- herë Komisioni gjatë punës është lëshuar edhe në disa çështje të parëndësishme duke tentuar që me çdo kusht ta fajësojë ish- kryetarin e Kuvendit, siç përmendet rasti në faqen 59 të Raportit, pika 25 (f) ku pyetet ish- kryetari i Kuvendit se, citoj: “A keni qenë të njoftuar për të gjeturat faktike për mirëmbajtjen e kopshtit të Kuvendit” thua se kryetari i Kuvendit nuk ka pasur punë të tjera më të rëndësishme, por të kujdeset edhe për mirëmbajtje të kopshtit të Kuvendit, se a është paguar apo sa herë është paguar kontraktori etj. dhe kjo konsiderohet si njëra nga faktet e gjetura të Komisionit Hetimor e që nuk donë shumë koment, që kjo se Komisioni Hetimor angazhohet që me çdo kusht të ngarkojë ish- kryetarin.

Sa u përket shpenzimeve buxhetore për pozicionin e kryetarit të Kuvendit, është me rëndësi të theksohet se mjetet e parapara për pozicionin me buxhet nga mjetet e parapara për vitin 2005, janë shpenzuar vetëm 15% të mjeteve që janë paraparë e që dëshmon qartë se sa kanë qenë racionale shpenzimet e ish- kryetarit të Kuvendit. Komisioni Hetimor me vend e ka dhënë konstatimin se është i domosdoshëm fuqizimi i rolit mbikëqyrës të Komisionit për Buxhet dhe Financa gjatë shfrytëzimit të fondeve publike dhe se ky komision duhet rregullisht të informohet me raportet e auditorit të përgjithshëm dhe të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa që do të ishte shumë e domosdoshme dhe do të ketë një transparencë të plotë financiare. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA -Fjalën e ka deputetja Teuta Hadri, le të përgatitet deputeti Ramadan Kelmndi.

DEPUTETJA, TEUTA HADRI – I nderuari z. kryetar, të nderuar deputetë. Kur them të nderuar deputetë gjithë atyre deputetëve që vërtetë e ndiejnë veten të nderuar për ta ngritur zërin dhe u ngritë këtu sot kur e dëgjuam këtë Raport të auditimit edhe pse të gjithë e kemi lexuar, mirëpo sot të gjithë nga hetuesia e këtij Komisioni u vërtetua për shkeljet ligjore dhe keqpërdorimin e buxhetit të Kosovës dhe nuk i ndiej te nderuar ata deputetë që mundohen tash e tutje për t'i mbrojtur të gjitha keqpërdorimet që i janë bërë buxhetit të Kosovës deri sot.

Z. Kryetar, në fillim të kësaj mbledhjeje e çmoj propozimin tuaj kur e dhatë një minutë heshtje për dy të vdekurit. Mirëpo, sot nga ky Parlament jam tepër e shqetësuar se kam frikë se ky Parlament vazhdimisht do të ngritet në këmbë nga një minutë zie në të ardhmen kur të gjithë dëgjuesit do ta dëgjojnë keqpërdorimin që u ka bërë mjeteve të buxhetit të Kosovës, atij buxheti që me djersë klasa punëtore, qoftë punëtorit të arsimit, qoftë shëndetësisë, që ju kanë keqpërdorur kujdestaritë e disa muajve, mund të them në Gjakovë që 8 muaj nuk paguhen kujdestaritë. Punëtorët e arsimit nuk marrin pagat që u takojnë, keqpërdoret vazhdimisht buxheti i Kosovës, sot e pamë në këtë Parlament, prandaj z. kryetar unë i mbështes gjithë kërkesat që i pati z. Bajrush Xhemajli se Partia Demokratike e Kosovës me kryetarin e saj të Grupit parlamentar vazhdimisht në këtë Parlament disa herë e kam dëgjuar, e ka ngritur zërin kundër keqpërdorimeve. Unë vetëm një pyetje për ju: Disa herë na keni thënë Partisë Parlamentare hiqeni fjalën “hajna” edhe unë kam qenë bashkë me ju dhe kam thënë keqpërdorues. Si do t'i quajmë tash këta njerëz a hajna a keqpërdorës, unë ju lutem që në fund fjalës time të ma jepni përgjigjen. Mirëpo, i mbështes propozimet e z. Xhemajli të gjitha që nga fillimi. Kam edhe dy propozime të miat. Unë propozoj se i besoj shumë z. Agani, se e kam edhe koleg dhe ka qenë transparent bile ka shumë gjëra që z. Agani edhe nuk i ka paraqitur fatmirësisht se e ka një shpirt të bardhë, çdo gjë edhe ka që duhet të dalin tash e tutje, prandaj ju lutem dëgjoni duhet një propozim ta jap që në të ardhmen të bëhet një debat, që nga ky parlament jo veç të lexohen raportet, por nga deputetët e meritojnë t'i thonë vetit të ndershëm, të dalin me propozime, ta kundërshtojnë ata njerëz që kanë vjedhë buxhetin e Kosovës dhe them vjedhje dhe të propozohet sa më shpejtë nga Komisioni që ato para të vjedhura t'u kthehen të gjithë punëtorëve të arsimit dhe të shëndetësisë, që u është vjedhur djersa e tyre. Dhe si përfundim z. Besa Gaxherri e tha: Demokracia ka dy rrugë ose i ke vjedhë, ose s'i ke vjedhë – e them fjalën vjedhje, ju ma përmirësoni nëse ka shprehje tjetër. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Replikë ka Besa Gaxherri.

DEPUTETJA BESA GAXHERRI – Nuk kam replikë, por edhe një herë po e them demokraci ka ose ki keqpërdor ose nuk ke keqpërdor, ndërsa z. Teuta, ta sqaroj se as në Raportin e të gjeturave faktike që nuk i ka përngjarë auditimit, Komisioni Hetimor e ka vërtetuar këtë dhe as në Raportin e Komisionit Hetimor nuk është vërtetuar se ka hajni qysh po e quani ju. Ka shkelje të procedurave, mund të ketë, por nuk ka korrupsion. Nuk

e ka vërtetuar këtë. Ne duhet t'i presim organet e drejtësisë, prandaj ju lutem më kjo temë nuk ka vend në Kuvend. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Urdhëroni zonja Hadri

DEPUTETJA TEUTA HADRI – Më vjen keq që e përdora emrin e koleges, nuk kisha dashur si gjini që është me e përdorë, mirëpo me të vërtetë unë e ndiej dhe i shfajësohem Besës pse ia përmendi emrin si deputete e këtij Parlamenti, e ndiej një përgjegjësi dhe më vjen turp të dal nga këto karrige e këtij Parlamenti para qytetarëve tanë. Këto që i dëgjuaun ata dhe i dëgjova edhe unë, se nuk kam besuar disa herë edhe pse partia ime i ka propozuar, kam thënë ndoshta nuk do të jenë, unë e ndiej një përgjegjësi dhe më vjen turp të kthehem në këto karrige e përsëri të ulem si deputete pa u marrë masa ndëshkuese. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet deputeti Alush Gashi.

DEPUTETI, RAMADAN KELMENDI - Ju faleminderit. I nderuari kryetar, e nderuara ministre, kolegë deputetë. Në shoqërinë demokratike dhe në shtetin ligjor askush mbi ligjin, na është e njohur, ka qenë e njohur dhe duhet të mbetet në aplikim dhe secili natyrisht, se do të japë llogari për punën e vet, por jo edhe sipas interpretimeve subjektive dhe hetimeve në emër gjoja se të ligjit dhe në mungesë të rregullave dhe rregulloreve për procedura. Ne, nuk duhet të lëshohemi në atë që të emitojmë gjyqtarin hetues, prokurorin apo gjyqtarin vendimmarrës për çështje të bëra apo të pabëra. Natyrisht, unë e çmoj punën e Komisionit Hetimor, por nga konstatimet e tyre rezultojnë se ka lëshime dhe tentime dhe tentimet në sferën e përdorimit apo të keqpërdorimit dallojnë shumë prej tentimeve për vepra penale dhe natyrisht se këtyre keqpërdorimeve të bëra të paraqitura u mungon rregullativa, andaj çdo veprim i pasanksionuar nuk do të prodhojë efekte të dëshiruara, sepse drejtësia është fjala përfundimtare. Në raport nuk paraqiten asnjë element i rrisë dhe në Raport nuk ka asnjë provë e re e cila dëshmon të kundërtën apo atë, dhe në tërësi ky Raport është diskutuar edhe në seancat e kaluara është dhënë një vendim, gjegjësisht një autorizim që të hetohet, të bëhet një hetuesi, por jo në raportin e auditorit sepse Komisioni hetimor nuk ka pasur të drejtë edhe në atë rregullore që e ka aprovuar dhe e kam lexuar, e ka këtu shtojcë të bëjë hetime në auditorin e përgjithshëm të Kosovës, por hetime të reja për ta vërtetuar apo për ta demantuar atë auditorim, dhe nga e tërë kjo. Komisioni është dashur të hulumtojë, pra prova të reja dhe jo ta marrë raportin e auditorit përsëri në, çka i mungon këtij raporti. Në raport, gjegjësisht Raporti nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit, unë nuk dyshoj në këtë se nuk kanë qenë dhe nuk kanë marrë pjesë, por në raste të tilla të gjithë duhet ta nënshkruajnë për ta vërtetuar saktësinë apo për të vërtetuar thëniet gjegjësisht konstatimet. Nën dy, nuk definohen qartazi, gjegjësisht ngatërrohen përgjegjësitë individuale me përgjegjësitë kolektive të një institucioni më të lartë dhe kryesuesit apo udhëheqësit atij institucioni. Komisioni shumë thellë ngatërrohet përgjegjësinë politike prej përgjegjësisë penale dhe këto dyja i ndërthen në keqpërdorim apo në mosmenaxhim dhe në rezultatet e ndryshme që nuk përputhen me realitetin e asaj që u dëgjua këtu dhe që është dëgjuar në seancat e shumta. Nën katër, nën

rrethanat konkrete Komisioni hetimor nuk prezanton fakte të reja përveç atyre që u debatuan më parë, dhe nën pesë, rreth një çështjeje të njëjtë nuk është praktik në shtetet demokratike që të zhvillohen dy procedura hetimore në të njëjtën kohë derisa zhvillohet procedura gjyqësore. Kjo hetimore hup vlerën e saj në realitet. Në përjashtim të individëve nga të cilët nuk është marrë informacioni është dëshmi shumë e madhe se cilat raste dhe cilat janë arsyet. Komisioni ka pasur për obligim, sepse ne si deputetë mjafton një individ mos të jap deklaratë dhe ta vëmë atë pikëpyetje e madhe që vërtetë ka ekzistuar ose nuk ka ekzistuar ky dyshim. Qendra Protokollare Administrative e Gërmisë a është Villë, ku gjendet ai objekt, kush e menaxhon, kush do ta kontrollojë dhe në shërbim të kujt. Të njëjtat pyetje vlejné edhe për veturën. Unë nuk dua ta elaboroj më tepër se vetëm një fakt: të gjithë i nënshtrohem Rregullores të Shërbimit Civil, ata që punojné në këto organe, dhe kjo nuk vlen në rastet e zyrtarëve të lartë, të cilët në Kuvend emërohen. Në veçanti këtu ngatërrohet shumë koncepti bashkëpunim dhe bashkërendim. Bashkëpunimi është një aktivitet për të mbërri një qëllim të caktuar për të vjedhur, për të vra, për të bërë krim të organizuar, bashkërenditja është funksion i parashikuar me një rregullore që vetë e kanë vërtetuar se nuk ekziston. Hetimet e vërtetuara, të cilat janë: në hetimet e vërtetuara asnjë fakt nuk është prezantuar dhe në veçanti tendenca e keqpërdorimit ka dy kuptime dhe në realitet këtu nuk kemi saktësi të vetë Komisionit, sepse keqpërdorimi dhe tentimi në keqpërdorim dallojnë. Në keqpërdorim të tentosh është diçka tjetër, ndërsa në procedurë penale apo për vepër penale tentimi është sanksionuar dhe është definuar shumë drejtë. Mungesa e këtyre të dhënave, lënë shumëçka për të dëshmuar dhe nuk kemi arritur dhe Komisioni nuk ka arritur ta ndajë përgjegjësinë kolektive prej asaj individuale, për të qenë kjo më keq i ngatërrohet të gjitha këto duke u mbështetur në funksionet që ushtrohen dhe qëllimet që janë parashtruar. Të cilat janë qëllimet private, nuk numërohen dhe çka është abuzuar në mënyrë private kur ajo ka qenë për shërbimin civil po për shërbimin e Kuvendit dhe duke i përcaktuar këto të gjitha, rekomandimet e parapara nuk përshkojnë me atë që të gjetura që janë paraparë këtu. Nga ky raport i të gjeturave ekziston në përgjegjësi jashtëzakonisht e madhe, por jo e sanksionuar dhe jo e bazuar në një rregullore e cila duhet të miratohet pastaj, duhet kërkuar përgjegjësi. Askush mbi ligjin po e përfundoj askush nuk mund ti ikë përgjegjësisë, por askush nuk mund të fajësohet pa e kryer veprën paraprakisht. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Faleminderit, fjalën e ka deputeti Alush Gashi, le të përgatitet deputeti Nazim Jashari.

DEPUTETI, ALUSH GASHI, i nderuari zoti kryetar i Kuvendit, Komisionet hetimore parlamentare janë mekanizma të krijuar për përmirësim të punës së Kuvendit dhe për kontrollin e tij, si edhe për dëshmi të mundësisë së veprimit transparent në jetën institucionale. Ne kemi mbështetur themelimin e këtij Komisioni, kemi deleguar në të deputetë me përvojë, të cilët kanë punuar me përkushtim nën udhëheqjen e kryetarit të Komisionit. Me këtë rast rikonfirmojmë përcaktimin tonë për transparencë të plotë të punës në institucionet e Kosovës, rikonfirmojmë besimin tonë të sigurtë se askush nuk duhet të jetë mbi ligjin. Komisioni Hetimor me raportin e ofruar për Kuvendin e Kosovës i ka verifikuar të dhënat e auditorit dhe ka dhënë rekomandime për mbarëvajtje të punës tash e tutje, rekomandime që shpresojmë që do ta forcojnë qëndrueshmërinë e institucioneve tona demokratike.

Debati i sotshëm është shpresëdhënës, sepse nga të gjithë kërkohet një transparencë dhe respektim i plotë i ligjit, duke qenë në dijeni se çështja u është dhënë organeve të drejtësisë, shpresojmë se hetimet dhe vendimi në drejtësi do të argumentojë se gjyqësia është institucione i pavarur në vendin tonë. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Gazmend Muhaxheri, në kartelë të Nazim Jasharit.

DEPUTRETI, GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit kryetar. Gjithë procedura ose fillimi i këtij Komisioni hetimor e ka fillimin e vet, fillimi i tij është diku në protestat e majit ku koalicioni “Gërmia” u ngrit për të mbrojtur parkun “Gërmia” që është në zemër të qytetit të Prishtinës. Në protestat e organizuara prej këtij koalicioni “Gërmia”, unë i bëra një kërkesë ish- kryetarit të Kuvendit të Kosovës që të njoftohet se kur është marrë vendimi edhe të shoh procedurën e prokurimit, si ka rrjedhë. Kryetari i Kuvendit tha; Ndiqi procedurat, si anëtar i Kryesisë, që fillova me i ndjekur procedurat, i kërkova me shkrim, ma dërgoi materialin e kërkuar Sekretaria edhe përkundër thirrjes në Ligjin për qasje në dokumenta zyrtare, materiali nuk më është dorëzuar. Ua kam bërë një shkresë tjetër kryetarit të Kuvendit, Sekretarisë dhe Përfaqësuesit Special z. Petersen që të sigurohet ky material. Vetëm pas insistimit të z. Petersen materiali është dorëzuar. Nga kërkesa deri te dorëzimi i materialit kanë shkuar 3 muaj. Vetë hezitimit dhe pengimi i dorëzimit të dokumentit të cilin Sekretaria ishte e obliguar ta dorëzojë me ligj brenda afatit 15 ditësh, më bëri të dyshoja se diçka nuk është në rregull. Kur e mora materialin, pasi që jam inxhinier i ndërtimtarisë, në rastin e parë që e kam vërejtur, kam vërejtur se ka shkelje të rënda edhe të prokurimit, por edhe tendenca të mëdha për manipulim.

Qendra Administrativo Protokollare në fillim zotërojë është quajtur Qendra Administrativo-Turistike. Edhe tenderi ka dal me këtë emërtim. Është kërkua të ndërtohet një qendër e cila i ka 6000 m², ka një pishinë brenda, me ujë të ngrohtë, edhe tri sauna. 12 apartamente luksoze, tri apartamente superluksoze dhe 12 dhoma për fjetje. Mundem me ju dëshmuja këtu deputetëve të Kuvendit të Kosovës, po edhe qytetarëve të Kosovës, se Qendra Protokollare në Slloveni i ka 6000 m², ndërsa ish -kryetari i Kuvendit edhe pasuesit e tij politikë dhe administrativë në Kuvendin e Kosovës u nisën me ndërtua një qendër 6000m², dhjetëfish duke marrë në konsiderim edhe çfarë buxheti kemi ne.

Nuk i kontestoj të gjeturat e Komisionit edhe pse çdo herë kam pasur mendim tjetër, jam nënshtrua konstatimeve të Komisionit për hir të asaj që ky raport i Komisionit të parë hetimor i suksesshëm të jetë konsensual. Sa u përket thënieve të deputetes Besa Gaxherri, mundem me i thënë që nuk e ka të saktë thënien që e tha këtu, vlerësimin e ka bërë firma NPEing është pronë e dikujt tjetër, ndërsa inzhinjeri Kenan Krasniqi i cili përpara ka punua me mua, është kolegë i imi, ka të drejtë me punua për gjithkënd, a vlerësimin përfundimtar edhe raportin e kanë bë dy profesorët e mirënjohur të Fakultetit të Ndërtimtarisë, dy inxhinier të respektuar, profesori Kadri Morina dhe profesori Fadil Sylejmani. Kështu që unë tri vjet nuk kamë të bëjë me atë firmë fare.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Faleminderit. Fjalën e ka deputetja, replikë, Besa Gaxherri,

DEPUTETJA, BESA GAXHERRI, Ju faleminderit, zoti Gazmend, Nuk e di sa keni të drejtë ligjore dhe morale tash me e marrë fjalën e me folë për shkelje kur ti zotëri ke bërë shkelje ligjore dhe morale. Zotëri Gazmend, ti ke konkurruar në tenderin për vlerësimin e objektit Villa Gërmia. Me çfarë të drejtë bile së paku morale po të them kur ti je ai i cili e ke shtyrë këtë akuzë shumë të pabazë dhe mua nuk mundesh me më thanë në qoftë se ju thua kolegëve të tjerë, sepse ky zotëria që e ke në licencë i nderuar këtu është licenca e jote, këtu hala s'e ke ndryshuar këtë licencë e ke udhëheqës teknik Kenan Krasniqin dhe ti e radhit qe ta tregojë shumë ma shumë se ai për me e fituar tenderin ai këtu, këto është lojë e juaja shumë e **ndyrë a, 9100** euro ti i ke kërkuar në të vërtetë 9850 euro dhe kjo firma tjetër e shokëve tuaj 9999 euro dhe tenderin e ka fituar shoku yt udhëheqësi teknik i ndërmarrjes tuaj i nderuar dhe tash të lutem ti nuk ke drejtë as ligjore as morale me na dhënë vlerësim pasi së paku nuk e keni parë të arsyeshme që në raport ose në komision me na pruar atë vlerësim çka keni pas me sauna, ai nuk është objekti askund, ti nuk di ku i ke parë ose ku i ke vlerësuar ato. Plus asaj kjo ndërmarrje nuk është e dëshmuar që ka aftësi për të bërë vlerësime të tilla, kjo ndërmarrje ka borxhe ndaj shtetit, kjo ndërmarrje s'ka reputacion. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Urdhëroni z. Osmani.

DEPUTETI NASER OSMANI –Kam vërejtje në udhëheqjen e juaj për arsye se keni lejuar devijimin e tendës. Temë e Komisionit Hetimor asnjëherë s'ka qenë vlerësimi apo prerja e gjendjes së Villa Gërmisë. Kjo ka ndodhë pasi e ka përfunduar punën Komisioni Hetimor dhe këtë çështje është dashur me thënë kryetari i Komisionit. Kjo për çka sot këtu po debatohet nuk është temë, nuk figuron në dokumentin e Komisionit Hetimor dhe një gjë dua t'ju garantoj që kam qenë edhe unë anëtar i Komisionit sikur Besa që për punën time 17 -vjeçare profesionale, në financa dhe në auditiv ju garantoj që asnjë shkronjë në atë dokument nuk është qitur pa mbulesë ,pa afat pa argument, ajo çka figuron aty është krejt e vërtetë, prandaj ose përqendrohemi në temë ose marrim pak pushim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Osmani, Fjalën e ka deputeti Sabit Rrahmani, le të përgatitet deputeti Mark Krasniqi.

DEPUTETI SABIT RRAHMANI – Ju faleminderit z. kryetar, unë nuk desha me hy në temë në lidhje me raportin hetimor, por desha të kyçem vetëm te fjalët e z. Besa Gaxheri që tha. U përmendën Durrësi dhe Antalia, Këshilli Konsultativ i Komuniteteve si trup i tretë negociues, katër udhëtime që i kemi bërë jashtë Kosovës në Durrës, në Greqi , në Selanik dhe Maqedoni Këshilli Konsultativ për Komunitete nga bisedimet për statusin asnjë cent, asnjë deputet i komuniteteve, nuk e ka marrë si mëditje, asnjë cent bile nuk na paguhen as udhëtimet që i kemi brenda Kosovës në Këshill Konsultativ.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Profesor Mark Krasniqi e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Fetah Berisha.

DEPUTETI MARK KRASNIQI – I nderuar kryetar , të nderur deputetë. Në Kosovë flitet shumë për korrupsionin, madje flitet aq shumë sa që duket nuk e kemi asnjë institucion ku nuk ka korrupsion, kjo e dëmton Kosovën shumë. Fatin e saj sidomos për pavarësi edhe për

qeverisje të vetvetes, sepse ne gjithmonë e themi këtë, jemi në provim para faktorit ndërkombëtar i cili vendos për fatin e Kosovës, prandaj jemi të bëjmë të luftohet korrupsioni në çdo vend në çdo rast.

Korrupsion flitet që ka edhe në shëndetësi edhe në pushtet edhe në arsim edhe kudo tjetër, domethënë ne nuk jemi të pjekur për ta qeverisur vetveten si duhet. Korrupsion mendoj që është kur njeriu e keqpërdor detyrën e vet ose mundësinë konkrete interesin personal për ta pasuruar vetveten. Mirëpo korrupsioni nuk është vetëm në qoftë se dëmtohet buxheti i Kosovës, korrupsioni më i madh është për mua në qoftë se keqpërdoret detyra të cilën ia ka dhënë partia, pushteti, populli ose kushdo tjetër Ajo është domethënë korrupsioni më i madh i cili duhet të dënohet ma ashpër. Por për këtë korrupsion që po flas unë po mjafton vetëm si ndërron detyrën prej një vendi shkon në një vend tjetër që të vjedhin edhe ma tutje.

Më duket se nuk është në rregull që të merret vetëm një shembull i korrupsionit ose i keqpërdorimit të buxhetit. Kemi edhe raste të tilla. Ja p.sh. unë nuk di që është korrupsion as keqpërdorim, por flitet dhe dëgjohe se Pallati i Shtypit p.sh. që është 17 katësh atje që disa vjet ai rri, atje hyjnë vetëm shtrigat, lugatë ose kush drejtin hynë atje kurrkush, e nga ana tjetër institucionet e Kosovës paguajnë miliona euro për qiranë njerëzve privat, pse nuk merret në shqyrtim një gjë e tillë p.sh. për të cilët kam dëgjuar unë shumë por vetë konkretisht nuk di asgjë për këtë punë.

Tani pse merret vetëm një periudhë tremujore, shkojmë ne ma larg, ne jemi këtu njerëz që duhet të jemi të ndershëm të gjithë të paktën sa do të jemi në këto banka këtu dhe që na ka zgjedhë populli për njerëz të tillë, shkojmë, kush është prej nesh ma i korruptuar këtu. Kush është ma i pastër? Korrupsioni nuk e ka vetëm një periudhë tremujore ose njëvjetore, shkojmë ku kemi bërë çka kemi bërë në këtë drejtim për ta kompromitur Kosovën para botës. Unë mendoj se nga ana tjetër për çdo gjë duhet të respektohet edhe respektohet gjithmonë në gjyqe se qysh, sepse ekziston një aksion qysh në drejtësinë romake ku thuhet **audiamo et arta pars**, ta dëgjojmë edhe anën tjetër. Do me thënë atëherë mund të marrim një qëndrimi, ose dënimi ose falje ose çka do tjetër. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Ju faleminderit profesor.Fjalën e ka deputeti Fetah Berisha, le të përgatitet deputeti Bajram Kosumi, i fundit.

DEPUTETI, FETAH BERISHA, zoti kryetar,

Ju lutem më lejoni të qartësoj diçka. Askush që nuk e njeh letërsinë popullore mirë, nuk e di urtësinë popullore dhe mençurinë e kombit tonë, po e përdori atë pa vend e deformon, ju lutem, populli ynë e ka lënë mençurinë më të vjetër, mos u bëfsh me të qajhtë Stambolli, si na doli sot, mos u bëftë me të qajhtë Rahoveci? Ju lutem Rahovecin e ka krijua perëndia në vendin më të begatshëm të Kosovës. Rahoveci është i mrekullueshëm, sepse është zemra e Podrimës. Prandaj, mos u bëfsh me të qajhtë Rahoveci, në asnjë mënyrë. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Faleminderit. Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi, le të përgatitet deputeti Genc Gorani.

DEPUTETI, BAJRAM KOSUMI – Ju faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar kolegë deputetë, unë nuk do të flas për përmbajtjen e raportit të Komisionit Hetues, sepse shpresoj që organet e drejtësisë do të thonë fjalën e tyre dhe nuk do të dëshiroja që këtu me u dhënë, me u bë gjykime politike për pa e dhënë organet e drejtësisë qëndrimin e vet.

Unë dëshiroj të flas sot për një aspekt të procedurave që ka ndjekë Komisioni Hetues i formuar në këtë Kuvend prej neve dhe për aspektin formal ligjor, në një pjesë të punës së vetë, me dokumentin e themelimin dhe me rregullën 50 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi i jep autoritetin Komisionit Hetues që, të ftojë secilin zyrtar të Kosovës të dëshmojë para Komisionit. Ky është autoriteti që Komisioni e ka marrë prej Kuvendit të Kosovës, të ftojë zyrtarët që të dëshmojnë para Komisionit për temën të cilën e ka identifikuar. Më lejoni unë t' jua lexoj një letër të datës 16 janar 2007 të cilën e kam marrë prej Komisionit në fjalë, vetëm një pjesë të letrës në të cilën thuhet, po citoj: “Kur të paraqiteni para Komisionit, ju do t'i keni të drejtat dhe detyrimet si vijon: mund të shoqëroheni nga përfaqësuesi juaj ligjor, përfaqësuesi juaj ligjor nuk mund të japë përgjigje në emrin tuaj, por ju mund të konsultoheni me të gjatë kohës që merreni në pyetje. Kur të përfundojë koha e marrjes në pyetje, do tu jepet rasti për tu konsultuar me përfaqësuesin tuaj ligjor”, mbaron citati.

Këtë letër në bazë të raportit që e kemi marrë, kjo letër iu ka dërgua këtyre personave, Bajram Kosumit, Fatmir Sejdiut, Sabri Hamitit dhe Xhezair Muratit dhe në herën e dytë ju ka dërgua përsëri anëtarëve të Kryesisë, Bajram Kosumi, Xhavit Haliti dhe Hydajet Hyseni. Unë kisha lutë, më parë të konstatoj pastaj e kamë edhe kërkesën,

Kjo gjuhë që është në këtë letër nuk është në përputhje me autorizimin që i ka dhënë Kuvendi Komisionit, nën një.

Nën 2. gjuha që është përdorur në letër nuk është në përputhje edhe me mandatin që ka Kuvendi i Kosovës dhe detyrimet që ka Kuvendi i Kosovës. Ky është konstatimi im dhe si të tillë unë nuk e kam pranuar as nuk e pranoj Mendoj asnjëri prej kolegëve që iu ka dërguar kjo letër nuk e ka pranuar si të tillë. Kërkesa ime është kështu, nuk është mirë që një letër e tillë me formulime të tilla të mbesin në dokumentet e Kuvendit të Kosovës. Kuvendi i Kosovës dhe as Komisioni Hetues nuk është gjykatë. Nuk është gjykatë që thërret në gjyq njerëzit. Prandaj kisha lutë Kryesinë e Kuvendit dhe Kryetarin e Kuvendit, që të kërkojnë nga Komisioni të gjejnë njëfarë modusi për ta ndryshuar këtë përmbajtje që të mos mbetet në dokumentet e një përmbajtje me fjali të tilla të pa pranueshme. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit, kryetari i Komisionit ka replikë, urdhëroni zoti Agani.

DEPUTETI FERID AGANI- Ju faleminderit, zotëri kryetar. Siç e thashë edhe në fjalën time, Komisioni Hetimor e ka filluar punën e tij praktikisht nga një xero, praktikisht në këtë aspekt të punës hetimore parlamentare, nuk ka pasur asnjë dokument zyrtar, juridik mbi të cilin ka mund ta mbështes punën e tij. Ka ekzistua një draft i ligjit për Komisionin Hetimor

i punuar nga një grup punues brenda Kuvendit, por i cili nuk është procedua më tutje në Komisionet funksionale, përkatëse.

Gjatë punës jemi ballafaquar me situata shumë konkrete, është dashtë që të vendoset komunikimi zyrtar, me zyrtarë dhe institucionet të caktuara dhe natyrisht se gjatë punës është dashtë të gjejmë edhe zgjidhjet konkrete për çështjet e caktuara. Siç e kemi parë edhe në shtojcat e këtij raporti, janë një varg i dokumenteve, ftesave për dëshmi gojore, për dëshmi me shkrim dhe në mes tjerave edhe kjo ftesë të cilën e citoj deputeti Kosumi, në të cilën unë personalisht kam pasur rastin të dëgjoj edhe një vërejtje nga njeri prej zyrtarëve të ftuar.

Esenca është se, shumica e madhe, siç e përmenda edhe më parë, prej 26 zyrtarëve të iu është dërguar kjo ftesë, i janë përgjigjur ftesës, në përjashtim të katër rasteve individuale, përkundër përmbajtjes që unë mund të pajtohem që mund të tingëllojë në mënyrë të ndryshme, por të ju informojë se kjo ftesë nuk është përpiluar në mënyrë ekskluzive nga Komisioni Hetimor, por është përpiluar në bashkëpunim me organizatën për siguri dhe bashkëpunim të Evropës, me ekspertët e sajë juridikë, me ekspertët të cilët kanë përvojë në punën e komisioneve hetimore parlamentare. Me siguri që puna në të ardhmen do të jetë shumë më e rregulluar dhe e mbështetur sikur Kuvendi i Kosovës, ashtu siç është kërkuar në rekomandime, të nxjerr ligjin për Komisionin hetimor, i cili ligj do t'i rregullojë të gjitha aspektet relevante të kësaj çështjeje. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit, urdhëroni zoti Bajram Kosumi,

DEPUTETI BAJRAM KOSUMI - Ju faleminderit, unë vetëm shkurtimisht e pranoj arsyetimin e zotit Agani për mungesë të dokumentacionit, edhe unë e kam pasur parasysh edhe para se ta përmendi këtë çështje. Thotë është një çështje që për herë të parë ka ndodhë. Mirëpo, nuk e pranoj që argumentimi që është punuar në bashkëpunim me OSBE-në, për deri sa ne kemi rregullore në të cilën Komisioni e di qartë mandatin e vetë, prandaj unë propozova që të gjendet një modus që këto fjali dhe këto formulime, që nuk janë gjuhë parlamentare të hiqen, nga letra dhe të mbesin në dokument ndryshe.

KRYETARI KOLË BERISHA – faleminderit, fjalën e ka deputeti Genc Gorani,

DEPUTETI GENC GORANI – Ju faleminderit zotëri kryetar, i nderuar kryetar i Parlamentit, te nderuar anëtarë të Parlamentit, zonja dhe zotërinj,

Që në fillim kisha dashtë të përgëzoj këtë punë të Komisionit Hetimor, i pari për nga kjo masë dhe i pari për nga një seriozitet, mjaft konsekuent, për nga çështja dhe për nga puna. Përgëzime mund t'i adresohen edhe këtij Kuvendi i cili në një periudë mjaft të gjatë ka arrit të arrijë në këtë rezultat dhe besoj se ky debat duhet edhe ta reflektoj këtë fakt. Kisha dashtë dy pika ti theksojë sa më shkurtë, një prej çështjeve që më së tepërmi më ka brengosur dhe që më brengosë gjithmonë, është vetë mundësia e Konstatuar që në nivel të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të mund të bëhet rialokim i mjeteve pa vendime të nevojshme, pa vendime mandatore. Çështja qëndron në faktin se, dikush ka mund të luajë me mjete konsekuente, mbi 200 mijë €, pa pasur në mbështetje e vendim të organeve të

cilat merren me vendimmarrjen në lidhje me atë rialokim. Ky arbitraritet shkelje e ligjit, është një prej brengave që duhet të jenë të përbashkëta për gjithë ne.

Çështja e dytë është frika ime se imitimi i rekomandimeve nga ky Komision pa dhënien e konditave ,të parakushteve që këto rekomandime të plotësohen mund të jetë edhe jo produktive. E kam një shembull që kisha dashtë, me të cilin kisha dashtë të ilustrojë këtë problem. Ajo që është konstatuar dhe konstatohet nga shumë ka qenë jo profesionaliteti i një pjese të administratës së Kuvendit të Kosovës. Një prej konsekuencave shumë serioze ka qenë që kjo administratë nuk ia ka përgatitë si duhet ashtu mendoj unë, punën Kryesisë së Kuvendit dhe shumë çështje duhet të përgatiten në nivel profesional dhe nuk është Kryesia e Kuvendit që mund ti kompensojë mangësitë profesionale në përgatitje të çështjeve të ndryshme. Konkretisht një investim gjegjësisht donacion prej 500 mijë €, nga Agjensionin Evropian për rikonstruktim. Është iniciuar në kohën e administratës së kaluar, së paku jam duke folur për sekretarin e kaluar.

Sipas dokumenteve të cilat mund t'i kemi në dispozicion, së paku unë i kam në dispozicion . Sekretari i atëhershëm i Kuvendit nuk ka marrë masa të duhura për përgatitjen e investimit të këtij donacioni, realizimin e këtij donacioni, që nga viti 2004, ky agjension ka kërkuar nga Kuvendi që ta përgatisë një si të them projekt që bazohet në nevojat e Kuvendit për realizimin e 500 mijë €, në fushë të teknologjive informative. Në atë kohë kjo çështje nuk është trajtuar si duhet dhe tani këtë çështje ne e kemi trashëguar dhe së shpejti kamë frikë se do të jetë pikë e një komisioni të ardhshëm hetimor.

Pra nëse dom ne që rekomandimi i këtij komisioni të jetë vërtetë valid, administrata që e ka trashëguar administratën e kaluar, duhet vërtet të merret shumë më seriozisht me këto çështje dhe të mos jetë në kontinuitet të administratës së kaluar. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Faleminderit, kemi edhe tre kandidatë që kanë kërkuar fjalën, katër vërtetë, vazhdimisht po shtohet numri, Fatmire Mulhaxha Kollçaku, Gani Koci, Behxhet Brajshori dhe Nazim Jashari.
Fatmire Mulhaxha e ka fjalën!

DEPUTETJA, FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU – Ju faleminderit zotëri kryetar, është e qartë që ky Kuvend e ka autorizuar një komision, besoj që të gjithë kemi besim te deputetët e këtij Kuvendi, që ta hartojë një raport dhe ta sjellë këtu edhe ta sjell për debat, sepse pa tendenca që të thuhet se këtu është diskutua për këtë çështje dhe nuk ka më nevojë, autorizimi i njerëzve, deputetëve të këtij Kuvendi, që të ulen dhe të punojnë seriozisht, nënkupton që edhe ne seriozisht duhet ta trajtojmë si çështje të tillë.

Nëse nisemi prej gjendjes faktike, të mbledhurat faktike që i ka ofruar së pari Grupi Parlamentar ORA këtu në seancë, që janë të pakontestueshme sepse kanë qenë dokumente zyrtare valide.

Nën 2. një raport shumë qartë i auditorit me gjendjen faktike dhe
Nën tre, një raport i besueshëm u quajt koncesual që na është ofrua këtu neve sot dhe habitë fakti i ecurisë së diskutimeve. Pse habitë fakti? Për hir të informimit të opinionit kosovar, në rend të parë taksapaguesve, po i potencoj vetëm dy- tri çështje, kur thotë sa i përket

përgjegjësi të ish- kryetarit të Kuvendit, a nuk mjafton fjalia në disa raste ka përdorur këto mjete për qëllime private. Mjetet, parandë publike, për sekretarin, ish sekretarin, thotë: edhe ai i ka shfrytëzua këto mjete në disa raste për qëllime private. Do me thënë në disa raste ka përdorë mjetet buxhetore të Kuvendit për qëllime private dhe këtë e ka lejuar edhe për anëtarët e kabinetit të ish kryetarit dhe për pjesë tjera.

Çka, cila është porosia taksapaguese, cila është porosia e qytetarëve të Kosovës, mos të kërkojmë përgjegjësi politike sot, jo nuk bën, të mos kërkojmë që organet e drejtësisë të presin që ta zgjidhin pa, tue ditë çfarë presione politike dhe qysh po i zgjidh sot gjyqësori kosovar rastet. Mund me ju thënë si anëtare e nënkomisionit për peticione e parashtrës drejtat e njeriut, që rastet në gjyq po na qëndrojnë me vite pa u zgjidh dhe ky Kuvend ti mbyll sytë, para shkeljeve evidente. Ka pasur tendenca të që minimizojmë bile bile edhe të këndojnë këngë këtu sot në emër të dikujt. Ju lutem nëse i mbyllim sytë ne e hedhim më së parim punën e këtyre anëtarëve të këtij komisioni, që kanë sjellë këtu gjendjen faktike, Së pari ky Kuvend duhet të deklarohet se do me thënë a qëndron një përgjegjësi, nëse jo kurrfare bile ajo politike.

Përndryshe, pakënaqësia e madhe që është akumulua të qytetarët e Kosovës, dhe mosbesimi në organet, mu këtu buron nga ky institucion edhe më lartë, në këtë Qeveria, sepse nuk po adresojnë dhe nuk po i thuhet gjërave me emrin e vetë. Nëse dikush ka qenë i korruptuar ka keqpërdorë ai dihet t'i japë përgjegjësi, sepse ne tjerët në atë rast distancohemi dhe e vazhdojmë punën si duhet. Çka mendoni zoti kryetar? A do t' jua falë pasardhësi i juaj gabimet e paraardhësit të juaj, besoni nëse dikujt i jepet rasti nuk do t' ju falë juve, as sekretarin e tashëm, po qe se do t'i bënte këto çka janë bërë prej paraardhësve tuaj, i bindur. Ne nuk guxojmë t' ia lëmë rastit që gjendja faktike që u konstatua prej tri, në tri hera këtu para neve deputetëve, nëse duamë me i mbyllë sytë, ajo është tjetër gjë. E dikush me e shfrytëzua këtu për fushatë parazgjedhore, të parakohshme, këtë seancë, ky Kuvend nuk duhet ta lejojë.

Ne jemi ,më duket këtu përfaqësues të dikujt në rend të parë të taksapaguesve. Nëse dikush e ka përvetësua një €, është njëjtë si me i përvetësua 100 mijë €. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë kriter, dijani që edhe ata a nuk është njëjtë sot një shërbyes civil i cili do të **përndjekjet nëse..... nëse** niseni edhe nuk kërkohet përgjegjësia për njerëz që i kanë bërë këto përvetësime qysh do të kërkoni sot prej punëtorëve tjerë shërbyesve civil, të cilët do ta bëjnë të njëjtën. Organet e drejtësisë shpresojmë që do ta bëjnë punën e vetë. Por edhe ky Kuvend ka përgjegjësi të deklarohet për zyrtarët më të lartë të cilët e kanë udhëheqë këtë Kuvend, jo në të kaluarën shumë të afërt. Ju faleminderit!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Faleminderit, Fjalën e ka deputeti Gani Koci, le të përgatitet deputeti Behxhet Brajshori,

DEPUTETI, GANI KOCI – Ju faleminderit zoti kryetar,

E pata ndarë mendjen të mos flas fare në këtë seancë, për faktin se kam qenë anëtar i Komisionit Hetimor dhe e ndaj të njëjtin mendim. Unë pata vendosur të mos flas, por kur i dëgjova disa diskutantë këtu që më shumë merren me vetveten e tyre, se sa me raportin, disi u nxita dhe nuk kam qare pa fol. Detyra e këtij Komisioni ka qenë të verifikojë, të

vërtetohet faktet e të gjeturave faktike nga raporti i auditorit, për të cilat fakte nuk kemi besuar ne si Kuvend, ose një pjesë bukur e madhe, nuk i ka besua revizorit. Do të thotë ky ka qenë qëllimi. Ky komision e ka verifikua katërciprisht bile bile edhe më shumë se sa vetë raporti i revizorit. Prandaj është konstatimi se raporti i të gjeturave faktike i revizorit është i saktë dhe është i drejtë.

Për këtë çështje është hapë edhe procedurë gjyqësore dhe çështja ka kalua në procedurë gjyqësore me të cilën ne nuk duhet të merremi dhe nuk duhet të ngatërrohem me këtë çështje. Çështja që unë dua të them këtu, e që u nxita ta them, nuk ka përgjegjësi politike. Po ju lutem në një institucion kur dikush është në krye të atij institucioni, janë konstatua kaq shumë shkelje, a mund të ketë përgjegjësi dhe cila është përgjegjësia e tij. Si mund të quhet ajo përgjegjësi. Kur në një institucion janë keqmenaxhues, nuk po them janë keqpërdorua, mund të ketë edhe keqpërdorime, shikoni raportin e Komisionit disiplinor lexon edhe ty të preferoj zoti Kosumi ta lexosh këtë raport dhe do të gësh shumë sende aty dhe e shihni se vërtetë a ka keqpërdorime dhe a nuk ka keqpërdorime. Dhe kjo çështje tjetër me të cilën po merret hetuesia atje.

Por nuk mund të pajtohem me vetë faktin që një kryesi e Kuvendit dhe një kryetar që ka abuzua me këtë Kryesi, dhe me krejt Kuvendin të thuhet se nuk ka ditë për këto gjëra, për këto ndodhi, për këto shkelje, për këto abuzime, për këto keqpërdorime. Unë dua të përmend vetëm një fakt, ku del përgjegjësia e kryetarit, se çfarë do të jetë ajo urdhëroni, më mësoni edhe mua, po ta themi këtu. Në qoftë se në një deklaratë të një zyrtari para këtij komisioni i cili komision nuk dënoju zoti Bajram Kosumi ti përgjigjet, dhe nuk e ka respektua pra as rregulloren, as pozitën e vetë si deputet, bile të vijë para atij Komisioni, thotë kështu:

Unë për punën time i kamë referuar sekretarit, drejtorit të Administratës së Divizionit teknik, fuqia dhe përpjekja ime gjatë tërë kohës ka qenë që të jemi në pajtueshmëri me kërkesat e ligjit. Me keqardhje po e them se nuk e kamë pasur lehtë dhe shpesh kamë qenë i kërcënuar, dhe i shqetësuar nga sekretari i Kuvendit dhe për këtë kamë njoftuar me shkrim edhe ish kryetarlamentarin dhe drejtorin e administratës. Në qoftë se ish kryeparlamentari e ka pasur një shkresë të tillë prej një administratori që ka potencuar se është i kërcënuar prej sekretarit dhe nuk e ka marrë asnjë masë, ku është përgjegjësia dhe çfarë përgjegjësia është e tij.

Ku është përgjegjësia e kryetarit dhe e Kryesisë në këtë rast kur nisen projektet që nuk kanë qenë fare të planifikuara dhe nuk merret një vendim, ose vendimet bëhen pasi të fillohet të realizohen ato projekte. Ku mos të ketë përgjegjësi kryetari në këtë rast edhe Kryesia që ka lejua që të veprohet, edhe ne si kuvendar këtu, në këtë mënyrë, kur për të gjitha këto veprime asnjëherë nuk i kanë ngritur çështjet, asnjëherë nuk kanë raportuar para dikujt dhe tani na dalin krejt krejt pastër. Nuk janë krejt pastër, ne nuk do t'i dënojmë ata, ne nuk jemi me heqë koka, por t'i themi se ke gabuar zoti Dac, ke gabua zoti Kolë, ke gabua ti anëtar i Kryesisë dhe këtë duhet ta themi hapur. Vetëm në këtë mënyrë mund ta shpërlajmë pak vetveten si deputet edhe si Kuvend, edhe si Kryesi e kaluar edhe si Kryesi e tanishme. Dikush tha nuk është njësoj sikur me i keqpërdorua një €, sikur 100 mijë €, edhe unë them nuk është njësoj, por në qoftë se e vjedh një €, je hajn, në qoftë se i vjedh 100 mijë €, je

hajn, vjedhja është vjedhje, mund të jetë vjedhje e lehtë, vjedhje e rëndë, është vjedhje dhe këtu ka edhe vjedhje. Urdhëroni shihni raportin e pastaj eni te përfundimet e juaja këtu.

KRYETARI, KOLË BERISHA – Faleminderit, fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori, Lulzim keni replikë, nuk tu ka përmend emri, Lulzim më falni nuk tu ka përmendur emri. Behxhet Brajshori e ka fjalën

DEPUTETI, BEHXHET BRAJSHORI – Ju faleminderit kryetar, të nderuar kolegë deputetë. Unë mendoj se raportet e këtilla në përgjithësi e shtojnë qëndrueshmërinë institucionale në të gjitha nivelet dhe duhet mirëprit do të thosha kontrollat e këtilla të brendshme të financave publike, prapë po e them në të gjitha nivelet, sepse kështu edhe na obligon ligji që të zhvillojmë edhe kontrolla të këtilla, me qëllim të rritjes së transparencës dhe të ngritjes së përgjegjësisë, për secilin dhe të përgjegjësisë natyrisht edhe të bartësve të institucioneve. Në këtë drejtim mendoj se kjo punë e bërë është një kualitet i ri brenda Kuvendi të Kosovës, do të na ndihmojë të gjithëve pa dyshim, dhe natyrisht Kuvendi me u ndalë brenda suazave të veta dhe organet tjera do ta bëjnë punën e vetë në vazhdimësi.

Pavarësisht se me çfarë rasti mund të lidhet sot dhe nesër, ajo që dua unë të them këtu, është çështja e rekomandimeve të cilat gjithë besoj kemi lexuar dhe do të ndalem pak a shumë vetëm te rekomandimi si ka të bëjë në këtë rast me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, për përgjegjësinë që përshkruhet në një aspekt jo për asgjë tjetër, por kam qenë i interesuar prej se kam marrë raportin vërtet për të parë se, a qëndron ajo përgjegjësi apo nuk qëndron. Unë kamë kërkuar që të nxirren të dhënat lidhur me lëndën në fjalë, dhe të shikohet se në të vërtetë Ministria ka bërë transfer të paligjshëm apo nuk ka bërë. Mund të them një gjë që deri në vitin 2005, organizatat buxhetore kanë udhëheqë me kodin e vetë ekonomik dhe nuk e kanë pasur kodin e projekteve kapitale. Me fjalë tjera, autoriteti kontraktues ose nëpunësi zyrtar ka qenë i obliguar për të menaxhua me pjesën që ka të bëjë me investimet kapitale.

Në këtë rast ne kemi jo transfer prej një kategorie ekonomike në kategorinë tjetër, por një bartje brenda kategorisë së njëjtë ekonomike se ka të bëjë pra me investimet kapitale, për çka po them përgjegjës ka qenë nëpunësi zyrtar i autorizuar i autoritetit kontraktues në këtë rast i Kuvendit të Kosovës, edhe jo Ministria e Ekonomisë dhe Financave, gjë që nuk bie përgjegjësia mbi këtë. Gjatë vitit 2006 ne tani kemi mekanizimin e kontrollit të projekteve investive me kodin e veçantë, gjë që Ministria është e obliguar tani pra të bëjë kontrollin eventuale të transfereve prej një projekti në projektin tjetër, nëse eventualisht kërkohet transfer pa miratimin e vendimit të Qeverisë, sipas ligjit mbi menaxhimin e financave publike me përqindje që janë përcaktua brenda ligjit.

Prandaj në këtë drejtim mendoj që Komisioni duhet edhe një herë ta analizojë këtë pjesë me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, për të ardhur të konkludimi i qartë, se ku bije përgjegjësia, mbi autoritetin kontraktues ose nëpunësit zyrtar të Kuvendit të Kosovës, apo të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për atë kohë në të cilën është bërë ky destinim i mjeteve përkatësisht do të thosha bartje brenda kategorisë së njëjtë ekonomike. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI, KOLË BERISHA – Faleminderit, fjalën e ka deputeti Nazim Jashari, ta merrni fjalën në fund.

DEPUTETI, NAZIM JASHARI – Ju faleminderit zoti kryetar i Kuvendit, të nderuar kolegë deputetë, çështja për të cilën po diskutojmë sot është një çështje e veçantë dhe në njëfarë mënyre shënon një gur- ndarës në praktikën parlamentare në Kosovë, në periudhën jo para këtij debati po para këtij Komisioni Hetimor dhe në periudhën pas këtij Komisioni Hetimor. Realisht në Kuvendin e Kosovës është menaxhuar me paratë publike, me paranë e taksapaguesve, me paranë e qytetarëve të Kosovës për faqe të zezë. Këtë duhet ta pranojmë që të gjithë bashkërisht dhe më bëhet shumë qejfi sot kur dëgjoj nga kolegja ime Basha Gaxherri, që është rritur vigjilenca, është rritur vëmendja, është rritur përqendrimi dhe edhe për një tender prej 10.000 €, kërkohet transparencë maksimale siç ishte ai tenderi për vlerësimin e punës në Villa Gërmia. Pra vetë ky fakt është pozitiv pra, vetë pritja e kësaj transparence, rritja e kësaj vigjilence, rritja e transparencës së kërkohet dhe vigjilenca që dëshmohet tregon se ky proces i iniciuar nga Grupi Parlamentar ORA, qysh në vitin 2005. në shkurtin e këtij viti, ka dhënë rezultatet e veta në këtë Kuvend dhe mendoj se këtu qëndron edhe poenta. Në qoftë se kjo shoqëri dëshiron të jetë shoqëri moderne demokratike, në qoftë se dëshiron dhe në qoftë se guxon të pretendojë të bëhet pjesë e familjes demokratike evropiane, ne duhet ta kemi parasysh ligjin dhe vetëm ligjin.

Fatkeqësisht kjo në këtë fazë, deri te ky komision hetimor nuk ka ndodhur, shpresoj shumë që tash e tutje kjo praktikë do të fillojë gradualisht të vendoset dhe që ky Kuvend do të fillojë të funksionoj si gjitha kuvendet e botës dhe këto institucionet tona do të jenë si të gjitha institucionet e botës demokratike ku përgjegjshmëria dhe llogaridhënia janë alfa dhe omega e punës në institucione. Pra kjo është e para që desha të ndalem dhe ta theksoj.

Çështja e dytë që dua të ndalem është partizania që dëshmohet në këtë Kuvend me rastin e debatimit për këtë çështje. Është normale, janë deputetët e partisë më të re në Kosovë të cilët e mbrojnë me fanatizëm liderin e tyre, tek e fundit të tillë kanë qenë edhe në periudhën deri sa nuk e kishin themeluar partinë e tyre, po këta zëra ata të cilët gjatë debatit të ditës së Shën Valentinit, akuzuan kryetarin e partisë sime në vija të ndryshme, për malverzime, manipulime, pa çka që, kryetari i partisë sime në asnjë kohë në asnjë mandat nuk ka menaxhuar fonde publike të paguara nga taksapaguesit Kosova.

Pra edhe atëherë këta ishin të njëjtit me të njëjtin zë, me të njëjtin ton u përpoqën që **dezavojnë** ose ta devijojnë debatin në çështje efemere,, siç ndodhë tash përpjekja për ta devijuar debatin në çështjen e mënyrës se si është dhënë tenderi për vlerësimin e punëve të kryera dhe jo në mënyrën se si është shpenzuar paraja publike gjatë menaxhimit ose ndërtimit të Vilës Gërmia. Posaçërisht ajo që duhet ndalemi është çështja e blerjes së automjetit.

Të nderuar kolegë deputetë,

236 mijë euro nga paret e popullit të Kosovës janë dhanë për një makinë e cila kur në Kosovë nuk ka ardhur. Pra, atje figuron një nënshkrim nga një ish -zyrtar i Kuvendit i cili e deklaroi që makina është pranuar. Dhe ajo makinë që kushton 236 mijë euro nuk ka mbërrirë

kurrë në Kuvendin e Kosovës. Ato para janë tretur, makina është zhdukur. Çështja është, a ka pasur Kuvendi i Kosovës, të shprehem në mënyrë elementare, rregullativë funksionuese, dhe a mjafton ajo rregullativë e pasur për funksionimin e Kuvendit ta dëshmojë fajësinë në zinxhirin vendimmarrës.

Rregullorja e punës e Kuvendit, qoftë ajo e para, qoftë ajo e dyta shumë qartë në mënyrë të katërciptë e ka theksuar përgjegjësinë e menaxhimit të buxhetit të Kuvendit të Kosovës dhe mënyrën se si u ushtrohet kjo përgjegjësi. Aty është thanë prerë, është thanë qartë se sekretari i Kuvendit, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit e kryen detyrën e tij në bashkëpunim të ngushtë me kryetarin e Kuvendit, as me Kryesinë e as me Kuvendin, por me kryetarin e Kuvendit.

Aspekti tjetër i cili duhet të theksohet këtu është lidhmëria e këshilltarit politik të ish kryetarit të Kuvendit në rastin e makinës së blinduar apo makinës së famshme të 236 mijë eurove. Në qoftë se kryetari i Kuvendit e ka këshilltar politik njeriun të cilën e ka zgjedhur vetë por nuk i ka ardhur me konkurs dhe i cili është drejtpërdrejt i implikuar në parregullsi, t'ia huazojë fjalën Gani Kocit, në vjedhjen e parasë publike, atëherë edhe përgjegjësia është shumë e qartë, adresa ku duhet të kërkohet fajësia është shumë e qartë. Çka mbetet e pa qartë. Mbetet i paqartë hezitimi i Kuvendit të Kosovës për ta marrë përgjegjësinë mbi vete.

Ky Kuvend duhet të dëshmojë që është institucioni më i lartë i demokracisë në Kosovë dhe si i tillë e ka për detyrë që të mos e le në dorën e një prokurori atje se a do të ketë ai guxim të nevojshëm qytetar për ta iniciuar procedurën e nevojshme lidhur me kërkimin e përgjegjësive penale për ata të cilët në mënyrë të pandërgjegjshme i ushtruan funksionet e tyre, por ky Kuvend duhet të bëjë kallxim penal. Ky Kuvend duhet ta bëjë kallximin penal dhe këtu Komisioni Hetimor mendoj se nuk ia ka dalë ta kryente punën e vet, sepse është dashur të vijë me rekomandime shumë më të qarta në këtë Kuvend dhe jo ta luajë rolin e strucit duke futur kokën në rërë dhe duke përpjekur të balancojë të gjitha të balancuarat.

Në këtë Kuvend do të ketë gjithmonë forca të cilat do të jenë për diçka dhe do të jenë kundër diçkaje, por në këtë Kuvend nuk do të duhet të ketë kur forca të cilat e mbrojnë krimin dhe e mbrojnë hajninë. Pra kjo është ajo vija fundamentale që i ndanë forcat demokratike nga forcat jodemokratike dhe në këtë aspekt mendoj se ky Kuvend duhet të dëshmojë pjekurinë e vet dhe duhet qartë dhe prerë të ndërmarrë hapat e nevojshëm për t'i sanksionuar për të gjithë ata të cilën kanë abuzuar me paratë publike. Po që se nuk e bëjnë këtë atëherë të gjitha gjakimet tona për përfshirjen në BE për ndërtim të shtetit të pavarur, për ndërtim të institucioneve demokratike mbesim vetëm fjalë dhe kur jo vepër. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Fjalën e ka kërkuar deputetja Besa Gaxherri.

DEPUTETJA BESA GAXHERRI – Faleminderit z. kryetar.. Kjo çështje tërësisht politike dhe joparimore dokumentohet për kolegët e mi të nderuar sikur të ishte shtruar kjo çështje pa u ngritë në organet e drejtësisë në Kuvend e kishte pasur anën parimore. Por ju lutem shumë, kjo është seanca e tretë në të cilën diskutohet për këtë çështje, që është në

duart e organeve të drejtësisë. Pse shtrohet këtu, shtrohet me çështje politike. Unë i dhashë shembujt konkretë, do me thanë konflikt i interesave. Andaj, kërkoj sot nga ky Kuvend që ta marrë në përgjegjësi qoftë Kryesinë e Kuvendit, qoftë anëtarin e Kryesisë z. Muhaxheri, i cili ka konkurruar në atë tender për vlerësim, do me thanë ky është kryekëput konflikt i interesave nuk kemi çka me hi tutje. Edhe një herë po e potencojë, Raporti i revizorit nuk është decidiv, nuk parasheh shkelje apo, po mendoj nuk parasheh vepër penale sepse edhe nuk është organ që e përcakton këtë. Edhe në raportin e revizorit thuhet tendencë ose dyshim njëkohësisht edhe Komisioni Hetimor thuhet tendencë dhe tendenca edhe realiteti kanë shumë dallim. Megjithatë këto dy organe nuk kanë as drejtë të thonë ndryshe, por as ky Kuvend nuk ka të drejtë të bëhet gjykatore, ju lutem shumë. Kjo çështje është në organet e drejtësisë, ndërsa ky debat bëhet kryekëput debat politik. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli, dhe e vazhdojmë seancën deri në orën 12,00 nuk ka problem. Urdhëroni z. Zeneli.

DEPUTETI LULZIM ZENELI - Z. kryetar, fillimisht gjatë diskutimit të mëhershëm e potencova një çështje e cila pas secilit diskutim do të vijë në përfundim. Ky debat i sotëm nuk ka objekt diskutimi për shumë arsye dhe është kryekëput në shërbim të interesave jashtëparlamentare. Pse po e cekim këtë punë? Forma si është ngritë pikë së pari para sa muajve, vazhdimësia e tij e kësaj procedure, në krijimin e Komisionit dhe sot kur po diskutojmë për diçka që ka mujtë shumë lehtë të kalohet, jo pse nuk i besojmë Komisionit në fjalë. Mirëpo kjo foltore e Kuvendit po shfrytëzohet për elemente të cilat më së paku jo që s'i kanë hije deputetit për fyerje dhe shantazhe pikërisht në dobi të interesave të ngushta partiake. Ajo që është thënë më herët se të mbetet çështje e institucioneve kompetente që të merren me këtë çështje, ose ky Kuvend t'i marrë të gjitha obligimet dhe ta marrë edhe mandatin e gjyqësorit edhe të ekzekutivit edhe gjithçka do të jetë okej pastaj. Mirëpo, në qoftë se ne si deputetë jemi në nivelin e përgjegjësisë dhe kemi adresuar përgjegjësinë shumë qartë, cili është mandati i gjyqësorit, lënda ka shkuar në prokurori dhe pastaj ç'kërkojmë ne sot këtu? Ne mund të debatojmë po debati ynë duhet të jetë në kontura të rregullave parlamentare. Dhe një debat i cili do t'i kontribuojë ngritjes së cilësisë, transparencës, por edhe punës si në nivel të Kuvendit ,po ashtu të jetë edhe mostër për institucionet e tjera. Kjo formë e diskutimit me një fjalor kryekëput partiak nuk është në shërbim as të Parlamentit, as cilësisë së punës të këtij Kuvendi. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. z. Jashari Urdhëroni.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Duhet shprehur keqardhjen që fjala e parafolësit tim nuk ishte replikë në fjalën time, në qoftë se është motivuar më fjalën time, ai foli çka deshë vetë. Prandaj, do t'i kthehem koleges së nderuar Gaxherri.

Mua më bëhet shumë qefi që zonja Gaxherri përfundimisht ka filluar ta kërkojë transparencën, unë e përkrahi z. Gaxherri që ta propozojnë një Komision Hetimor për ta hetuar dhënien e tenderit për vlerësimin e Qendrës Protokollare në Gërmë. Pra, unë përkrah plotësisht që ajo ta iniciojë procedurën për hetimin e atij tenderi, e ka përkrahjen e Grupit ORA përnjëherë.

Çështja është këtu, a jemi ne trup politik apo ky është simpoziум i kimistëve. Ky është një organ politik dhe kur diskutohet, ku diskutojnë politikanët për çështjet të cilat janë fundamentale për shoqërinë dhe nuk ka çështje më fundamentale për shoqërinë mënyra si menaxhohen parat e këtij populli. Kjo është çështja më fundamental, kurse çështja a janë çuar në gjykatë apo jo asnjë Kuvend në botë nuk **të shtrohet** në gjykatë, mirëpo z. kryetar ju si pasardhës i paraardhësit tuaj ju e keni përgjegjësinë edhe morale, por jo vetëm morale për ta çuar në gjykatë në rast se prokurori nuk reagon, e keni përgjegjësinë për ta çuar paraardhësin tuaj në gjykatë për punët që i ka bërë keq, të shprehem më saktë për hajninë që e ka bërë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. profesor Hamiti e ka fjalën.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryetar i Kuvendit. Po të më lejohej t'i gjykoja diskutimet ,do të thosha se më shumë se gjysma s'kanë pas të bëjnë me objektin e diskutimit, por kjo ka ndodhur dhe nuk më lejohet të gjykoj.

Ne kemi përpara një raport të një Komisioni që kemi formuar vetë dhe unë dua të precizoj menjëherë këtu. Kurrfarë komisioni nuk ka **maru** Kryesia e Kuvendit këtë komision e **maru** ky Kuvend me konsensus të plotë. Kjo është nën 1 dhe kjo është shumë esenciale të thuhet këtu.

Nën 2, ky Komision i ndërtuar me konsensusin e të gjitha grupeve parlamentare në Kuvend e ka kryer punën dhe ky Komision ka këtë përbërje, kjo është me rëndësi të lexohet këtu. Kryetar Ferid Agani, Partia e Drejtësisë, anëtarë Lutfi Zharku, LDK, Hysnija Beshkoviq, 6+, Besa Gaxherri LDK, Ali Sadriu, LDK, Nimon Alimusaj, LDK, Naser Osmani, LDK; Shaban Halimi, LDK, Gani Koci, PDK, Safete Hadërgjonaj, PDK, Afrim Arzuallxhiu, PDK, Mazllom Kumnova, AAK, Gazmend Muhaxheri, ORA dhe Snezhana Iliq, LSKM, kjo është me rëndësi të thuhet. Domethënë është një Komision i ndërtuar në mënyrë konsesuale nga Kuvendi i Kosovës jo nga Kryesia e Kuvendi, i ndërtuar në këtë formë me konsensus i cili Komision vjen te na me një dokument që thotë e ka bërë me konsensus. Ne patëm këtu nuancime të disa anëtarëve të Komisionit që thanë që kanë pasur objeksione ndaj formulimeve, disa formulimeve, megjithatë, në fund të fundit doli, që pothuajse, tash unë po them thuaj se, Komisioni ka punuar me konsensus. Ne si Parlament me rregullat në fuqi e kemi për detyrë ta nxjerrim raportin e Komisionit në bankat Parlamentit, të bisedojmë me te dhe të marrim një vendim për rekomandimet e tij. Kjo është rregull e Parlamentit. Ne s'po bëjmë kurrgjë as më shumë as më pak seç jemi të detyruar të punojmë me rregullat e Parlamentit dhe unë besoj asnjëri nga 120 deputetët që flasin këtu sjellin teorinë qesharake për demokracinë, nuk mund të shkojnë përtej rregullave që i kanë aprovuar vetë. Këto rregulla thonë që të punohet kështu dhe nuk duhet të kalohet në histori as përpara as mbrapa se sa fenomeni që ekziston në këtë raport. Unë ju thashë është kaluar edhe para edhe mbrapa. Nën 2, duhet të theksoj ,sepse në mënyrë indikative është përmend Kryesia dy- tri herë. Unë po çuditë me kolegët e mi më të vjetër pse nuk reagojnë. Kryesia kur thuhet ka tri nuanca, ekziston një Kryesi e legjislacionit të parë që implikohet në këto probleme, ekziston një Kryesi e dytë e legjislacionit të dytë që implikohet në këto probleme dhe një Kryesi aktuale, përbërja që

është tash që i ka dy anëtarë që s'kanë lidhje as me të parën as me të dytën. Në periudha duhet të shihet ky problem. Kjo Kryesi aktuale ta quajë unë, se është shumë me rëndësi të thuhet, ka mbajtur shumë mbledhje për këto probleme dhe ka sqaruar shumë probleme dhe të dhëna dhe ky Komision veçse po jep të drejtë sa ka qenë institucionale në punën e vet. Dhe Komisioni Hetimor nëse i ka marrë procesverbalet e këtyre mbledhjeve ka mund saktësisht të konkludojë pikërisht çka ka konkluduar. Që asnjëra prej dy kryesive, meqë po flasim për Kryesi, paranej nuk ka mund të vërtetojë që ka vendim legal për këto punë. Mbas katër mbledhjeve të Kryesisë aktuale definitivisht është pranuar që nuk ekziston vendim legal i Kryesisë për këto probleme. Ç'po doni ta implikoni tash këtë Kryesi. Kjo ka dëshmuar që nuk ekziston ai vendim dhe ky Kuvend prapë jo Kryesia ,sepse as Kryesia aktuale s'ka pas fuqi të marrë vendim për gjërat që kanë ecë në kohë, mos vet sa, po e ka zbrit në bankat e këtij Kuvendi dhe është ky Kuvend prapë që ka marrë një vendim për vazhdim të punëve. Dhe kjo Kryesi edhe një herë është bërë përgjegjëse para Kuvendit, të cilit i përgjigjet, që ta inspektojë punën çfarë është bërë, po kjo është punë në vazhdim dhe kjo s'ka të bëjë me këtë raport.

Pra, ta personalizosh tash definitivisht problemin, unë jam njeni nga anëtarët e Kryesisë dhe nuk keq dorë nga pikëpamjet që i kam shpreh institucionalisht në Kryesi dhe në këtë Kuvend.

Unë e lexova këtë raport, unë i lexova rekomandimet ,sepse kjo është puna jonë tash sot këtu çka po bëjmë. Unë nuk shoh kurrfarë rekomandimesh që nuk mund të mbështeten, bile mund t'ju them janë rekomandime shumë institucionale gati pedagogjike. Mua më intereson prapë i fundit, ku implikohem direkt, sepse jam anëtar i Kryesisë. Thuhet rekomandimi 8.13. monitorimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, nuk është përgjegjësi nëse rekomandimet implikohen përtej Kuvendit. Duhet të specifikohet kush i realizon ato rekomandime në mënyrë që të jenë në monitorim të Kryesisë.

Kryesia e Kuvendit si organ nuk mund të monitorojë asgjë përtej punëve të Kuvendit dhe përtej detyrave që i ka me Rregulloren e Kuvendit. Unë due këtu precizim nëse do të votohet për këto rekomandime. Nuk kemi nevojë pra, definitivisht po them, të bëjmë tipe të fjalimeve jo është politike, s'është politike. Unë e di këtu njerëzit kur thonë politike mendojnë diçka të jashtëzakonshme. Unë po e përkthej shumë më të kapshme për të gjithë, se na e kënda me thanë institucionale, po përgjegjësitë institucionale zonja dhe zotërinj do t'i marrë gjithkush që i ka, edhe unë që i kam sot, edhe ai nesër, edhe pasnesër edhe prej kësaj s'kemi nevojë të frikohemi as të abstenojmë asnjëri prej nesh. Meqë kemi deklaruar që domi institucione, meqë kemi deklaruar që jemi institucionalistë, unë pranoj që unë jam ihtar i institucionalizimit. Faleminderit z. kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit profesor. Fjalën e ka deputeti Agim Krasniqi.

DEPUTETI AGIM KRASNIQI – Ju faleminderit z. kryetar. Unë e kërkoja fjalën në momentin kur vërtet e ka humbur kuptimin edhe vetë diskutimi edhe marrja e fjalës. Nëse dy tre diskutues ose pesë e ma tepër e përmendin emrin e një deputeti, pastaj ndërlihen

ato, neve na shkon gjithë koha gati në replika dhe kundër replika. Unë nuk jam ithtari i asaj që çdo gjë që nuk është Besa Gaxherri që të jep përgjegjësi ajo edhe ta mbrojë ose ti del në mbrojtje të dikujt. Për atë po them kërkojë ndjesë prej Besës që po e përmendi emrin, i thash edhe para se ta marr fjalën që po ta përmendi emrin i thashë edhe para se ta marr fjalën që do ta përmendi emrin por kisha me e lutë që nuk ka replikë, të lutem.

Ne kemi përpara dokumentin të cilin e ka hartuar Komisioni Hetimor Parlamentar që e kemi formuar, këto janë rekomandimet, e desha ta orientojë diskutimin se kisha dashur që të jem i fundit që diskutimi edhe të orientohet dhe dimë se si do ta përfundojmë këtë seancë.

Kjo seancë është e treta në radhë që i përkushtohet kësaj teme, edhe tu pas parasysh se i kemi rezultatet e Komisionit hetimor që përputhen plotësisht në përmbajtje edhe në formë, edhe në sasi edhe në vlera me gjitha rezultatet e dy seancave të mëparshme, atëherë ne do të duhej të përfundojmë këtë, e si do të jetë përfundimi, a do të shkojmë me aprovimin e rekomandimeve që jep Komisioni Hetimor apo do të hartohen rekomandime tjera do të shohim se çka duhet vendos. Për atë kisha me ju lutur rekomandimet që i ka ofruar Komisioni Hetimor, kanë të bëjnë gati kryesisht me punën e mëtutjeshme të organeve drejtuese të Kuvendit, për Kryesinë, për Kuvendin dhe për administratën e Kuvendit.

Vërtetë këtë që tha profesor Sabri Hamiti, të gjitha këto rekomandime janë plotësisht të akceptueshme, plotësisht janë të pranueshme, por si të përmbillet kjo se ne nuk dojmë me shndërrua Seancën Parlamentare në gjykatë, e ne tash gjykojmë. Të shohim se çka duhet bërë sepse puna që do ta bëjnë organet e prokurorisë nuk është puna e vetë të këtij Kuvendi. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti.

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Z. kryetar, zonja dhe zotëri. Vërtet unë i konsideroj të gjitha diskutimet që i dëgjova dhe kërkoj falje që s'isha për një kohë të caktuar këtu, si pjesë e politikës që duhet ta bëjë ky Kuvend, pjesë e debatit me të cilin duhet ta bëjë ky Kuvend dhe nuk konsideroj që ky Kuvend ka për qëllim ta linçojë dikë por që t'i vejë në vend gabimet dhe ta vejë në vend mirë funksionimin e tij për të ardhmen, sepse deri më tash kjo çështje ka çalue dhe nuk ka funksionua mirë, për këtë është debatua edhe më herët. Jam shumë i shqetësuar sepse nuk është në seancë ish kryetari i parlamentit z. Daci, sepse seanca e sotme, debati i sotëm është duke u zhvilluar pikërisht për z. Daci dhe për keqpërdorimet që janë konstatuar nga auditimi dhe Komisioni i ngarkuar nga ky Kuvend.

Si anëtar i Kryesisë në dy mandate kam thanë, edhe herën e fundit kur kanë desh me manipulua dhe kur pa drejtë pa asnjë rregull të lojës është pranua që sekretari i Kuvendit të dalë në foltore ta keqpërdorë foltoren e Kuvendit. Kam deklaruar dhe prapë po deklaroj, Kryesia nuk ka përgjegjësi për menaxhimin e fondeve Kuvendit as buxhetit të Kuvendit sepse askush në asnjë mbledhje nuk e ka ngritë këtë çështje dhe në qoftë se në rend të ditës nuk e ka sjellë kryetari që të diskutohet për një çështje të tillë unë nuk e di si ka pas mundësi që të merr vendim.

E dyta, përgjegjësitë mund t'i kemi të gjithë njësojë këtu, aq sa i ka pas Kryesia e Kuvendit bile, bile më shumë ka Kuvendi përgjegjësi sepse e ka pranua në kundërshtim me Kornizën kushtetuese, rolin e kryetarit të Kuvendit duke e nda nga Kryesia shumë herë përmes për mes rregullores që është antikushtetuese.

Tani sa i përket Komisionit. Së pari, unë mendoj që Komisioni është krijuar për të mos dhënë rekomandime, për të mos vendos kurrigjë dhe për ta shpërndarë përgjegjësinë, më vjen keq që është keqpërdorë Ferid Agani për me qenë kryetari i këtij Komisioni.

Kryetari i Komisionit në fjalë është dashur të jetë pikërisht dikush nga Grupi Parlamentar ORA që e ka ngritë çështjen dhe kanë kërkuar komisionin, këto janë rregulla parlamentare gjithkund edhe pse nuk shkruan në rregullore, edhe pse nuk është miratuar akoma Ligji për krijimin e komisioneve në Kuvend.

Prandaj, diskutimet mendoj që janë në rregull. Cilado qofshin i pëlqejnë dikujt apo si pëlqejnë, sepse asnjëherë diskutimet e tilla nuk mund të kenë një trajtim të posaçëm por mendoj që sot i ka takuar z. Daci që të jetë këtu dhe të jep përgjigje ai për të gjitha këto çështje që po ngriten dhe që janë ngritë deri më sot këtu dhe jo të na shikojë në televizor t'ue pi çaj ose të kesh me ne, thotë i kam futë llugave ata, donë me nejtë deri në mes natë t'u diskutua për qef temë.

Pra diskutimet, ka pas keqpërdorime apo jo unë nuk dua të hy sepse nuk kam pas akses kurrë, as unë dhe asnjë anëtar i Kryesisë, me i pa shpenzimet e buxhetit, përkundrazi kanë ardhur do farë tabelash që vetëm këta që janë marrë nashta me çështje të buxhetit ose çështje matematikash, mund t'i marrin vesh ose as ata si marrin vesh si kanë ardhur raportimet në Kuvend. Mendoj që administrata e di shumë mirë si ka funksionua cila ka qenë rruga e marrjes së vendimeve për shpenzimet e buxhetit dhe mendoj që e mbështesë plotësisht diskutimin e z. Hamiti i cili tha që jemi këtu për të dhënë mendime dhe për të vendos se çfarë më tutje ky Kuvend.

Vërejtja ime është, në komisionin që mendoj që është përpjekë me shpërnda përgjegjësinë të gjithë nga pakë dhe mos me e adresue përgjegjësinë aty ku duhet dhe ku është përgjegjësia. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. fjalën e ka kryetari i Komisionit, i fundit e merr fjalën.

DEPUTETI FERID AGANI - Faleminderit z. kryetar. Ishte me të vërtetë privilegj të dëgjoj këtë debat pas një pune tremujore, i falënderoj të gjithë diskutantët për vlerësimet e bëra. Mendoj se do të jenë me siguri në dobi të pasardhësve do të thotë deputetëve të tjerë që do të udhëheqin komisione të tilla ose do të jenë anëtarë të këtyre komisioneve me qëllim të përmirësimit të punës së tyre. Duke pas plotësisht kuptim për qëllime të mira të z. Halitit këtu definitivisht se kam ni veten të keqpërdorur, as nga anëtarët e Komisionit as nga ky Kuvend, e kam ndi vetën të privilegjuem me qenë në mesin e atyre deputetëve, zonjave dhe zotërive të nderuem të cilët me të vërtetë kanë punuar në një mënyrë shumë

konstruktive, në mënyrë shumë serioze dhe më besoni nga tërë puna shumë-orëshe që është bërë në 18 mbledhje të këtij Komisionit asnjëherë debati nuk ka marrë në mënyrë të cilësuar tone të personifikimit. Thuhet se puna e Komisionit është e drejtuar ndaj një personi. Ne jemi munduar që të jemi parimor të punojmë në nivel parimor, t'i adresojmë çështjet në nivelin parimor dhe rezultati është ky që është këtu që po e shihni. Me siguri se nuk mund të aspirojmë që të miratohet nga të gjithë në mënyrë unanime sepse çështja është mjaft e ndjeshme, u pa edhe nga debati i sotëm, por me gjithë atë ky është rezultat i punës analitike që është bërë, aq sa ka qenë e mundur që të bëhet në rrethanat konkrete. T'i adresoj vetëm dy çështje konkrete. Një, ishte një diskutim më duket se raporti i këtij Komisioni është një lloj replikimi i raportit të auditorit të përgjithshëm, që unë mendoj se nuk qëndron, mjafton të shihen përfundimet e këtij raporti, në veçanti rekomandimet të cilat janë pjesë specifike e këtij raporti e cila ka për qëllim me të vërtetë, që unë konsideroj pjesa më e rëndësishme e këtij raporti, ka për qëllim të ndryshojë gjendjen ekzistuese në Kuvend. Një fakt vetëm po e jap, është çështja e dokumentit të Komisionit Rregullativë të Prokurimit Publik për anulimin e vendimit të Organit Rregullator Prokurimit Publik, vendim ky i marrë më 27 dhjetor 2004, e thashë në fjalën time i cili nuk figuron askund në Raportin e Auditorit të Përgjithshëm dhe Auditori i Përgjithshëm në përgjigjen të cilën e ka kthyer në pyetjen tonë, a ka qenë ajo në dijeni për këtë dokument, për këtë vendim të Organit Rregullator Prokurimit Publik të marrë më 27 dhjetor 2004, ajo thotë se nuk ka qenë në dijeni, pra këto janë fakte të reja dhe këto na kanë udhëzuar më tutje, mos të lodhim më detaje, në një vijë të re hetimore e cila ka përfunduar me rekomandimin konkret që e kemi.

Çështja e dytë. U ngre çështja e përgjegjësisë së Ministrisë së Ekonomisë dhe e Financave. Vetëm të ju përkujtoj se me analizën e provave materiale ne kemi ardhur deri te konkludimi se në dokumentet zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ku paraqiten buxhetet e vitit 2003, 2004 dhe 2005, në faqe konkrete me referenc, i keni në raport të paraqitura thuhet shumë qartë se në buxhetin e vitit 2004, për shembull, thotë ka siguruar, janë siguruar 1 milion e 800 mijë euro në vijën buxhetore të administratës për investime kapitale dhe këtu mund të jem me z. Brajshorin në argumentim, kjo ka qenë edhe përgjigjja e zyrtarit nga thesari i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave por në vazhdim thuhet, për meremetimin dhe renovimin e objekteve të vjetruara të Kuvendit, ndërsa në dokumentin e vitit 2005 thuhet se 2 milion e 615 mijë euro janë nda në Departamentin e Administratës qendrore për investime kapitale që do të investohen për projektin e ndërtimit të aneksit në Germi, i cili projekt ka filluar punën me buxhetin e vitit 2004. Pra, Ministria e Ekonomisë dhe Financave e ka ditë se këto mjete janë të alukume për projektin konkret të investimit kapital të Qendrës Administrative Protokollare dhe megjithatë nëpër kanalet zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave është mundësuar që 236 mijë e 500 euro të ndahen nga ajo vijë buxhetore dhe të shkojnë në pagesën e veturës së blinduar. Pra, kjo ka qenë ajo që e ka shty Komisionin me jap rekomandimin konkret.

Në fund pajtohem me profesor Hamitin kur është në pyetje monitorimi dhe zbatimi i mëtutjeshëm i këtyre rekomandimeve. Komisioni nuk ka gjet organ më kompetent brenda Kuvendit i cili kishte mund të monitorojë zbatimin e këtyre rekomandimeve. Ne me siguri do ta pranoni cilëndo zgjidhje që ky Kuvend do ta binte por mendoj që se nuk do të ishte

që ky dokument të mbarojë në sirtarë dhe të ngelë vetëm një letër e shkruar e cila nuk do të ketë kurrfarë efekti.

Mendoj për të ardhmen do të ishte shumë me rëndësi dhe ndoshta do të ishte mirë që Kryesia e Kuvendit ta analizojë edhe një herë këtë situatë, ta shohë situatën që e ka me këto rekomandime dhe të propozoj Kuvendit një rekomandim konkret se si të procedohet më tutje me këtë dokument.

Për fund edhe një herë po ju falënderoj, mendoj se jemi munduar që të kemi një qasje serioze gjithëpërfshirëse ndaj kësaj çështje, si thash sa më analitike që është e mundur dhe shpresoj se kjo do të jetë fillimi i një praktike të re në Kuvendin e Kosovës e definitivisht ka qenë një përvojë shumë e rëndësishme për gjithë anëtarët e Komisionit dhe shfrytëzoj rastin që t'ju falënderoj të gjithë për kontributin e tyre. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Sërish i kemi dy kandidatë të paraqitur. Teuta Sahatçiu dhe Xhavit Haliti. Urdhëroni z. Haliti

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Së pari unë e di që z. Agani është krenar por unë nuk do të isha krenar duke pas parasysh që nuk ka qenë punë e tij ta drejtojë këtë Komision, për mua për dy arsye.

Një, sepse përfaqëson një parti e cila e ka vetëm një deputetë në parlament dhe janë bashkuar në një grup parlamentar dhe e dyta, nuk është propozues për ta krijuar komisionin. Së treti, konstatova saktë në propozimin e fundit që z. Agani dhe Komisioni nuk kanë qenë kompetent për këtë çështje por faktin se s'kanë asnjë sugjerim dhe thojnë do të ishte mirë që ta merr Kryesia këtë punë edhe një herë në dorë, për çka Kryesia, për çka u dashka Kryesia me marrë edhe një herë, cili është propozimi i Komisionit këtu. Çka duhet me bë ky Kuvend sot, cili është vendimi që duhet me nxjerr ky Kuvend, a duhet me votua me miratua këtë farë raporti të Komisionit, a duhet me marrë me qitë me ja u çue gazetave me i lutë me i botua për shkak të inateve të dikujt ose ngatërresave që kanë deputetët në mes veti ose grupet parlamentare njëra me tjetrën apo duhet vërtetë që të jemi në nivelin e përgjegjësive si Kuvend, si deputetë, që të marrim vendime të guximshme në momente të duhura dhe të epim mësim edhe vetvetes edhe atyre që kanë me ardhë mbas nesh.

Unë nuk po shoh këtu asnjë rezultat të këtij Komisioni, çfarë ka konstatuar ky, ka konstatua të njëjta gjëra dhe paska zbulua edhe një keqpërdorim ose një vendim që paska marrë Ministria e Financave ose që s'po don dikush me e pranua, okej, çka me ba tash, i kemi tre muaj ditë dhe u dashka edhe tre muaj ditë prapë me ardhur këtu me diskutua dhe me propozua Kryesia edhe një Komision të ri tash me konstatua që a është e vërteta e këtij farë Komisionit të parë. Unë sipas propozimeve të kryetarit të Komisionit këtë e konstatova që po u dashka na me u mbledh Kryesia, me ardhur edhe një herë në parlament me propozua edhe diçka kundërshtim me këtë.

Ju lutem, ne ose e miratojmë këtë raport me rekomandime konkrete ose është mirë me dhanë një rrugëzgjdhje kësaj çështje ose me thanë që s'jemi për këtë punë. Pajë, s'po dua me thanë krejt qashtu. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Teuta Sahatçiu e ka fjalën.

DEPUTETJA TEUTA SAHATÇIU – Faleminderit z. kryetar. Edhe ne, sikur edhe z. Haliti, e shohim që në përfundim pa disa dilema edhe ky debat në vend që të përmbillet me diçka hapi edhe dilema të reja. Nuk duhet nënçmuar punën e Komisionit t'u pas parasysh se Komisioni është formuar për herë të parë edhe e ka kryer me ato mundësi e veta punën e cila ju ka dhënë prej Kuvendit. Por duke pasur parasysh këto dilema dhe duke pasur parasysh që Komisioni ka qenë heterogjen edhe i përbërë prej partive, prej të gjitha grupeve parlamentare dhe duke pasur parasysh rekomandimet të cilat në fund i solli ky raport dhe ky Komision shihet dilema se në rekomandime nuk ka ndonjë afatizim kohor, nuk ka saktësi, nuk ka identifikim të atyre trupave të atyre grupeve të cilët do ta monitorojnë edhe do ta kryejnë. Këtu thuhet Kryesia, ndërsa tash shohim që ka dilema a mundet Kryesia me i krye ato punë a jo.

Prandaj, propozim konkret që të takohen Kryesia me shefat e grupeve parlamentare, sepse e përbëjnë, e reflektojnë Kuvendin ashtu si e ka reflektu edhe ky Komision dhe të diskutojnë për afatizimet kohore, ato i ceku edhe z. Sabriu që të përcaktohet cili trup do ta kryejë edhe afatet të cilat do të kryhen me të cilat do të realizohen këto rekomandime. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryetar. Unë në fund propozoj që t'i vëni në votim rekomandimet e raportit. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Shaban Halimi.

DEPUTETI SHABAN HALIMI – z. kryetar edhe unë si anëtar i Komisionit për hetimin e çështjeve të gjetura dhe faktike nuk e kam pas ndërmend të diskutojë por ja që këtu në fund tash kemi ardhur në dilema se çfarë të vendoset për këtë raport.

Unë mendoj se raporti është, pavarësisht ai që thuhet se njerëzit që kanë punuar nuk janë profesionalë, unë them se janë profesionalë dhe raporti ka misionin e vet ose ka qëllimin e vet. Nën një, neve duhet të kemi për bazë se kemi pasur për detyrë dhe obligim të mandatuar nga ky Kuvend vetëm për të verifikuar të gjeturat faktike nga Raporti i Auditorit Gjeneral dhe këtë e kemi bërë.

Tjetra anë pozitive e Raportit është se ky Raport ka afruar rekomandimet e tija dhe ato rekomandime janë, dhe në këto rekomandime neve pranuar, gjithashtu, dhe sugjerimet të tjera të cilët dhanë sugjerime se duhet të plotësohen këto rekomandime, dhe nuk është dhe nuk mundem për veti të pajtohem me konstatimin se ky Komision ka shpërnda përgjegjësitë, ky Komision nuk ka bërë asgjë. Komisioni them se e ka bërë punën e vet dhe tani i mbetet detyrë organeve përgjegjëse të këtij Kuvendi që këto detyra t'i shtynë më tej. Në rekomandime jashtëzakonisht qartë janë të dhëna të gjitha detyrat dhe obligimet që duhet t'i marrin organet kompetente.

Unë propozoj, jo si anëtar i Komisionit, që ky raport të pranohet nga ky Kuvend për të gjeturat faktike, do të thotë se është i saktë me mandatin që e ka pas dhe të pranohen rekomandimet e këtij Komisioni, hiq më tepër. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Propozoj që raporti të aprovohet në tërësi me vërejtjet që janë dhënë dhe rekomandimet, duke e heqë pikën për të cilën foli z. Sabri Hamiti.

E hedh në votim formal këtë propozim.

Kush është për, ju faleminderit. Kundër 5, abstenim 1. Konstatoj se me shumicë votash u aprovua raporti.

Me qenë se pika të tjera nuk kemi të rendit të ditës për sonte, ju faleminderit.

Mirë u pafshim në seancën tjetër.